RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

PËR

ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA NË 6-MUJORIN E DYTË TË VITIT 2021

Titulli: Për kryerjen e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit - AKSHI, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave - DPD, Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë – ISUV, Posta Shqiptare dhe Bashkia Shkodër.

Subjektet: Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit – AKSHI;
Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave – DPD;
Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë – ISUV;
Posta Shqiptare;
Bashkia Shkodër.

Përgatitur: shtator 2022

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 609/1, datë 16.06.2022.

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditim në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit - AKSHI, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave - DPD, Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë – ISUV, Posta Shqiptare dhe Bashkinë Shkodër, "*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e dytë të vitit 2021*", duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Hartimin e programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjor për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr.154/205 "Për organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
- Zbatimin e rekomandimeve *për përmirësimin në legjislacionin në fuqi*. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve *për masat me karakter organizativ*. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve *për Shpërblim dëmi ekonomik*. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve *për përdorimin me efektivitet dhe ekonomicitet*. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve *për masat disiplinore dhe administrative*. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.

Kuadri ligjor dhe nënligjor i verifikimit të zbatimit të rekomandimeve:

- Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 "Mbi Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC;
- Manualet e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH-së.

II. HYRJE

Auditimi u krye në zbatim të nenin 15 shkronja (j) dhe pika 2, e nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit*", Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr.1, datë 04.11.2016 "*Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, Programit të Auditimit nr. 609/1 prot., datë 16.06.2022 me objekt "*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e dytë të vitit 2021",* u krye auditimi mbi hartimin e plan veprimit dhe raportimit në KLSH mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për marrjen e masave organizative, dhe të masave të tjera, të rekomanduara në përfundimet e auditimit nga KLSH-ja për misionet e

mëparshme realizuar në subjektet AKSHI, DPD, ISUV, Posta Shqiptare dhe Bashkia Shkodër.

Auditimi është kryer nga:

1. E. C., përgjegjëse grupi
2. M. H., anëtar
3. A. K., anëtare
4. M. P., anëtare

Çështjet e Audituara:

1. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh nga data e marrjes së kërkesës, për informimin e KLSH për zbatimin e rekomandimeve e lëna nga auditimi i mëparshëm (germa "j" e nenit 15 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit").

Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit përfundimtar të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (*pika 2 e nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014*).

2. Realizimi i rekomandimeve për *ndryshime apo përmirësime në legjislacionin* në fuqi, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

3. Realizimi i rekomandimeve për *masa me karakter organizativ*, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

4. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

II.1. Objekti i auditimit

Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka si objektiv, verifikimin në subjekt (terren) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së Titullarëve të Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, etj.

II.2. Qëllimi i auditimit

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

II.3. Metodologjia e auditimit

Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin këshillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës "*Udhëzime mbi rregullat e auditimit*", ISSAI 10, Parimi 7, Deklarata e Meksikos, "Ekzistencën e Mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve", si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësive dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuara dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësive të

pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësisë në të ardhmen.

II.4. Konkluzione

Në përfundim të procesit të punës audituese në terren nga subjekti i audituar nuk u paraqiten kundërshti mbi aktverifikimet e mbajtura mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja.
Nga 5 auditime në subjekte, janë rekomanduar gjithsej 153 masa, nga të cilat janë pranuar gjithsej 146 masa ose në masën 95% dhe 7 masa nuk janë pranuar ose në masën 5%. Verifikuam se, nga 146 masat e pranuara janë zbatuar plotësisht 19 masa ose në masën 13%, janë zbatuar pjesërisht 11 masa ose 7.5% e totalit të masave të pranuara, janë në proces zbatimi 67 masa ose në masën 45.9% dhe pa zbatuar rezultuan 49 masa ose 33.6%. Analiza sipas llojit të rekomandimeve të dhëna paraqitet:
Masa propozime për përmirësime ligjore janë rekomanduar 3, nga të cilat 2 janë pranuar ose në masën 67% dhe 1 masë nuk është pranuar ose në masën 33%. Nga 2 masat e pranuara, 1 është në proces zbatimi 1 dhe nuk është zbatuar.
Masa organizative janë rekomanduar 149, nga të cilat janë pranuar 143 masa janë pranuar ose në masën 96% dhe 6 masa nuk janë pranuar ose në masën 4%. Nga 143 masat e pranuara, 19 masa janë zbatuar, 11 masa janë zbatuar pjesërisht, 65 masa janë në proces zbatimi dhe 48 masa nuk janë zbatuar.
Masa për shpërblim dëmi është rekomanduar 1 masë në vlerën 1,704,000 lekë e cila është pranuar dhe është në proces zbatimi.

Përmbledhëse e masave të pranuara në %

Nga 146 rekomandime të pranuara	Nr.	%
Zbatuar	19	13
Zbatuar pjesërisht	11	7.5
Në proces	67	45.9
Nuk janë zbatuar	49	33.6

- Në përputhje me kërkesat e nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nga 5 auditimet e kryera, për 4 prej tyre, nuk është kthyer përgjigje brenda 20 ditëve në KLSH, mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportet përfundimtare të auditimit nga KLSH, sipas afateve të përcaktuara, konkretisht: (AKSHI, DPD, ISUV dhe Bashkia Shkodër).

- Gjithashtu konstatohet se, nga 5 auditimet e kryera, anjë nga 5 subjektet, nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", konkretisht: (AKSHI, DPD, ISUV, Posta Shqiptare dhe Bashkia Shkodër).

II.5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

Pavarësisht nga puna e bërë, ku niveli i realizmit të rekomandimeve është mbi 12 %, për disa nga masat për të cilat janë në proces zbatimi ose janë zbatuar pjesërisht duhet akoma më shumë punë për realizimin në nivelin 100% të rekomandimeve.

III. Zbatimi i Rekomandimeve të Lëna në Auditimin e Mëparshëm
1. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

Në vijim do të gjeni më mënyrë të detajuar situatën mbi zbatimin e rekomandimeve në Agjencinë Kombëtarë të Shoqërisë së Informacionit – AKSHI, në bazë të Programit të Auditimit nr. 609/1 Prot, datë 16.06.2022.

Në zbatim të pikave 1-4 të Programit të Auditimit "*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e dytë të vitit 2021*", në AKSHI.

Objekti i auditimit është: Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e mëparshme me shkresën nr. *820/13 prot, datë 24.09.2021* drejtuar AKSHI-t.
Nga verifikimi i dokumentacionit, për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:
Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 3 masa si përmirësim ligjor dhe 15 masa organizative. Nga masat për përmirësim ligjor 2 masa janë pranuar nga të cilat një masë është në proces zbatimi, 1 nuk është zbatuar. Masat organizative janë pranuar plotësisht nga të cilat janë zbatuar 4 masa, janë në proces zbatimi 2 masa organizative dhe nuk janë zbatuar 9 masa organizative.

Përmbledhëse e masave të pranuara në %

Nga 17 masat e pranuara	Nr.	%
Zbatuar	4	23.5
Zbatuar pjesërisht	0	0
Në proces	3	17.6
Nuk janë zbatuar	10	58.8

2. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".
AKSHI nuk ka dërguar në Kontrollin e Lartë të Shtetit planin e masave për rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit mbi auditimin e zhvilluar në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit me objekt "Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit".

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
AKSHI nuk ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

4. Realizimi i rekomandimeve, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

1. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, është institucion publik qendror, në varësi të Kryeministrit dhe e zhvillon aktivitetin e saj në mbështetje të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 *"Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtarë të Shoqërisë së Informacionit"*, i ndryshuar, në të cilin përcaktohen kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë, etj. Me hyrjen në fuqi të kësaj VKM-je, siç edhe është përshkruar përgjatë këtij raporti, filloi procesi i qendërzimit të strukturave dhe Infrastrukturave të institucioneve dhe organeve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave. Përgjatë këtij transformimi në sektorin TIK janë hasur një sërë problematikash mbi përgjegjësitë, kompetencat dhe mbivendosje të bazës ligjore, çka nënkupton se procesi i qendërzimit nuk ka rezultuar i mirë planifikuar. Më poshtë janë rreshtuar disa nga mangësitë:

- Kundërshtim i akteve ligjore mbi administrimin e sistemeve të cilat kanë kaluar nën administrimin e AKSHI-t;
- Mbivendosje të kompetencave dhe përgjegjësive mbi administrimin dhe ofrimin e shërbimeve;
- Objektivat e përcaktuara në dokumente strategjik si p.sh. (*Axhenda Dixhitale e Shqipërisë 2015-2020 (Strategjia ndër sektoriale) dhe Programin Kombëtar TIK 2018-2021*) nuk janë reflektuar objektiva specifike që rrjedhin nga përcaktimet e VKM nr. 673;
- Mos realizim në kohë të objektivave të përcaktuara në VKM nr. 673 si p.sh. mos realizimi në kohë i transferimit të strukturave dhe infrastrukturave TIK nga institucionet e administratës publike;
- Mos hartimi i planeve dhe mënyrave mbi transferimin e aseteve nga institucionet në administrim të AKSHI-t;
- Etj.

Referuar sa më sipër grupi i auditimit vëren se VKM nr. 673 nuk është në përputhje me ligjin nr. 90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*", në nenin 10 të tij, parashikohet mënyra e krijimit dhe funksionimit të agjencive autonome, në të cilin citohet se: "***Agjencitë autonome krijohen dhe mbyllen me ligj***". Kjo njësi publike pavarësisht se ka emërtimin si Agjenci, statusi juridik i saj qëndron midis statusit të institucioneve të vartësisë dhe statusit të Agjencive Autonome.

1.1 <u>Rekomandimi</u>: AKSHI në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të ndërmarrë hapat e nevojshëm ligjore për hartimin e projekt ligjit "Për funksionimin dhe organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit".

Nga auditimi rezulton që: Rekomandimi është në proces zbatimi duke qenë se AKSHI ka draftuar projektligjin "Për qeverisjen elektronike".

Rekomandimi është në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Kundërshtim i akteve ligjore mbi administrimin e Regjistrit Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

Në nenin 3, pika 1/e të ligjit nr. 131/2015, datë 26.11.2015 *"Për Qendrën Kombëtare të Biznesit"*, citohet se: "QKB-ja ka këto funksione: *"mban dhe administron Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, në përputhje me ligjin që rregullon licencat, autorizimet dhe lejet""*, të ndërkohë në pikën 9 të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 "*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*", i ndryshuar, citohet: "*AKSHI është administrator i çdo sistemi TIK që ka si përdorues institucionet apo organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave*". Nga auditimi u konstatua se baza ligjore e sipërcituar bie në kundërshtim për sa i përket përcaktimit të institucionit administrues të Regjistrit Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve. Në VKM nr. 673 *(si akt më i vonshëm kronologjikisht*), nuk përcaktohet asnjë dispozitë apo nen i cili parashikon këto mbivendosje. Aktualisht, të dyja aktet janë në fuqi, edhe pse

kundërshtojnë njëri tjetrin për sa i përket administrimit të sistemit të Regjistrit Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

2.1 <u>Rekomandimi</u>: AKSHI dhe QKB të marrin masa për ngritjen e një grupi të përbashkët me qëllim hartimin, përcaktimin e propozimin e ndryshimeve të nevojshme në bazën rregullatore për të drejtat Administruese të Regjistrit Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

Nga auditimi rezulton që: QKB-ja mban dhe administron Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, në përputhje me ligjin që rregullon licencat, autorizimet dhe lejet, nëpërmjet sistemit dhe jo jashtë tij. Grupi i auditimit e ka gjetur të mbivendosur në aktet ligjore të drejtën administrative të sistemit, kjo dhe si rezultat i mungesës së një marrëveshje institucionale dakortësuar ndërmjet AKSHI-t dhe QKB, ku mund të specifikoheshin të drejtat dhe detyrimet administrative të sistemit për AKSHI-n dhe QKB–në. Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk është marrë asnjë masë nga AKSHI.

Rekomandimi nuk është zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi bazën ligjore dhe nënligjore të AKSHI dhe ADISA u konstatua se ka mbivendosje të kompetencave dhe përgjegjësive mbi administrimin e sporteleve të ofrimit të shërbimeve nga institucionet e administratës shtetërore midis dy institucioneve, më saktësisht përcaktohet si më poshtë:

Miratimi i VKM-së nr. 673 datë 22.11.2017, ka sjell ndikim në veprimtarinë e ADISA-s, pasi janë konstatuar mbivendosjet e përcaktuara më lart, me Ligjin nr. 13/2016 *"Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë"*, i cili rregullon veprimtarinë e ADISA-s. Konkretisht, në nenin 13, pika b e ligjit nr. 13/2016 *"Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë"*, citohet se: ADISA ka këto kompetenca: "*b) ngre dhe administron sportelet fizike të shërbimit për personat fizikë dhe juridikë, sportelet fizike të pikave të shërbimit me një ndalesë, si dhe qendrat e shërbimeve publike të integruara me një ndalesë dhe përgjigjet për menaxhimin e tyre",* neni 50: *Kalimi i administrimit të sporteleve të ofrimit të shërbimeve nga institucionet e administratës shtetërore tek ADISA*, pika 5, citohet: "*ADISA, mbas marrjes në administrim të sporteleve të shërbimit, ka të drejtë që t'i organizojë ato në një nga mënyrat e parashikuara nga neni 28 i këtij ligji",* ndërkohë në VKM nr. 673, pika 5 e kreut II "*Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e AKSHI-t"* citohen nënpikat:

f) Ngre dhe ofron shërbime elektronike për sportelet fizike të institucioneve dhe organeve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, të cilat ofrojnë shërbime publike.

g) Ofron sisteme IT, infrastrukturë hardware dhe TIK për ADISA-n, në kuadër të ofrimit të shërbimeve publike në sportele fizike nga ana e saj.

ç) Përcakton standardet shqiptare të shërbimeve publike elektronike (e-shërbime), në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, të adoptuara, të cilat do të ndiqen nga administrata shtetërore dhe subjektet private.

Aktualisht, të dyja aktet janë në fuqi, edhe pse kanë mbivendosje me njëri tjetrin për sa i përket administrimit dhe organizimit të sporteleve të shërbimit.

3.1 <u>Rekomandimi</u>: AKSHI dhe ADISA të marrin masa për ngritjen e një grupi të përbashkët me qëllim hartimin, përcaktimin e propozimin e ndryshimeve të nevojshme në bazën rregullatore për të drejtat e administrimit dhe organizimit të sporteleve të ofrimit të shërbimit.

Nga auditimi rezulton që: ndryshimet ligjore të ligjit nr.107/2021, datë 4.11.2021 "Për bashkëqeverisjen" i cili është miratuar pas dhënies së rekomandimit nga KLSH, ka ndikuar në pa zbatueshmërinë e tij. Bazuar në këtë argument, ky rekomandim konsiderohet i papranuar në zbatueshmërinë e tij.

Rekomandimi nuk është pranuar

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Ndryshimet në qeverisje dhe shkrirja e Ministrisë të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike MIAP me VKM nr. 504 datë 13.09.2017 dhe ndryshimi i statusit të AKSHI-t me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 nuk janë reflektuar në Strategjinë ndër sektorialë 2015-2020 apo edhe në Indikatorët e Strategjisë 2015-2020 dhe Plani i veprimit i strategjisë 2015-2020 që janë të ndërlidhura me njëra tjetrën. Këto dokumente strategjik nuk janë të update-uar me ndryshimet që AKSHI ka pësuar nga përcaktimet e VKM nr. 673.

1.1 Rekomandimi: AKSHI duke marrë parasysh ndryshimet strukturore dhe infrastrukturore të ndodhura në institucion me hyrjen në fuqi të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 të marrë masa për përditësimin e Strategjisë ndër sektoriale dhe dokumentet e tjerë strategjik si dhe reflektimin e ndryshimeve dhe përcaktimeve të VKM nr. 673, datë 22.11.2017.

Nga auditimi rezulton që: Ky rekomandim është zbatuar plotësisht me VKM nr. 370, datë 1.6.2022 "Për miratimin e Strategjisë Ndër sektoriale "Agjenda Digjitale e Shqipërisë" dhe të Planit të Veprimit 2022–2026".

Rekomandimi është zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Strategjia e Axhendës Dixhitale në Shqipëri[1] nuk përcakton politika shteruese për veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Kjo strategji është një ndër prioritetet e Qeverisë si një instrument kyç për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve dhe biznesit në vend dhe është hartuar si një strategji ndër sektorialë gjithëpërfshirëse e qeverisë në nivel makro të cilat përfshijnë dhe AKSHI-n. AKSHI nuk ka një strategji të veçantë zhvillimi të sajën, për rrjedhojë dhe plan-veprimin e strategjisë dhe indikatorët e matjes së perfomancës së strategjisë të veçantë.

2.1 Rekomandimi: AKSHI, duke marrë në konsideratë rëndësinë e të dhënave që institucioni zotëron dhe përpunon, të marri masa për hartimin e Planit Strategjik Institucional të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit duke patur parasysh ndryshimet e ndodhura me aktet ligjore dhe nënligjore.

Nga auditimi rezulton që: Ky rekomandim është zbatuar plotësisht me VKM nr. 370, datë 1.6.2022 "Për miratimin e Strategjisë ndër sektoriale "Agjenda Digjitale e Shqipërisë" dhe të Planit të Veprimit 2022–2026".

Rekomandimi është zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi masat e marra për plotësimin objektivave të Programit Kombëtar TIK 2018-2021 u konstatua se në programin kombëtar TIK nuk ka indikatorë të matshëm për plotësimin e këtyre objektivave. Në masat e përshkruara në programin kombëtar bëhet një shpjegim i përgjithshëm narrativ në nivel makro i politikave mbi situatën dhe nuk flitet për element konkret dhe mënyrën se si do të arrihet përmbushja e këtyre objektivave. AKSHI në përmbushje të përcaktimeve të pikës 3 dhe 5, b, të VKM nr. 673, duhet të kishte ndërmarrë rishikimin e këtij plani duke vendosur objektiva me tregues të matshëm më detyra të lindura nga kjo VKM.

3.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të AKSHI, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për përcaktimin e elementëve dhe indikatorëve të matshëm për matjen e plotësimit të objektivave të Programit Kombëtar TIK 2018-2021.

[1] *Miratuar me vendimin nr. 284 datë 01.04.2015, të Këshillit të Ministrave.*

Nga auditimi rezulton që: Meqenëse kemi në dispozicion vetëm Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 370, datë 1.6.2022 "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale "Agjenda Digjitale e Shqipërisë" dhe të Planit të Veprimit 2022–2026", por nuk kemi asnjë dokument tjetër i cili tregon se janë adresuar objektivat e institucionit në dokumentin strategjik "Programi Kombëtar TIK", ky rekomandim do të konsiderohet në proces për shkak të afatit shumë të afërt të miratimit të VKM dhe auditimit mbi zbatimin e rekomandimeve. Ky rekomandim nuk mund të realizohet deri në momentin që do të jenë adresuar objektivat e institucionit në dokumentin strategjik "Programi Kombëtar TIK" kërkuar në rekomandimin nr. 4.1.

Rekomandimi nuk është zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Në dokumentin strategjik "Programi Kombëtar TIK 2018-2021" të trajtuar nga grupi i auditimit nuk rezulton të jetë cekur procesi i qendërzimit të infrastrukturës TI dhe shërbimeve. I vetmi akt rregullator që përcakton afate kohore, mënyrën se si dhe kur do të fillojë procesi i qendërzimit është VKM 673, datë 22.11.2017. Në mbështetje të VKM 673, datë 22.11.2017, mbi këtë proces, nga AKSHI nuk është marrë asnjë masë për hartimin dhe miratimin e plan veprimeve për detajimin si dhe organizimin dhe fillimin e procesit të qendërzimit të infrastrukturës TI dhe shërbimeve. Ky proces ka rezultuar jo i mirë organizuar pasi në disa institucione nuk kanë ditur si të veprojnë dhe masat që duhet të merrnin për plotësimin e përcaktimeve në VKM 673. Procesi është në vazhdimësi dhe i papërfunduar në kohën që po hartohet ky raport edhe pse VKM ka përcaktime kohore të cilat nuk janë respektuar.

4.1 <u>Rekomandimi</u>: AKSHI në përmbushje të misionit të tij duke marrë parasysh funksionalitetet e reja të përcaktuara në legjislacionin rregullator, me një proces gjithë përfshirës të marri masa për rishikimin, përditësimin si dhe reflektimin e ndryshimeve ligjore, në dokumentin strategjik "Programi Kombëtar TIK" ku të adresohen qartë objektivat e institucionit.

Nga auditimi rezulton që: Meqenëse kemi në dispozicion vetëm Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 370, datë 1.6.2022 "Për miratimin e strategjisë ndër sektoriale "Agjenda Digjitale e Shqipërisë" dhe të Planit të Veprimit 2022–2026", por nuk kemi asnjë dokument tjetër i cili tregon se janë adresuar objektivat e institucionit në dokumentin strategjik "Programi Kombëtar TIK", ky rekomandim do të konsiderohet në proces për shkak të afatit shumë të afërt të miratimit të VKM dhe auditimit mbi zbatimin e rekomandimeve.

Rekomandimi është në proces zbatimi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk ka një plan veprimi për transferimin e aseteve nga institucionet nën administrim të AKSHI-t në kundërshtim me pikën 20 të VKM-së nr. 673, datë 22.11.2017.

5.1 <u>Rekomandimi</u>: Strukturat drejtuese të AKSHI-t në bashkëpunim institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave të marrin masa për hartimin e miratimin e një plan veprimi të detajuar për përfundimin e procesit të qendërzimit të infrastrukturës TI.

Nga auditimi rezulton që: Hartimi i planit të veprimit nëpërmjet parashikimit të projekteve të përbashkëta në përmirësimin e sistemeve ekzistuese nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në bashkëpunim me institucionet, nuk pasqyron rekomandimin e grupit të auditimit i cili i referohet procesit të qendërzimit të infrastrukturës TI. Gjithashtu nuk disponojmë asnjë plan të veprimi të dokumentuar ndërmjet institucioneve të cilës i referohet subjekti. Për sa më sipër, konstatojmë se për këtë rekomandim nuk është marrë asnjë masë për zbatim.

Rekomandimi nuk është zbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se 83 institucione të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, që përmbushin kalimin te AKSHI, për 79 prej tyre nuk është analizuar situata në fushën IT, në kundërshtim me shkronjën "gj", të pikës 5, të VKM-së nr. 673, datë 22.11.2017, ku citohet se AKSHI: *"Ngre, mirëmban dhe administron sisteme dhe aplikacione të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, infrastrukturën e qendërzuar dhe infrastrukturën TIK, përfshirë edhe ato të klasifikuara si "sekret shtetëror", për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave".*

6.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të AKSHI-t në vijimësi të marrin masa për vazhdimin e procesit të ngritjes së grupeve të punës për identifikimin dhe analizimin e gjendjes në fushën TIK dhe gjenerimin e raporteve përkatëse mbi situatën, për të gjitha institucionet të cilat përmbushin kalimin te AKSHI, në përputhje me përcaktimet ligjore

Nga auditimi rezulton që: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se AKSHI nuk ka marrë masa për përmbushjen e kërkesave të parashtruara në VKM nr. 35, datë 22.01.2020 dhe si rezultat nuk ka gjeneruar të ardhura për ofrimin këtyre shërbimeve. Gjithashtu AKSHI nuk ka ngritur dhe afishuar, në faqen elektronike web listën e shërbimeve që ofrohen nga AKSHI kundrejt subjekteve private edhe jo buxhetore si dhe listën e tarifave përkatëse për ofrimin e këtyre shërbimeve.

7.1 Rekomandimi: AKSHI në të ardhmen të marrë masa për të afishuar në faqen elektronike web listën e shërbimeve që ofrohen nga AKSHI kundrejt subjekteve jo buxhetore edhe private si dhe listën e tarifave përkatëse për ofrimin e këtyre shërbimeve si dhe marrjen e masave për zbatimin e përcaktimeve ligjore mbi ofrimin e shërbimeve sipas tarifave për ofrimin e shërbimeve nga AKSHI kundrejt institucioneve jo buxhetore dhe subjekteve private.

Nga auditimi rezulton që: Rekomandimi konsiderohet i zbatuar pasi këto të ardhura janë verifikuar edhe nga auditimi i përputhshmërisë i zhvilluar në vitin 2022 ku fondet janë hedhur në një llogari të veçantë në buxhetin e shtetit.

Rekomandimi është zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në strukturën faktike të vitit 2020 të AKSHI-t ka disa sektorë dhe ndarje strukturore më tepër se sa janë të përcaktuara në urdhrin e Kryeministrit nr. 174, datë 24.12.2019, i ndryshuar, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", si organ përgjegjës për përcaktimin dhe miratimin e strukturës. Gjithashtu kjo strukturë është e referuar edhe në rregulloren e brendshme mbi detyrat dhe funksionimin e institucionit.

8.1 Rekomandimi: AKSHI në të ardhmen të marrë masa që për çdo nevojë për ndryshim të strukturës institucionale të kërkojë miratimin paraprak të saj në organin përgjegjës.

Nga auditimi rezulton që: Rekomandimi konsiderohet i zbatuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 58 datë 25.03.2022 "Për miratimin e strukturës dhe të organikes së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit".

Rekomandimi është zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Nga administrimi i dokumentacionit mbi procesin e qendërzimit të strukturave TIK u konstatua se ky proces nuk ka dhënë efektet e pritshme në administratë. Procesi i qendërzimit të strukturës për shumicën e institucioneve të administratës shtetërore

nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave nuk është realizuar brenda afateve të përcaktuara, duke e bërë këtë proces të ngadaltë dhe jo mirë organizuar.

9.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të AKSHI-t në bashkëpunim me institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, për përfundimin e procesit të kalimit të burimeve njerëzore nën strukturën e AKSHI-t sipas përcaktimeve ligjore të marrin masa për hartimin dhe miratimin e një plan veprimi për detajimin dhe organizimin e procesit të qendërzimit të strukturës TIK.

Nga auditimi rezulton që: Nuk na është vënë në dispozicion asnjë dokument i cili tregon se është hartuar plani i veprimit për detajimin dhe organizimin e procesit të qendërzimit të strukturës TIK. Për sa më sipër, konstatojmë se për këtë rekomandim nuk është marrë asnjë masë për zbatim.

Rekomandimi nuk është zbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi kalimin e aktiveve nga DPGJC, ISSH dhe DPT në AKSHI u konstatua se institucionet nuk kanë marrë masa për ngritjen e grupeve të punës për evidentimin e sistemeve IT dhe infrastrukturave hardware, si dhe përcaktimin e listës së aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara objekt kalimi kapital. Infrastrukturat TIK të këtyre subjekteve nuk kanë kaluar nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse brenda datës 30 shtator 2018, në kundërshtim me pikën 18 të VKM 673, duke ndikuar në mbarëvajtjen e procesit të qendërzimit të infrastrukturës që AKSHI ka filluar që prej hyrjes në fuqi të kësaj VKM-je.

Edhe pse ka kaluar rreth 2 vite e 3 muaj nga afati i vendosur në VKM Nr. 673, datë 22.11.2017, "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtarë të Shoqërisë së Informacionit", i ndryshuar, ky proces ende nuk ka përfunduar. Aktualisht sistemet e IT dhe infrastruktura hardware në këto institucione, janë ende pjesë e inventarit të tyre, e për pasojë edhe detyrimet juridike dhe financiare mbi këto sisteme, në kundërshtim me pikën 18 të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 "*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtarë të Shoqërisë së Informacionit*", i ndryshuar.

10.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të AKSHI-t, DPGJC, ISSH dhe DPT të marrin masat e nevojshme për përfundimin e procesit të kalimit të aktiveve të sistemeve të teknologjisë së informacionit tek AKSHI, si dhe të përcaktojnë përgjegjësitë për vonesat e shkaktuara të zbatimit të kërkesave ligjore lidhur me këtë çështje.

Nga auditimi rezulton që: AKSHI megjithëse ka ngritur grupet e punës për përcaktimin e sistemeve dhe infrastrukturës TIK për kalim kapital për DPGJC në vitin 2018, ky proces është konstatuar i papërfunduar nga auditimi për të cilin është dhënë rekomandimi më sipër. Ministrisë së Brendshme i është drejtuar sërish me shkresën nr.2502/1, datë 02.06.2022 duke i rikujtuar marrjen e masave për përcaktimin e sistemeve dhe infrastrukturës që do të transferohet tek AKSHI. Ky proces nuk ka përfunduar në të 3 institucionet për të cilat është dhënë rekomandimi, por është në proces zbatimi. Gjithashtu, nuk janë përcaktuar përgjegjësitë për vonesat e shkaktuara të zbatimit të kërkesave ligjore.

Rekomandimi është në proces zbatimi

11. Gjetje nga auditimi: Që nga momenti i hyrjes në fuqi i VKM 673, AKSHI nuk ka marrë asnjë masë për hartimin e planit të veprimit ndërinstitucional të transferimit nën administrimin e AKSHI-t të aseteve që preken nga fusha e veprimit të *VKM nr. 673*, duke bërë që procesi i qendërzimit të jetë jo i plotë dhe në mospërputhje me afatet ligjore të përcaktuara duke krijuar vonesa dhe mos efektivitetet të procesit.

11.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të AKSHI-t të marrin masa për hartimin e planit të veprimit ndërinstitucional të transferimit nën administrimin e AKSHI-t të aseteve dhe

aktiveve të sistemeve të informacionit që preken nga fusha e veprimit të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtarë të Shoqërisë së Informacionit", i ndryshuar.
Nga auditimi rezulton që: Nuk na është vënë në dispozicion asnjë dokument i cili tregon se është hartuar plani i veprimit ndërinstitucional i transferimit nën administrimin e AKSHI-t të aseteve dhe aktiveve të sistemeve të informacionit që preken nga fusha e veprimit të VKM nr. 673, datë 22.11.2017. Për sa më sipër, konstatojmë se për këtë rekomandim nuk është marrë asnjë masë për zbatim.

Rekomandimi nuk është zbatuar

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga 83 institucione të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, që duhet të bëhen pjesë e procesit të qendërzimit me AKSHI-n, sipas përcaktimeve të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, vetëm 17 prej tyre kanë nënshkruar MNSH ndërsa 66 prej tyre nuk kanë lidhur ende një marrëveshje nivel shërbimi me AKSHI-n.
12.1 Rekomandimi: AKSHI në bashkëpunim me institucionet e administratës shtetërore sipas përcaktimeve të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 me qëllim monitorimin e ofrimit të shërbimeve, rritjen e efektivitetit, kufizimin e risqeve teknike, ruajtjen e integritetit dhe vazhdueshmërinë e punës të marri masa për hartimin e zbatimin e MNSH sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
Nga auditimi rezulton që: Hartimi i MNSH-së është rekomanduar nga auditimet e vazhdueshme të KLSH për arsye se është i vetmi dokument që mund të rregullojë dhe garantojë monitorimin e shërbimeve TIK të çdo institucioni publik të përcaktuar në VKM nr. 673, datë 22.11.2017. Neni 2 në VKM 710/2013 të cilës i referoheni përcakton lidhjen e MNSH-ve vetëm për sistemet informatike që ofrojnë shërbime për qytetarët, biznesin dhe për ndërveprimin e shkëmbimit të informacionit për administratën publike. Aktualisht, në katalogun e shërbimeve në VKM 673 datë 22.11.2017 renditen më shumë shërbime se ato që përmenden në pikën 2 të VKM 710/2013. Pra, shfuqizimi i kësaj pike nuk hedh poshtë detyrimin për nënshkrimin e MNSH-së, e rekomanduar vazhdimisht nga KLSH si dokument që rregullon marrëdhëniet institucionale ndërmjet ofruesit dhe përfituesit të shërbimeve në TIK.

Rekomandimi nuk është zbatuar

13. Gjetje nga auditimi: MNSH-t e nënshkruara ndërmjet AKSHI-t dhe 17 institucioneve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave janë pothuajse identike në hartimin e tyre, pavarësisht nga institucioni përfitues, duke mos marrë në konsideratë, rëndësinë e institucionit, ngarkesën apo sasinë e informacionit që institucioni përfitues përpunon.
13.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të AKSHI-t në vijimësi të marrin masa për rishikimin e MNSH-ve me institucionet që është nënshkruar MNSH duke marrë në konsideratë, tipin, formën dhe rëndësinë e institucionit, ngarkesën apo sasinë e informacionit që institucioni përpunon dhe përfshirjen e plotë të elementëve të Marrëveshjeve në Nivel Shërbimi sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
Nga auditimi rezulton që: Hartimi i MNSH-së është rekomanduar nga auditimet e vazhdueshme të KLSH për arsye se është i vetmi dokument që mund të rregullojë dhe garantojë monitorimin e shërbimeve TIK të çdo institucioni publik të përcaktuar në VKM nr. 673, datë 22.11.2017. Neni 2 në VKM 710/2013 të cilës i referoheni përcakton lidhjen e MNSH-ve vetëm për sistemet informatike që ofrojnë shërbime për qytetarët, biznesin dhe për ndërveprimin e shkëmbimit të informacionit për administratën publike. Aktualisht, në katalogun e shërbimeve në VKM 673 datë 22.11.2017 renditen më shumë shërbime se ato që

përmenden në pikën 2 të VKM 710/2013. Pra, shfuqizimi i kësaj pike nuk hedh poshtë detyrimin për nënshkrimin e MNSH-së, e rekomanduar vazhdimisht nga KLSH si dokument që rregullon marrëdhëniet institucionale ndërmjet ofruesit dhe përfituesit të shërbimeve në TIK.

Rekomandimi nuk është zbatuar

14. Gjetje nga auditimi: Pjesë e MNSH-ve janë edhe administrimi i incidenteve, problemeve dhe disponueshmërisë. Ofruesi i shërbimit (AKSHI) duhet të zotërojë një bazë të dhënash të gabimeve të njohura dhe historikun e incidenteve të mëparshme. Me anë të procedurës së administrimit të problemeve ofruesi i shërbimit (AKSHI) duhet të kryejë analizën e prirjes së informacionit për të identifikuar rrënjët e incidenteve dhe mundësitë për të parandaluar ndodhjen e tyre. Ofruesi i shërbimit (AKSHI) duhet të jetë i disponueshëm për të ofruar shërbim në institucionin përfitues të këtij shërbimi që janë institucionet përfituese. Për plotësimin e këtyre kërkesa thelbësore grupi i auditimit nuk administroi asnjë dokument që të vërtetonte që këto pika ishin trajtuar. Drejtoritë apo sektorët e TIK të AKSHI-t të atashuar pranë institucioneve i menaxhojnë risqet mbi bazë ngjarjesh. Suporti, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nuk dokumentohen.

14.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të AKSHI-t në vijimësi të kryejnë analizimin, prioritarizimin dhe ofrimin e shërbimeve të përcaktuara në MNSH-në ndërmjet institucioneve, hartimin e raporteve javore dhe mujore të shërbimeve të ofruara, me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme për kryerjen me rigorozitet të suportit.

Nga auditimi rezulton që: Hartimi i MNSH-së është rekomanduar nga auditimet e vazhdueshme të KLSH për arsye se është i vetmi dokument që mund të rregullojë dhe garantojë monitorimin e shërbimeve TIK të çdo institucioni publik të përcaktuar në VKM nr. 673, datë 22.11.2017. Neni 2 në VKM 710/2013 të cilës i referoheni përcakton lidhjen e MNSH-ve vetëm për sistemet informatike që ofrojnë shërbime për qytetarët, biznesin dhe për ndërveprimin e shkëmbimit të informacionit për administratën publike. Aktualisht, në katalogun e shërbimeve në VKM 673 datë 22.11.2017 renditen më shumë shërbime se ato që përmenden në pikën 2 të VKM 710/2013. Pra, shfuqizimi i kësaj pike nuk hedh poshtë detyrimin për nënshkrimin e MNSH-së, e rekomanduar vazhdimisht nga KLSH si dokument që rregullon marrëdhëniet institucionale ndërmjet ofruesit dhe përfituesit të shërbimeve në TIK.

Rekomandimi nuk është zbatuar

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga 83 institucione të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, që duhet të bëhen pjesë e procesit të qendërzimit me AKSHI-n, sipas përcaktimeve të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, vetëm 17 prej tyre kanë nënshkruar MNSH ndërsa 66 prej tyre nuk kanë lidhur ende një marrëveshje nivel shërbimi me AKSHI-n.

15.1 Rekomandimi: AKSHI në bashkëpunim me institucionet e administratës shtetërore sipas përcaktimeve të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 me qëllim monitorimin e ofrimit të shërbimeve, rritjen e efektivitetit, kufizimin e risqeve teknike, ruajtjen e integritetit dhe vazhdueshmërinë e punës të marri masa për hartimin e zbatimin e MNSH sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Nga auditimi rezulton që: Hartimi i MNSH-së është rekomanduar nga auditimet e vazhdueshme të KLSH për arsye se është i vetmi dokument që mund të rregullojë dhe garantojë monitorimin e shërbimeve TIK të çdo institucioni publik të përcaktuar në VKM nr. 673, datë 22.11.2017. Neni 2 në VKM 710/2013 të cilës i referoheni përcakton lidhjen e MNSH-ve vetëm për sistemet informatike që ofrojnë shërbime për qytetarët, biznesin dhe për

ndërveprimin e shkëmbimit të informacionit për administratën publike. Aktualisht, në katalogun e shërbimeve në VKM 673 datë 22.11.2017 renditen më shumë shërbime se ato që përmenden në pikën 2 të VKM 710/2013. Pra, shfuqizimi i kësaj pike nuk hedh poshtë detyrimin për nënshkrimin e MNSH-së, e rekomanduar vazhdimisht nga KLSH si dokument që rregullon marrëdhëniet institucionale ndërmjet ofruesit dhe përfituesit të shërbimeve në TIK.

Rekomandimi nuk është zbatuar

Në vijim do të gjeni më mënyrë të detajuar situatën mbi zbatimin e rekomandimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave – DPD, në bazë të Programit të Auditimit nr.609/1, datë 16.06.2022.

Në zbatim të pikave 1-4 të Programit të Auditimit "*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e dytë të vitit 2021*", në DPD.

Objekti i këtij auditimi është: Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e mëparshme me shkresën nr. 570/8 prot., datë 20.09.2021 drejtuar DPD si dhe me shkresën nr. 570/7 prot., datë 20.09.2021 drejtuar AKSHI-t.
Nga verifikimi i dokumentacionit, për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:
Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 24 masa organizative nga të cilat nuk është kundërshtuar asnjë. Është zbatuar plotësisht 1 masë, janë zbatuar pjesërisht 2 masa, është në proces zbatimi 1 masë dhe nuk janë zbatuar 20 masa organizative.

Përmbledhëse e masave të pranuara në %

Nga 24 masat e pranuara	Nr.	%
Zbatuar	1	4.2
Zbatuar pjesërisht	2	8.3
Në proces	1	4.2
Nuk janë zbatuar	20	83.3

2. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".

DPD nuk ka dërguar asnjë dokument shkresor pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi hartimin e një plan veprimi në respektim të afatit 20 ditor mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

DPD nuk ka dërguar dokument shkresor pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit në respektim të afatit 6 mujor mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

4. Realizimi i rekomandimeve, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Plani i veprimit dhe implementimit Strategjik Institucional nuk është realizuar sipas plan veprimeve përkatëse, prioriteteve, periudhave të implementimit nga personat përgjegjës me indikatorëve matës.

- Për objektivin "*Zhvillimi, implementimi dhe rishikimi i rregullt i strategjisë afatgjatë të TI-së që mbështet prioritetet e biznesit*" ku në plan veprimin parashikohet hartimi i një strategjie afatgjatë në përputhje me nevojat e anëtarësimit në EU MASP dhe programin e punës së EU UCC, konstatohet se nuk është hartuar një strategji IT afatgjatë në përputhje me nevojat e anëtarësimit në EU MASP dhe programin e punës së EU UCC, megjithëse parashikohej të mbaronte në dhjetor të vitit 2019.
- Për objektivin "*Përmirësimi i TI-së në të gjitha strukturat e ndryshme hierarkike*" ku në plan veprimin parashikohet të përcaktohen qartë rolet dhe përgjegjësitë ndërmjet AKSH-it dhe Administratës Doganore, konstatohet se nuk ka një marrëveshje të përbashkët ose rregullore ku të përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë ndërmjet AKSH-it dhe DPD megjithëse parashikohej të mbaronte në dhjetor të vitit 2018.
- Për objektivin "*Implementimi i NCTS, (Sistemin e Transitin Elektronik të Përbashkët) ITMS (Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave) dhe sistemeve të tjera të IT-së së BE-së*" ku në plan veprimin parashikohet hartimi i planeve të implementimit, përfitimi i burimeve dhe fondeve përkatës.

a. Konstatohet se nuk janë hartuar planet e implementimit me aktivitetet e parashikuar për Implementimin e NCTS, (*Sistemin e Transitit Elektronik të Përbashkët*), nuk janë identifikuar boshllëqet dhe nevojat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, duke përfshirë rekomandime për aktivitete të mëtejshme në fushën e transportit të përbashkët/komunitar; hartimi i të gjitha ligjeve, akteve nënligjore ose dispozitave zbatuese; takime ndërgjegjësimi me tregtarët; krijimin e skemës së menaxhimit dhe mirëmbajtjen e sistemit NCTS.

b. Sistemi i ri i kompjuterizuar i tranzitit skemë që duhej të miratohej nga qeveria shqiptare, etj. nga DPD dhe AKSH-i nuk ka përfunduar megjithëse parashikohej të mbaronte në dhjetor të vitit 2020.

c. Gjithashtu konstatohet se nuk janë hartuar planet e implementimit me aktivitetet e parashikuar për Implementimin e ITMS (*Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave*), ku përmes këtij Projekti, duhet të hartohej legjislacioni, manualet dhe udhëzimet e reja në përputhje me standardet e BE-së për tarifat, trajnimet përkatëse si dhe të sistemeve të tjera të IT-së së BE-së nga DPD dhe AKSH-i megjithëse parashikohej të mbaronte në dhjetor të vitit 2020.

- Për objektivin "*Prezantim i një mjedisi të plotë pa letër*" në plan veprimin parashikohet përmirësimi i sistemit ekzistues ASYCUDA në versionin më të fundit të disponueshëm, zhvillimi i një ndërfaqe ndërmjet sistemit tranzit dhe deklarimit, dhe përcaktohen qartë rolet dhe përgjegjësitë ndërmjet AKSH-it dhe DPD, konstatohet se nuk janë respektuar afatet e mbarimit nga DPD dhe AKSH-i sipas plan veprimit por rezulton se janë në proces realizimi.

Pra konstatohet se Teknologjia e Informacionit zhvillohet pa një Plan Strategjik, nuk janë hartuar planet e implementimit me aktivitetet e parashikuara në strategji bazuar në "*Strategjia e Biznesit e Administratës Doganore shqiptare 2018-2021*", praktikat më të mira, planin e veprimit dhe implementimit Strategjik Institucional.

1.1 <u>Rekomandimi:</u> DPD në bashkëpunim me AKSHI-n, të marrë masa për hartimin dhe konkretizimin e Planit të veprimit dhe implementimit Strategjik Institucional për objektivat e planit strategjik institucional "*Strategjia e Biznesit e Administratës Doganore shqiptare 2018-2021*", implementimi i NCTS, ITMS dhe sistemeve të tjera të IT-së së BE-së në përputhje me nevojat e anëtarësimit në BE, EU MASP dhe programin e punës së EU UCC.
Nga auditimi rezulton se: janë ndjekur hapa të zhvillimit të sistemeve NCTS dhe Single window. Me shkresën protokolluar në AKSHI me nr.8692 prot., datë 24.12.2021, eshtë ngritur komiteti ndërinstitucionalë që do të bashkëveproje për ecurinë e procesit. Meqenëse Single window dhe NCTS janë në fazë zhvillimi ky rekomandim do të konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Objektivat e Strategjisë Ndërsektoriale të Axhendës Dixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020 miratuar nga KM nuk janë të përfshira në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
Plan veprimi i strategjisë i AKSHI-t ku janë përcaktuar prioritetet strategjike ndërsektoriale të Axhendës Dixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020 nuk është përfshirë në plan veprimin e strategjisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
a. Konsolidimi i infrastrukturës dixhitale në Administratën Publike për;
- **Rritjen e sigurisë** përmes krijimit të Qendrës së Vazhdueshmërisë së Punës "*Business Continuity Center dhe Backup*" për Sistemet Qeveritare dhe "*Qendrës së Rikuperimit nga Fatkeqësia*" (Disaster Recovery Center –DRC)" për Sistemet Qeveritare; Ky aktivitet synon përmirësimin dhe forcimin e kapaciteteve të infrastrukturës aktuale TIK, (*shërbime dhe informacion*).
<u>Objektivi i kësaj strategjie gjithashtu nuk është përfshirë në strategjinë e DPD.</u>
DPD nuk disponon një infrastrukturë për vazhdueshmërinë e punës BCC (*Business Continuity Center)* për sigurinë e ruajtjes së të dhënave në rastet e dështimit të qendrës së të dhënave primare.
Nuk ka një plan vazhdimësie (BCP) si dhe plan rimëkëmbje nga katastrofat (DRC) për garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit. Duke mos caktuar kështu personat përgjegjës për të siguruar vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit, si dhe nuk janë identifikuar dhe ndarë sipas rëndësisë të dhënat kritike, sistemet, operacionet dhe burimet.
- **Një objektiv tjetër** (6) është "*Për Rrjete e Sisteme informacioni të sigurtë*".
Zhvillimi i Qeverisjes Elektronike, Administratës Dixhitale dhe Ekonomisë Dixhitale nuk mund të bëhet pa pasur një garanci efektive mbi sigurinë e rrjeteve të informacionit.
<u>Objektivi i kësaj strategjie gjithashtu nuk është përfshirë në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.</u>
b. Në funksion të strategjisë nga AKSHI është hartuar Plan veprimi i strategjisë Axhenda Dixhitale e Shqipërisë 2015-2020 ku si Prioriteti Strategjik 2 është përcaktuar: "*Politika për zhvillimin e infrastrukturës TIK dhe komunikimeve elektronike në të gjithë sektorët*":
1. Ndërtimi i Qendrës së Vazhdueshmërisë së Punës "*Business Continuity Center dhe Backup*" për Sistemet Qeveritare. Me afat implementimi 2015-2017.
2. Ndërtimi i "*Qendrës së Rikuperimit nga Fatkeqësia*" (Disaster Recovery Center – DRC)" për Sistemet Qeveritare. Me afat implementimi 2015-2017.
<u>Ky plan veprimi i AKSHI-t ku janë përcaktuar prioritetet strategjike të Axhendës Dixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020 nuk është përfshirë në plan veprimin e strategjisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.</u>
Pra konstatohet se Teknologjia e Informacionit zhvillohet pa një Plan Strategjik. Gjithashtu nuk janë përfshirë në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave objektivat dhe nuk

janë hartuar planet e implementimit me aktivitetet e parashikuara në strategji bazuar në "*Strategjia Ndërsektoriale e Axhendës Dixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020.*

2.1 Rekomandimi:

Nga DPD, AKSHI të merren masat për përfshirjen në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të Objektivave e Strategjisë Ndërsektoriale e Axhendës Dixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020.

- Nga DPD, AKSHI të merren masat për rritjen e sigurisë në infrastrukturën kritike të teknologjisë së informacionit dhe zbatimin e kërkesave të larta teknike për bazat e të dhënave shtetërore etj.
- DPD në bashkëpunim me Drejtorinë e TIK të Doganave, të marrë masa për hartimin dhe konkretizimin e Planit të veprimit dhe implementimit Strategjik Institucional për objektivat e planit të strategjisë ndërsektoriale të Axhendës Dixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020.
- Të merren masat për rritjen e sigurisë përmes krijimit të Qendrës së Vazhdueshmërisë së Punës "*Business Continuity Center dhe Backup*" për Sistemet Qeveritare dhe "*Qendrës së Rikuperimit nga Fatkeqësia*" (Disaster Recovery Center –DRC)" për Sistemet Qeveritare:

1. Ndërtimi i Qendrës së Vazhdueshmërisë së Punës "Business Continuity Center dhe Backup" për Sistemet Qeveritare.

2. Ndërtimi i "Qendrës së Rikuperimit nga Fatkeqësia" (Disaster Recovery Center – DRC)" për Sistemet Qeveritare.

Nga auditimi rezulton se: Ky rekomandim konsiderohet pjesërisht i realizuar meqenëse DPD ka hartuar udhëzimet e nevojshme, ndërsa ngritja e sistemit BCC është përgjegjësi e AKSHI-t.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

3. Gjetje nga auditimi: Objektivat (3) e Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike Shqipëri 2019-2022, "*Përmirësim i efikasitetit për mbledhjen e të ardhurave i cili do të sjellë më shumë qëndrueshmëri për financimin e buxhetit në nivelet e qeverisë qendrore dhe vendor*e" nuk janë të përfshira në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Plan veprimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike Shqipëri 2019-2022 ku janë përcaktuar masat për realizimin e objektivave specifike sipas komponentëve dhe treguesit e performancës ku institucioni udhëheqës është DPD nuk është përfshirë në plan veprimin e strategjisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

- Një nga komponentët e rëndësishëm të objekti specifik (3.3) është Menaxhimi Doganor ku si objektiv ka "*Mbrojtja e interesave financiare dhe ekonomike të Shqipërisë; kontributi për sigurinë e shoqërisë; lehtësimi i tregtisë; dhe bashkëpunimi me të gjithë aktorët e nevojshëm në nivel kombëtar ose ndërkombëtar*".

Në këtë kontekst rrëndësi merr sidomos përafrimi i kuadrit rregullator të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) me acquis të BE-së, përmirësimi i ofrimit të shërbimit ndaj klientit me procesin e ri-inxhinierimit si procedurat e thjeshtuara, kontrollet e reja të sigurisë sipas profilit të operatorëve dhe futjes së menaxhimit doganor elektronik për të lehtësuar procesin e përputhshmërisë.

Në këtë fushë në strategji konstatohet se mbeten ende mangësi (sistemi TIK) si:

• *Pak ecuri është bërë në drejtim të përdorimit proaktiv të njoftimeve elektronike për ngarkesat që mund të kenë rrezik të lartë shkeljeje;*

• *Prezantimin e një garancie të vetme për të gjithë llojet e transaksioneve dhe regjimeve që është në varësi të ngritjes së sistemit TI, i cili është vonuar;*

• *Gjithashtu, vonesa ka pasur kontraktimi i ITMS-së nga DPD-ja për t'u pajtuar me BE-ITMS.*

- Sipas Kapitullit 3 "*Qeverisja dhe koordinimi*" kjo strategji angazhon të gjithë sektorin publik dhe përgjegjësia e përgjithshme për një zbatim të suksesshëm të strategjisë është një përgjegjësi që ndahet mes të gjithë këtyre aktorëve në sektorin publik. (DPD).

Reformat e TI-së (3.8) që janë planifikuar brenda Objektivit Specifik përkatës përfshijnë aktivitete të rëndësishme që kanë si qëllim përmirësimin dhe integrimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit (TI-së).

Disa nga komponentët dhe masat brenda strategjisë (reforma e TI-së) janë:

• *Zhvillimi dhe mirëmbajtja e një sistemi gjithëpërfshirës për menaxhimin e riskut (DPD)*

• *Zgjerimi/rritja e përdorimit të SIFQ (Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë) dhe Integrimi i SIMBNJ (Sistemi Informatik i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore) dhe krijimi i interfaces (ndërlidhje) me doganat.*

Objektivat e mësipërm të Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike Shqipëri 2019-2022, nuk janë të përfshira në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

- Konstatohet se nga DPD dhe AKSH-i nuk janë hartuar planet e implementimit me aktivitetet e parashikuar për Implementimin e ITMS (*Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave*) ku përmes këtij Projekti, duhet të hartohej legjislacioni, manualet dhe udhëzimet e reja në përputhje me standardet e BE-së për Tarifat si dhe trajnimet përkatëse si dhe sistemeve të tjera të IT-së së BE-së megjithëse parashikohej të mbaronte në dhjetor të vitit 2020.

3.1 Rekomandimi:

- Nga DPD, AKSHI të merren masat për përfshirjen në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Objektivat e Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike Shqipëri 2019-2022

- Nga DPD, AKSHI të merren masat për hartimin e plan veprimit për realizimin e objektivave specifike sipas komponentëve për menaxhimin e doganave dhe masat për përmirësimin e mëtejshëm të sistemeve dhe platformave të TI-së dhe treguesit e performancës:

- *Zhvillimi, zbatimi dhe rishikimi i rregullt i strategjisë afatgjatë të TI që mbështet përparësitë e biznesit.*

- *Përmirësimi i organizimit dhe menaxhimit të TI.*

- *Implementimin e NCTS, ITEMS dhe sistemeve të tjera të TI të BE-së.*

Nga auditimi rezulton se: nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Dokumenti i politikave për sigurinë kibernetike 2015 – 2017 nuk është përfshira në Strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave qëllimi i të cilit është të rishikojë dhe të koordinojë detyrimet që lindin nga angazhimet e marra për një hapësirë kibernetike të sigurt me qëllim që të sigurohet përmbushja e përgjegjësive nga të gjithë aktorët në mënyrë të koordinuar.

Gjithashtu nuk është përfshirë në plan veprimin e strategjisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ku të përcaktohen masat për realizimin e objektivave specifike sipas komponentëve dhe treguesit e performancës.

A. Në dokumentin e politikave janë përcaktuar **objektivat strategjike** që duhet të ndiqen për përmbushjen e vizionit dhe respektimin e parimeve bazë të cilat **nuk janë përfshirë në plan veprimin e strategjisë** së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe AKSHI-t si:

- Plotësimi i kuadrit ligjor në fushën e sigurisë kibernetike.

a- Futja përdorimi sa më i gjerë i certifikatave për faqe interneti dhe web servera për të garantuar identitetin e sigurt të faqeve të institucioneve publike .

b-Detyrimi i kryerjes së auditimit periodik dhe vlerësimit të përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sigurisë së sistemeve të informacionit në përputhje me bazën ligjore dhe rregullatorë në

fuqi. Kjo, për të plotësuar legjislacionin aktualisht në fuqi që parashikon auditimin e databazave shtetërore duke lënë jashtë spektrit të veprimit sistemet në tërësi.

- Forcimi i kuadrit institucional.

a- Vlerësimi i krijimit të strukturave të nevojshme respektive pranë institucioneve të tjera të administratës publike, ku Forcimi dhe mbështetja për rritjen e kapaciteteve në fushën e sigurisë kibernetike do jetë një proces i vazhdueshëm në mënyrë që shteti të shërbejë si model në sigurinë kibernetike.

- Rritja e ndërgjegjësimit për sigurinë kibernetike.

- *Shpërndarja dhe publikimi i informacionit mbi rreziqet e hapësirës kibernetike,* nxjerrja e udhëzimeve dhe këshillave për një siguri minimale do jetë një proces i vazhdueshëm nëpërmjet të cilit do synohet të rritet ndërgjegjësimi dhe siguria e përdoruesve të thjeshtë. Përveç publikimit të tyre në faqet zyrtare të internetit të institucioneve të specializuara do bashkëpunohet në mënyrë të ngushtë me median për të siguruar një informim sa më të gjerë dhe të shpejtë të publikut.

B. Në dokumentin e politikave janë përcaktuar objektivat strategjike që duhet të ndiqen për përmbushjen e vizionit dhe respektimin e parimeve bazë të cilat **nuk janë përfshirë në plan veprimin e strategjisë** së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe AKSHI-t si:

- Identifikimi dhe mbrojtja e Infrastrukturave Kritike të Informacionit në Shqipëri.

a. Krijimi i procedurave dhe proceseve të nevojshme për identifikimin, inventarizimin dhe garantimin e sigurisë të tyre.

b. Përcaktimi i bazës rregullative mbi të cilën operatorët e infrastrukturave kritike do të duhet të raportojnë mbi incidentet e rënda kibernetike.

- Krijimi dhe implementimi i kërkesave minimale të sigurisë kibernetike.

a. Standarde, udhëzime dhe procedura të bazuara në praktikat më të mira ndërkombëtare duhet të përshtaten dhe miratohen për t'u zbatuar në administratën shtetërore.

b. Krijimi dhe miratimi i procedurave të analizës të rrezikut të sigurisë për sistemet e përdorura dhe shërbimet elektronike të ofruara nga institucionet është prioritet. Analiza e rrezikut të jetë një proces i vazhdueshëm dhe të kryhet në mënyrë periodike.

c. Do të ngrihen BCC (*Business Continuity Center*) dhe DRC (*Disaster Recovery Center*) për rrjetet/sistemet shtetërore.

d. Të ngrihet një sistem monitorimi, i cili do t'i njoftonte në kohë institucionet për rreziqet kibernetike që u kanosen duke monitoruar 24\7 nyjet më të rëndësishme, trafikun dhe eventet që ndodhin në sistem për të mundësuar edhe nxjerrjen e konkluzioneve nga log-et që ruhen, pa ndërhyrë apo monitoruar përmbajtjen.

- Forcimi i partneritetit me struktura të tjera përgjegjëse të fushës brenda dhe jashtë vendit.

a. Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve shtetërore do të forcohet për të garantuar ndërveprimin dhe koordinimin në forcimin e sigurisë dhe minimizimin e dëmeve nga sulmet kibernetike.

- Rritja e nivelit të njohurive, aftësive dhe kapaciteteve për ekspertizë në fushën e sigurisë kibernetike.

Të realizohen aktivitete me qëllim ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore të nevojshme në fushën e sigurisë kibernetike.

a. Në kuadër të forcimit të institucioneve, të rriten kapacitetet teknike të burimeve njerëzore. Kjo do të bëhet përmes programeve të zgjedhura të trajnimeve të cilat do të synojnë aftësimin e pjesëmarrësve në parandalimin e sulmeve, minimizimin e dëmeve, dhënien e përgjigjes efektive ndaj incidenteve të sigurisë së informacionit.

b. Pjesëmarrja aktive në konferenca ndërkombëtare, takime, seminare dhe ushtrime që kanë të bëjnë me sigurinë kibernetike. Shkëmbimi i informacioneve, analizave, eksperiencave, krijimi i projekteve të përbashkëta, vlerësimi i teknologjive dhe sistemeve të sigurisë shihen

jo vetëm si një mundësi për rritjen e sigurisë kibernetike në institucionet publike, por dhe si një investim për zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve të brezave pasardhës.
Konstatohet se nga DPD nuk janë marrë masat e nevojshme për hartimin dhe konkretizimin e planit të objektivave strategjike sipas komponentëve për dokumentin e politikave për sigurinë kibernetike 2015 – 2017.

4.1 Rekomandimi:

- Nga DPD, AKSHI të merren masat për përfshirjen në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të objektivave strategjike sipas komponentëve për dokumentin e politikave për sigurinë kibernetike 2015 – 2017.
- Gjithashtu nga DPD, AKSHI të merren masat për hartimin e plan veprimit për implementimin e objektivave strategjike sipas komponentëve për dokumentin e politikave për sigurinë kibernetike 2015 – 2017 si:

- Plotësimi i kuadrit ligjor në fushën e sigurisë kibernetike.
- Forcimi i kuadrit institucional.
- Rritja e ndërgjegjësimit për sigurinë kibernetike.
- Identifikimi dhe mbrojtja e Infrastrukturave Kritike të Informacionit në Shqipëri.
- Krijimi dhe implementimi i kërkesave minimale të sigurisë kibernetike.
- Forcimi i partneritetit me struktura të tjera përgjegjëse të fushës brenda dhe jashtë vendit
- Rritja e nivelit të njohurive, aftësive dhe kapaciteteve për ekspertizë në fushën e sigurisë kibernetike.

Nga auditimi rezulton se: nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Operatori i infrastrukturës kritike të informacionit; DPD, AKSHI, nuk kanë marrë masa sigurie për rritjen e sigurisë së informacionit në sistemin kritik "*Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganor*e", nuk ka përcaktuar, pikën e kontaktit, person përgjegjës AKCESK.

- Në listën e infrastrukturës kritike të informacionit në sektorin qeveritar është përfshirë operatori administrues DPD, AKSHI, me sistemin kritik "*Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganor*e" i cili ***nuk ka përcaktuar, pikën e kontaktit, person përgjegjës*** për infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit, dhe t'ia komunikojnë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

Sa konstatuar më lart është në kundërshtim me VKM nr. 553, datë 15.07.2020 "*Për miratimin e listës së infrastrukturës kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit*".

- Operatori i infrastrukturës kritike të informacionit; DPD, AKSHI, nuk kanë marrë masa sigurie për rritjen e sigurisë së informacionit në sistemin kritik "*Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganor*e" nuk i kanë zbatuar dhe nuk kanë dokumentuar zbatimin e tyre.

Mos marrja e masave të sigurisë cenon sigurinë e informacionit në sistemet e informacionit dhe disponueshmërinë e besueshmërinë e shërbimeve në sistemin kritik "*Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganor*e".

.Sa më lart është në kundërshtim me ligjin nr.2, datë 26.01.2017 "*Për sigurinë kibernetike*" Neni 8, "Masat e sigurisë", VKM nr. 553, datë 15.07.2020 "*Për miratimin e listës së infrastrukturës kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit*", pika 3 dhe 4.

5.1 Rekomandimi:

- Nga DPD në bashkëpunim me AKSHI-n të merren masat e nevojshme për përcaktimin e pikës së kontaktit, personin përgjegjës për infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit "*Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganor*e" dhe t'ia komunikojnë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

- Nga operatori i infrastrukturës kritike të informacionit, DPD, AKSHI, të merren marren masa sigurie për rritjen e sigurisë së informacionit në sistemin kritik "*Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganor*e" duke i zbatuar dhe dokumentuar zbatimin e tyre.
Nga auditimi rezulton se: nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se DPD nuk disponon procedura për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive për kryerjen e ndryshimeve.
6.1 Rekomandimi: Drejtoria së Përgjithshme të Doganave të marrin masat e nevojshme për hartimin e procedurave për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive për kryerjen e ndryshimeve.
Nga auditimi rezulton se: Subjekti nuk ka dhënë përgjigje lidhur me masën e marrë për zbatimin e këtij rekomandimi. Për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.

Rekomandimi nuk është zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se DPD nuk ka analizuar, identifikuar dhe planifikuar nevojat për trajnim të punonjësve për Sigurinë e Informacionit, në përmbushje të nevojave të përgjithshme dhe specifike që ndihmojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e veprimeve dhe procedurave të këtij institucioni.
7.1 Rekomandimi: DPD të hartojë plane për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sigurinë e informacionit në përmbushje të nevojave të përgjithshme dhe specifike që ndihmojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e veprimeve dhe procedurave të këtij institucioni.
Nga auditimi rezulton se: Subjekti nuk ka dhënë përgjigje lidhur me masën e marrë për zbatimin e këtij rekomandimi. Për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.

Rekomandimi nuk është zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se DPD nuk ka akte rregullatore të miratuara, e përkatësisht:

- Rregullore mbi mbarëvajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave të sigurisë;
- Rregullore për kategoritë e incidenteve kibernetike si dhe formatin dhe elementët e raportimit;
- Rregullore për administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike;
- Rregullore për menaxhimin e Firewall;

Rregullore për menaxhimin e log-eve digjitale në administratën publike.
8.1 Rekomandimi: DPD të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e:

- Rregullore mbi mbarëvajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave të sigurisë;
- Rregullore për kategoritë e incidenteve kibernetike si dhe formatin dhe elementët e raportimit;
- Rregullore për administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike;
- Rregullore për menaxhimin e Firewall;
- Rregullore për menaxhimin e log-eve digjitale në administratën publike.

Nga auditimi rezulton se: Subjekti nuk ka dhënë përgjigje lidhur me masën e marrë për zbatimin e këtij rekomandimi. Për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.

Rekomandimi nuk është zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Kontrata nr. 20069, datë 06.09.2017, me objekt "*Blerje, instalim dhe vënie në funksion të Software të LIMS*", nuk ka të parashikuar marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit për sistemin LIMS si dhe nuk është parashikuar dhe hartuar një marrëveshje e nivelit të shërbimit.

A. Midis Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe kontraktorit "J. S." sh.p.k, është lidhur kontrata nr. 20069, datë 06.09.2017, me objekt "*Blerje, instalim dhe vënie në funksion të Software të LIMS*", me vlerë 3.270.000 lekë me TVSH. Afati i ekzekutimit të kësaj kontratë është 90 ditë nga dita e nënshkrimit dhe do të përmbushet me furnizimin e "*Software të LIMS*" të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, konform aneks kontratës si dhe grafikut të lëvrimit të paraqitur nga kjo shoqëri.

Në kontratë mirëmbajtja është specifikuar vetëm tek formulari i ofertës që do të bëhet për 4 vjet dhe e gjithë vlera bashkë me blerjen është vendosur në total tek çmimi i kontratës për objekt blerje, instalimi dhe vënie në funksion.

Kjo kontratë nuk ka të parashikuar marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit për sistemin LIMS si dhe nuk është parashikuar dhe hartuar një marrëveshje e nivelit të shërbimit, ku të përcaktohen parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit si p.sh. orët/nivelet e suportit/përgjegjësitë/kufizimet, etj.

Sa më lart konstatohet, është në kundërshtim me, VKM nr. 710, datë 21.08.2013 "*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit"* i ndryshuar, pika 2, 2a dhe Udhëzimin e Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 1159, datë 17.03.2014 "*Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit*", pika 1 si dhe pika 6.

B. Gjithashtu *konstatohet se, sistemi LIMS nuk ka kaluar në administrim dhe inventar të AKSHI-t dhe marrëveshja e shërbimit me OE nuk ka reflektuar ndryshimet përkatëse për kalimin e shërbimit tek AKSHI* kjo në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 "*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*", i ndryshuar, neni 18 dhe neni 19.

9.1 Rekomandimi:

Nga DPD në bashkëpunim me AKSHI-n të merren masat e nevojshme për të kaluar në administrim dhe inventar të AKSHI-t sistemin, "*LIMS*", së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse duke përcaktuar përgjegjësisë dhe detyrimet për shërbimin e mirëmbajtjes të këtij sistemi dhe infrastrukturës TIK.

Nga auditimi rezulton se: nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Kontrata, me objekt "*Dixhitalizimi i shërbimeve doganore*" është lidhur nga AKSHI në cilësinë e autoritetit kontraktor me përfitues shërbimi DPD, në një kohë kur AKSHI organizon, kryen prokurimet e përqendruara për pajisjet TIK, por nuk lidh kontrata si dhe nuk është parashikuar dhe hartuar një marrëveshje e nivelit të shërbimit, ku të përcaktohen parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit.

A. Midis AKSHI-t në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit BO "S. & S." SHPK dhe "H." SHPK, është lidhur kontrata nr. 4700, datë 24.09.2020, me objekt "*Dixhitalizimi i shërbimeve doganore*" me përfitues shërbimi Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, me vlerë 100.295.999 lekë me TVSh, përkatësisht 62.495.999 lekë për implementimin dhe 37.800.000 lekë mirëmbajtje. Sipas kushteve të veçanta të kontratës neni 1, janë përcaktuar si:

- ***Autoriteti Kontraktor*** *është Agjencia Kombëtare e Shoqërisë të Informacionit.*
- ***Kontraktuesi*** *është BO "H." SHPK & "S. & S." SHPK.*
- ***Përfituesi i shërbimit*** *është DPD.*

Sipas kushteve të përgjithshme të kontratës baza ligjore e cituar për hartimin e kësaj kontrate është ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Kreu II, pika 5/j dhe VKM nr. 673, datë 22.11.2017 "*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*".

Kjo kontratë është firmosur nga AKSHI në cilësinë e Autoritetit Kontraktor në një kohë kur AKSHI organizon, kryen prokurimet e përqendruara për pajisjet TIK, për institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave dhe nuk lidh kontrata.
Sa më lart nënshkrimi i kontratës është në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 "*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*", Kreu II, pika 5, germa j, i ndryshuar me VKM nr. 872, datë 24.12.2019 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 673, datë 22.11.2017, të KM, "*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*", të ndryshuar, ku në Kreun II, janë bërë ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:..ii. Në shkronjën "j", fjalët "*lidh kontrata*", hiqen".
B. Nga auditimi i kontratës së mësipërme rezulton se nuk ka të parashikuar marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit për sistemin "*Dixhitalizimi i shërbimeve doganore*" në vlerën 37,800,000 si dhe nuk është parashikuar dhe hartuar një marrëveshje e nivelit të shërbimit, ku të përcaktohen parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit si psh. orët/nivelet e suportit/përgjegjësitë/kufizimet, etj.
Kjo në kundërshtim me, VKM nr. 710, datë 21.08.2013 "*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit"* i ndryshuar, pika 2, 2a, dhe Udhëzimin e Ministri të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP) nr. 1159, datë 17.03.2014 "*Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit*", pika 1 dhe pika 6.
C. Konstatohet se sistemi, "*Dixhitalizimi i Sistemit Doganor*" deri 31.12.2020 nuk ka kaluar në administrim dhe inventar të AKSHI-t pasi nuk ka mbaruar implementimi, gjithashtu nuk ka një marrëveshje shërbimi me kontraktorin dhe nuk ka një marrëveshje ku të jenë reflektuar ndryshimet përkatëse për kalimin e shërbimit tek AKSHI, në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 "*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit"*, i ndryshuar, neni 18 dhe neni 19.

10.1 Rekomandimi:

DPD në bashkëpunim me AKSHI-n të marrë masat e nevojshme për hartimin e një marrëveshje të nivelit të shërbimit, për sistemin "*Dixhitalizimi i shërbimeve doganore*" ku të përcaktohen parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit.
- DPD në bashkëpunim me AKSHI-n të marrë masat e nevojshme për të kaluar në administrim dhe inventar të AKSHI-t pas implementimit sistemin, "*Dixhitalizimi i Sistemit Doganor*", së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse duke përcaktuar përgjegjësisë dhe detyrimet për shërbimin e mirëmbajtjes të këtij sistemi dhe infrastrukturës TIK.

Nga auditimi rezulton se: komenti nga AKSHI i referohet gjetjes dhe jo rekomandimit, ndërsa të dy institucionet nuk kanë ndërmarrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi..

Rekomandimi nuk është zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Inventari i Aktive Afatgjata Materiale (AAM) të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, llogaria 213 "*Rrjetet dhe sistemet*" paraqitet në vlerën 264,765,083 lekë të cilat në analizë nuk pasqyrojnë vlerën e saktë të këtyre aktiveve.
- Në inventarin e AAM të DPD, janë pasqyruar "*Rrjetet dhe sistemet*", në vlerën 264,765,083 lekë, ku vlera bruto e sistemit "ASYCUDA" deri 31.12.2020 në total është 102,309,224 lekë kur në fakt duhej të ishte 150,160,248 lekë. (*Përfshirë tre zërat: Sistemi Asycuda World IT, në vlerën 102,309,224 lekë, Moduli i Akcizës IT, në vlerën 32,566,784 lekë, Moduli Protip për Tranzitin Kosovë –Al, në vlerën 15,284,240 lekë, të cilat janë në përbërje të një sistemi*). Pra nuk duhet të janë të veçuara si zë më vete në inventar, pasi janë pjesë e Sistemit Asycuda Word IT.
Gjithashtu, "*Mirëmbajte Pasje Laboratori – TVSh*" në vlerën 806,190 lekë, "*Suport për Firewall për IT*" në vlerën 8,474,355 lekë, "*Asistence Teknike për Administratën. Doganore*

IT" në vlerën 569,600 lekë, nuk janë AAM por shpenzime operative dhe nuk mund të jenë në inventarin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara në DPD.
Këto aktive nuk kanë kaluar nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse.
Mos paraqitja në vlerën e saktë e inventarit të aktiveve të llogarisë 213 "*rrjetet dhe sistemet*" si dhe mos kalimi i këtyre aktive nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse ka sjellë mos përcaktimin e përgjegjësisë dhe detyrimet për shërbimin e mirëmbajtjes së këtyre sistemeve dhe infrastrukturës TIK .
Për sa më lart është në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 *"Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit",* dispozita kalimtare, pika 18.
11.1 <u>Rekomandimi</u>: DPD të marrë masat e nevojshme për paraqitjen në vlerën e saktë të inventarit të aktiveve të llogarisë 213 "*Rrjetet dhe sistemet*" si dhe kalimi i këtyre aktive nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse duke përcaktuar përgjegjësisë dhe detyrimet për shërbimin e mirëmbajtjes së këtyre sistemeve dhe infrastrukturës TIK .
Nga auditimi rezulton se: nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

12. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 "*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*", <u>lloji dhe niveli i shërbimeve TIK që i ofrohen nga AKSHI, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave kryhen në mungesë të një marrëveshje midis palëve</u>.
- Nga auditimi rezulton se të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellat midis DPD dhe AKSHI-t, nuk janë të rregulluara dhe përcaktuara me një marrëveshje të nënshkruar nga palët, me qëllim përcaktimin e llojit dhe nivelit të shërbimeve që i ofrohen nga AKSHI Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave sipas VKM nr. 673, datë 22.11.2017 "*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*", pika 5/gj, 6/dh.
Nga Drejtoria e TIK e Doganave e AKSHI-t atashuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave është hartuar një "*Draft Marrëveshja Operacionale Bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*" e pa firmosur. Në këtë draft marrëveshje përcaktohen, objekti i marrëveshjes baza ligjore, të drejtat detyrimet dhe detyrat funksionale të AKSHI-t referuar Rregullores së AKSHI-t nr. 1900, datë 16.04.2020.
Mungesa e një marrëveshjeje ndërmjet dy institucioneve, përbën risk për mbarëvajtjen, monitorimin dhe dokumentimin e shërbimeve të Drejtorisë TIK në DPD.
12.1 <u>Rekomandimi</u>: DPD të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e një marrëveshjeje dypalëshe me qëllim përcaktimin e të drejtave dhe detyrimet e ndërsjellat midis DPD dhe AKSHI-t, llojin dhe nivelin e shërbimeve që i ofrohen nga AKSHI Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
Nga auditimi rezulton se: nuk rezulton të jetë hartuar një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve.

Rekomandimi nuk është zbatuar

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurat e ndjekura për monitorimin dhe analizimin e gjurmës elektronike të auditimit, rezultoi se:
- DPD nuk disponon asnjë politikë, procedurë apo procese të standardizuara për kontrollin dhe administrimin e gjurmës elektronike të auditimit, të quajtur ndryshe Audit Log.
- DPD nuk ka përcaktuar burimet njerëzore, përgjegjësitë dhe personat përgjegjës për monitorimin dhe analizimin e gjurmës së auditimit.
- Me gjithë rëndësinë që ka sistemi Asycuda, DPD nuk ka zhvilluar një infrastrukturë të

përdoret për gjenerimin, transmetimin, analizimin e log-eve.
- Ndërhyrjet që kryejnë specialistët e AKSHI-t bazuar në sugjerimet e UNCTAD, nuk rezultojnë të jenë dokumentuar e miratuar nga DPD në rastet kur ndërhyrjet kryhen mbi të dhënat e sistemit, duke vepruar kështu në mënyrë të paautorizuar. Struktura e AKSHI-t nuk ka në detyrat e saj menaxhimin e log-ut.
- DPD nuk ka implementuar një infrastrukturë për analizimin, arkivimin dhe ruajtjen e të dhënave të gjurmës elektronike, në kundërshtim me 5.2.1 "*Infrastruktura e Menaxhimit Të Log-eve*" të rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në administratën publike miratuar me Urdhrin nr.109, datë 10.06.2016 nga ALCIRT – Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike.

13.1 <u>Rekomandimi</u>: DPD të marrë masa për sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave duke filluar së pari me hartimin e një procedure apo rregullore për menaxhimin e gjurmës elektronike të auditimit. Në këtë dokument duhet të specifikohet qartë vendi ku ruhen gjurmët, për cilat veprime të përdoruesit ruhen këto gjurmë, koha, struktura përgjegjëse për monitorimin dhe analizimin e tyre, detyrat dhe përgjegjësitë, e çdo element që i shërben sigurisë së të dhënave dhe parandalimit në tjetërsimin e tyre.

Nga auditimi rezulton se: Subjekti nuk ka dhënë përgjigje lidhur me masën e marrë për zbatimin e këtij rekomandimi. Për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.

Rekomandimi nuk është zbatuar

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi të dhënat e gjurmës elektronike të auditimit, rezultoi se për vitin 2019 këto gjurmë janë fshirë me argumentin se madhësia e kësaj tabele bllokoi punën me sistemin Asycuda World për disa orë. Për këtë ndërhyrje, nuk rezulton të jetë dokumentuar asnjë shpjegim dhe asnjë miratim nga niveli drejtues i DPD. Vendimi dhe ekzekutimi është marrë nga struktura e AKSHI-t pranë DPD, në kundërshtim me pikën 5.2.2 "*Detyrat e Stafit Përgjegjës për Menaxhimin e Log-eve*", të rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në administratën publike miratuar me Urdhrin nr.109, datë 10.06.2016 nga ALCIRT – Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike, sepse struktura e AKSHI-t nuk janë stafi përgjegjës për menaxhimin e log-eve.

Drejtoria TIK e AKSHI-t nuk ka ngritur mekanizma kontrolli me qëllim parandalimin e çështjeve që lidhen me funksionalitete të sistemit, çfarë do të thotë se e njëjta situatë rrezikon të përsëritet në të ardhmen.

14.1 <u>Rekomandimi:</u> DPD të marrë masa të menjëhershme për ndërtimin e mekanizmave të kontrollit për mbrojtjen dhe sigurimin e të dhënave shtetërore, gjeneruar prej saj nëpërmjet sistemit Asycuda, me qëllim parandalimin e situatave të ngjashme si fshirja e të dhënave mbi gjurmën elektronike të auditimit në të ardhmen.

Nga auditimi rezulton se: Subjekti nuk ka dhënë përgjigje lidhur me masën e marrë për zbatimin e këtij rekomandimi. Për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.

Rekomandimi nuk është zbatuar

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi sistemin dhe të dhënat e aplikacionit të laboratorit – LIMS, sipas kontratës nr. 20069, datë 06.09.2017, rezulton se mungon gjurma elektronike e auditimit (Audit Logs), megjithëse është kërkuar në specifikimet teknike bashkëngjitur kontratës në disa pika, e përkatësisht:

Pika 4 Audit Trail:

- ii. Auditim i logimeve, aksesimeve, ndryshimeve dhe hapjes së çfarëdo aspekti të sistemit;
- iii. Auditim i të gjitha njoftimeve të dërguara nga sistemi (email sms);
- iv. Auditim i login-eve të dështuara;
- v. Të gjitha auditimet duhet të jenë të raportueshme;

Pika 11.8 Administrimi dhe monitorimi i dokumenteve kriteri nr. 26 "Sistemi duhet të menaxhojë gjurmët (auditimet e sistemit informatik)";
Pika 11.9 Menaxhimi i regjistrimeve dhe procedurave administrative kriteri nr.14 "Sistemi nuk duhet të lejojë fshirje të gjurmëve nga skedarët e log-eve (audit trails or logs)" dhe kriteri nr.23 "Sistemi duhet të ketë aftësi të regjistrojë "audit trail" për të gjitha aktivitetet që ndodhin në regjistrime".

15.1 <u>Rekomandimi:</u> DPD të marrë masat e nevojshme, për të siguruar përmbushjen e detyrime mbi specifikimet teknike për sistemin LIMS në lidhje me gjenerimin, administrimin, monitorimin dhe raportimin e gjurmës elektronike të auditimit quajtur "*Audit Log*".

Nga auditimi rezulton se: Subjekti nuk ka dhënë përgjigje lidhur me masën e marrë për zbatimin e këtij rekomandimi. Për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.

Rekomandimi nuk është zbatuar

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se DPD, si institucion që posedon disa sisteme informacioni që ruajnë, përpunojnë dhe gjenerojnë të dhëna me rëndësi për realizimin e mbikëqyrjes dhe tregtisë ndërkombëtare, nuk disponon një infrastrukturë BCC (Business Continuity Center), në kundërshtim me VKM nr.710, datë 21.08.2013 "*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*", i ndryshuar.
DPD nuk ka një plan vazhdimësie dhe plan rikuperimi për garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit.

16.1 <u>Rekomandimi:</u> DPD në bashkëpunim me AKSHI-n nisur edhe nga rëndësia që ka ofrimi i shërbimit pas një fatkeqësie natyrore, të hartojnë planin e vazhdimësisë dhe planin e rikuperimit si dhe të ndërmarrin hapat e nevojshëm për sigurimin e pajisjeve të nevojshme në ndërtimin e *Business Continuity* si dhe të përcaktojnë burimet njerëzore përgjegjëse nga të dy institucionet.

Nga auditimi rezulton se: DPD e ka përmbushur rekomandimin pasi e ka hartuar planin e veprimtarisë në rast ndërprerje. Aktualisht nuk rezulton të jetë ndërtuar një BCC për DPD.

Rekomandimi i zbatuar pjesërisht

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi pajisjet TIK rezulton se Firewall-i i internetit është Checkpoint i ndërtuar në një server që nuk është Cluster, kjo mungesë backup në pajisje vlerësohet me rëndësi nga auditimi për arsye se në të janë konfiguruar lidhjet me institucionet Bankare, me palët e treta dhe me shtetet fqinjë. Gjithashtu, nëpërmjet tij administrohen dhe VPN client për subjektet e akcizës, agjencitë doganore apo institucione të tjera për aksesimin e sistemit.

17.1 <u>Rekomandimi:</u> DPD të kërkojë nga AKSHI, prokurimin e pajisjes backup për linjën e internetit, me rëndësi për institucionin pasi në të janë konfiguruar lidhjet e jashtme me sistemin doganor, me qëllim parandalimin e ndërprerjes së punës në rast të një defekti në pajisjen aktuale.

Nga auditimi rezulton se: Këtë identifikim të pajisjeve nuk ka kapacitet DPD për ta kryer e vetme. Ajo që DPD identifikon është nevoja për mos ndërprerje të shërbimit të pagesave, teknikisht se si arrihet kjo është detyrë dhe përgjegjësi e AKSHI-t për ta përmbushur.

Rekomandimi nuk është zbatuar

18. Gjetje nga auditimi: A. Grupi i auditimit për periudhën nën auditim në lidhje me menaxhimin e përdoruesve Asycuda World, konstatoi se:

- Nuk janë dokumentuar në asnjë formë politikat e implementuara për fjalëkalimet e sistemeve qendrore, administrimit dhe përdoruesit fundor, me qëllim informimin mbi

kriteret e aplikuara në Asycuda si sistemi më i rëndësishëm dhe kritik i DPD, si dhe të aplikohen detyrimet që nevojiten në fjalëkalimin e tyre , bazuar në pikën 4 "Kërkesat e Sigurisë" pika a. dhe b. të rregullores për "Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike" miratuar nga CESK me Urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

- Mbajnë statusin "aktiv" përdorues të cilët nuk kanë asnjë marrëdhënie aktive me DPD.
- Në të dhënat mbi përdoruesit rezulton se në disa raste është mbyllur përdoruesi ekzistues dhe krijuar përdorues i ri për të njëjtin punonjës.
- Rezulton më shumë se një përdorues për të njëjtin person;
- DPD nuk ka dokumentuar në asnjë formë përdoruesit e bazës së të dhënave dhe të drejtat që ata kanë;
- Disa përdorues Brokers rezultojnë me të drejta si "Administrator";
- Për disa përdorues nuk ka datë krijimi;
- Të dhënat e kontaktit në pjesën më të madhe janë plotësuar me "1" e në disa raste nuk janë plotësuar fare, në vend të të dhënave të vlefshme;
- Janë funksionale disa role me të drejta administrative si: a, aa, admin, Administrator, çfarë tregon se mungon unifikimi i rolit në aplikacion.
- Adresa e përdoruesit është një e dhënë tekst e pa bazuar në ndonjë standard, herë është plotësuar qyteti dhe herë roli që ka përdoruesi, në disa raste adresa është një numër prsh "100";
- Emri i plotë në disa raste është plotësuar me numër;
- Nuk është respektuar i njëjti standard në krijimin e "username" ku pjesa më e madhe është krijuar me emër mbiemër, por në disa raste ky model nuk është ndjekur.
- Përcaktimi i fushës "JOB" është në disa forma për të njëjtin informacion p.sh në disa raste përdoruesve ju është caktuar fusha "Trade" e në disa raste "Trader", çfarë tregon se mungon standardi dhe në përcaktimin e roleve të njëjta në përdoruesit që krijohen dhe kjo e dhënë nuk rezulton të jetë një listë e miratuar por caktohet nga specialisti që regjistron për herë të parë përdoruesin.

B. Nga verifikimi në nivel administrativ që grupi i auditimit kreu në sistem lidhur me krijimin, ndryshimin dhe mbylljen e përdoruesve në sistemin LIMS, rezultoi se:

- Nuk ka datë krijimi, datë ndryshimi dhe datë mbyllje të përdoruesit;
- Në zgjedhjen e rolit të përdoruesit listohen dy mundësi D (doganier) dhe View (Monitorim Drejtoria e Përgjithshme), por në disa përdorues rezulton se roli I përcaktuar nuk gjendet në listë si p.sh: DL (Drejtor Laboratori), PI (Përpunuese Informacioni), PSMA (Përgjegjëse e Sektorit të Metodikave të Administrimit);
- Administratori mund të fshijë përdoruesin apo të ndryshojë dhënat e pandryshueshme si emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi.
- Nuk është ndjekur i njëjti standard në krijimin e përdoruesit në rolin doganier:
- Në një rast është krijuar sipas modelit shkronja e parë e emrit.mbiemër;
- Në disa raste janë krijuar sipas modelit emër mbiemër;
- Në disa raste sipas modelit emër_mbiemër
- Në një rast nuk përputhet emri i punonjësit me emërtimin e përdoruesit;
- Kriteret e ndërtuara në sistemin LIMS për fjalëkalimin e përdoruesit fundor dhe administrimit janë të njëjta: kur nuk duhet të përmbajë hapësira boshe; jo më i shkurtër se 6 karaktere; jo 6 fjalëkalimet e fundit;

18.1 <u>Rekomandimi:</u> Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të unifikojë të dhënat për përdoruesit e sistemit Asycuda dhe LIMS të njëjtës kategori, të plotësojë të dhënat që mungojnë për çdo përdorues, të ndërtojë kontrolle për mbylljen e përdoruesve në kohën e

duhur, të mbyllë përdoruesit të cilët kanë përfunduar objektin e krijimit, me qëllim ruajtjen e sistemit nga ndërhyrjet e paautorizuara.
Nga auditimi rezulton se: Subjekti nuk ka dhënë përgjigje lidhur me masën e marrë për zbatimin e këtij rekomandimi. Për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.

Rekomandimi nuk është zbatuar

18.2 <u>Rekomandimi</u>: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të ndërtojë mekanizma kontrolli për dokumentimin dhe miratimin fizik të ndryshimeve të lejuara për përdoruesit, për të cilat nuk gjenerohet një gjurmë elektronike auditimi.
Nga auditimi rezulton se: Subjekti nuk ka dhënë përgjigje lidhur me masën e marrë për zbatimin e këtij rekomandimi. Për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.

Rekomandimi nuk është zbatuar

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi aktet rregullative për dokumentimin dhe mirë administrimin e bazës së të dhënave doganore, rezulton se:
- DPD nuk disponon asnjë akt rregullativ të brendshëm me qëllim organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave, në përputhje me ligjin nr.10325, datë 23.9.2010, për "*Bazat e të dhënave shtetërore*", neni 5.
- Nuk janë dokumentuar në asnjë formë të dhënat dytësore të cilat ruhen në këtë bazë të dhënash për të mirë funksionuar si dhe të dhënat apo sistemet me të cilat ndërveprohet sipas përcaktimeve në nenet 7 dhe 8 të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, për "*Bazat e të dhënave shtetërore*".

19.1 <u>Rekomandimi:</u> DPD si institucion përgjegjës dhe administrues i të dhënave shtetërore që gjenerohen nëpërmjet sistemit Asycuda, të dokumentojnë me një akt rregullativ të brendshëm organizimin dhe funksionimin e të dhënave shtetërore me rëndësi kritike. Gjithashtu, të evidentohen dhe dokumentohen pa përjashtim të dhënat parësore dhe dytësore me të cilat janë ndërtuar ndërveprime për ofrimin e shërbimit ndaj shtetasve.
Nga auditimi rezulton se: nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi administrimin e të dhënave shtetërore të DPD rezulton se **t**ë dhënat gjeneruar prej sistemit Asycuda nuk administrohen nga DPD, megjithëse janë detyrim i institucionit që i gjeneron ato, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr.10325, "*Për bazat e të dhënave shtetërore"*, neni 5, dhe VKM nr.673, datë 21.11.2017 "*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*" pika 5/y. Aktualisht detyrat e administrimit të të dhënave janë deleguar në mungesë të plotë dokumentacioni (verbalisht) tek specialistët e AKSHIT, për arsye se vetë DPD nuk ka asnjë pozicion dhe punonjës në strukturën e saj, për ruajtjen dhe administrimin e të dhënave.

20.1 <u>Rekomandimi:</u> DPD si institucion përgjegjës dhe administrues i të dhënave shtetërore që gjenerohen nëpërmjet sistemit Asycuda, të marrë masa për përmbushjen e këtij detyrimi me strukturë të posaçme për administrimin dhe mbrojtjen e të dhënave, si shërbime të cilat nuk ofrohen nga AKSHI.
Nga auditimi rezulton se: Subjekti nuk ka dhënë përgjigje lidhur me masën e marrë për zbatimin e këtij rekomandimi. Për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.

Rekomandimi nuk është zbatuar

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përdorimin e moduleve të ndryshme të sistemit Asycuda World, u konstatuan problematika të ndryshme si:
- DPD nuk disponon manual të administrimit të sistemit Asycuda World si dhe për modulet *Akciza* dhe *Borxhi*.

- Pikat doganore rakordojnë me 1 javë vonesë, vetëm prej kushteve teknike dhe fizike që disponojnë, çfarë krijon pamundësi të kontrolleve dhe verifikimeve në kohë reale tek subjektet sa herë që kërkohet nga vetë ata apo nga hallkat monitoruese të DPD.
- Nuk e disponon askush adresën e email-it të krijuar për subjektet që kërkojnë anulimin e DSHA e për pasojë dhe ndërprerjen e lëvizjes për mallrat e akcizës, çfarë tregon se komunikimi i subjektit me degët doganore, për anulimin e DSHA nuk kryhet sipas përcaktimeve të Udhëzimit Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nr.2, datë 07.04.2015, dhe nr. 8627 prot, datë 07.04.2015.
- Ngarkimi i mallit nga subjektet e akcizës është një e dhënë që nuk mund të modifikohet nga ndërfaqja pasi është regjistruar në sistem pa marrë parasysh gabimin njerëzor në këtë rast edhe pse ngarkimi i mallit rezulton një herë i regjistruar në sistem nëpërmjet deklaratës doganore nga ku mund të lexohet automatikisht pa qenë i nevojshëm vetë deklarimi i subjektit.
- Gjendja e magazinës në sistemin e raportimit (Oracle) nuk është e njëjtë me gjendjen e magazinës në sistemin Asycuda për të njëjtin subjekt.
- Ngarkimet e mallit që regjistron subjekti në pika të ndryshme doganore nuk i shfaqen zyrës doganore mbikëqyrëse ku subjekti ushtron veprimtarinë.
- Anulimi i DSHA për subjektet e akcizës nuk e kthen sasinë e produktit në magazinën e subjektit në gjendjen që ishte përpara regjistrimit të veprimit, por e bën hyrje pa e shkarkuar atë sasi. Kjo sasi duhet të shkarkohet nga magazina e subjektit dërgues në momentin që subjekti pritës e ka pranuar dërgesën dhe jo që në regjistrimin e veprimit, pasi ky veprim krijon konfuzion dhe pamundësi për të patur të dhëna reale për gjendjen e subjekteve të akcizës.
- Në modulin e dokumentit elektronik të magazinimit të përkohshëm (DEMP) rezulton se, nuk mund të ndryshohen të dhënat kur konstatohet diferencë në peshë dhe në sasi (nr. I paketimit) edhe kur këto veprime kryhen përpara mbërritjes në destinacion. Gjithashtu peshat nën 1 gram (prsh 0.8) nuk mund të mbyllen në DEMP.

21.1 <u>Rekomandimi</u>: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për testimin e situatave të konstatuara nga auditimi renditur më sipër, raportimin e tyre tek Specialistët e TIK dhe ekspertët e UNCTAD për ato raste që mund të rregullohen gjatë fazës të Upgrade, dhe evidentimin e dobësive të cilat kërkojnë më shumë kohë për zgjidhje.

Nga auditimi rezulton se: Subjekti nuk ka dhënë përgjigje lidhur me masën e marrë për zbatimin e këtij rekomandimi. Për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.

Rekomandimi nuk është zbatuar

22. Gjetje nga auditimi:

A. Nga auditimi mbi veprimtarinë e ofruar nga sistemi LIMS rezulton se, nuk komunikon, menaxhon apo ndërvepron ndonjë palë e tretë. Ndërveprimi mungon dhe me sistemet e brendshme të DPD dhe konkretisht me atë më kryesorin Asycuda World kërkuar dhe në specifikimet teknike, mbështetur dhe në faktin se ky sistem suporton nënshkrimin Dixhital.

B. Nga auditimi mbi sistemin LIMS, rezulton se:

- Monitorimi dhe vazhdimësia e kontratës me kontraktuesin kryhet nga sektori Help Desk, ndërkohë që me hyrjen në fuqi të VKM nr.673, datë 21.11.2017 "*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*", kushtet teknike për të mbajtur funksional këtë sistem duhet të suportohen nga struktura e zhvillimit TIK atashuar nga AKSHI;
- DPD nuk disponon manual administrimi të këtij sistemi;
- Konfigurimet për gjuhën dhe identifikimin me "*Two factor authentication*" janë parametrizime të cilat nuk janë funksionale, kërkuar përkatësisht në pikat 11.1 dhe 11.6 të specifikimeve teknike.

- Në këtë sistem gjurma elektronike e auditimit (audit trails ose logs) mungon, çfarë është në kundërshtim me "Rregulloren për Menaxhimin e log-eve digjitale në administratën publike", miratuar me urdhrin nr. 109 datë 10.06. 2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT) si dhe me specifikimet teknike kërkuar më shumë se një herë e më konkretisht në pikat: 4 "Audit Trail", 11.8 "Administrimi dhe monitorimi i dokumenteve", 11.9 "Menaxhimi i regjistrimeve dhe procedurave administrative".
- Nuk janë zhvilluar raporte komplekse të cilat do të mund ti shërbenin auditimit të brendshëm dhe të jashtëm mbi monitorimin e aktivitetit dhe veprimtarisë së kësaj drejtorie dhe këtij sistemi, kërkuar në pikën 11.11 " Raporte të avancuara dhe analizë informacioni" ku një nga kërkesat është Monitorim dhe Raportim i aktivitetit në sistem (audit trails).

22.1 <u>Rekomandimi:</u> DPD të kërkojë tek kontraktorit përmbushjen e funksionaliteteve që nuk janë aktualisht funksionale, mbi:

- Import/exportin e të dhënave;
- Integrimin me sistemin Asycuda World me qëllim sigurimin e efektivitetit të përdorimit të sistemit LIMS pas përfundimit të kontratës së mirëmbajtjes;
- Manualin e Administrimit;
- Gjurmën elektronike të auditimit (audit trails ose logs);
- Raporte komplekse të cilat do të mund ti shërbenin auditimit të brendshëm dhe të jashtëm mbi monitorimin e aktivitetit dhe veprimtarisë së kësaj drejtorie;
- Konfigurimet për gjuhën dhe identifikimin me "*Two factor authentication*" të cilat nuk janë funksionale;

Nga auditimi rezulton se: Subjekti nuk ka dhënë përgjigje lidhur me masën e marrë për zbatimin e këtij rekomandimi. Për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.

Rekomandimi nuk është zbatuar

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi monitorimin e Intranetit, rezultoi se:

- Rruga që ndiqet për monitorimin e linjave data, nuk kryhet sipas hapave të përcaktuar në Rregulloren e Brendshme pika 4.3 "Detyrat funksionale të Sektorit të Zgjidhjeve dhe Suportit (Help Desk)".
- Nëpërmjet kësaj zgjidhje nuk monitorohet konsumimi i bandwith-it të linjës deri në nivel përdoruesi, duke mos i dhënë mundësinë Sektorit të TIK dhe vetë administratës doganore të kryejnë planifikimet e duhura për sasinë reale që çdo pike doganore i nevojitet.

23.1 <u>Rekomandimi:</u> Drejtoria TIK e AKSHI-t pranë DPD të konsiderojnë dhe implementojnë zgjidhje të tjera "open source" për monitorimin e linjave data për pikat doganore me qëllim monitorim më të detajuar mbi konsumin e bandwithit, çfarë do të ndihmonte DPD në një planifikim më të mirë dhe të afërt me atë kapacitet që nevojitet. Gjithashtu, Sektori i Zgjidhjeve dhe Suportit (Help Desk) me qëllim eliminimin e hapave të panevojshëm që mund të shkaktojnë humbje në kohë, gjatë monitorimit të linjave data të përcjellë tek ISP dhe eprori problemet e konstatuara

Nga auditimi rezulton se: ky rekomandim është zbatuar.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht

Në vijim do të gjeni më mënyrë të detajuar situatën mbi zbatimin e rekomandimeve në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë – ISUV, në bazë të Programit të Auditimit nr.609/1 prot, datë 16.06.2022.

Në zbatim të pikave 1-4 të Programit të Auditimit "*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e dytë të vitit 2021*", në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Objekti i këtij auditimi është: Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimin e mëparshme me shkresën nr.973/8 prot, datë 22.12.2021 drejtuar Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë .
Nga verifikimi i dokumentacionit, për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:
Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 26 masa organizative dhe 1 masë për shpërblim dëmi. Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 26 masa. Janë zbatuar 2 masa, janë në proces zbatimi 14 masa organizative, janë zbatuar pjesërisht 2 masë organizative dhe nuk janë zbatuar 8 masa organizative.
Nga masa për shpërblim dëmi është pranuar 1 masë dhe është në proces zbatimi 1 masë.

Përmbledhëse e masave të pranuara në %

Nga 27 masat e pranuara	Nr.	%
Zbatuar	2	7.4
Zbatuar pjesërisht	2	7.4
Në proces	15	55.6
Nuk janë zbatuar	8	29.6

2. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", me shkresën *552/7 prot, datë 19.09.2021*, është dërguar "Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për, auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit" në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë".
Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë nuk ka dërguar në Kontrollin e Lartë të Shtetit planin e masave për rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit mbi auditimin e zhvilluar në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë me objekt "Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit", por ka ngritur një urdhër të brendshëm për grupin e punës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH me nr. 2 datë 05.01.2022. Bashkëlidhur edhe plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve.

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", me shkresën *552/7 prot, datë 19.09.2021*, është dërguar "Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për, auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit" në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë".
Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë nuk ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

4. Realizimi i rekomandimeve, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ISUV nuk ka të miratuar respektivisht nga MBZHR dhe AKSHI, "*Rregulloren e Organizimit të Brendshëm të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë*" dhe Rregulloren për Sigurinë e Informacionit në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.
1.1. Rekomandimi: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në bashkëpunim me MBZHR dhe AKSHI-n duhet të marrë masa për miratimin e rregulloreve në bazë të së cilave institucioni mbështet veprimtarinë e tij.
Nga auditimi rezulton që: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë ka marrë masat e nevojshme për miratimin e dy Rregulloreve Institucionale, nga ku vetëm ajo e Teknologjisë së Informacionit është miratuar, në pritje të miratimit të Rregullores së Brendshme të ISUV.

Rekomandimi është proces

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ISUV nuk disponon strategji të Teknologjisë së Informacionit. Po ashtu, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë nuk disponon as një strategji institucionale.
2.1. Rekomandimi: ISUV duhet të ndërmarrë masa për ndërtimin e një plani strategjik për teknologjinë e informacionit, duke marrë në konsideratë rëndësinë e të dhënave që ISUV zotëron dhe përpunon, në të cilën të adresohen qartë objektivat e institucionit.
Nga auditimi rezulton që: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë ka hartuar planin strategjik në "Rregulloren Nr. 1 datë 17.01.2022 për Sigurinë e Informacionit.

Rekomandimi është zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ISUV ka mungesë në burimet njerëzore. Struktura aktuale e funksionimit të ISUV bëhet në zbatim të Urdhrit nr. 126, datë 23.10.2020 "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së ISUV*", e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave. ISUV ka në strukturën e tij të miratuar një numër total prej 99 punonjësish. Aktualisht, në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë janë 12 vende vakante, për të cilat institucioni duhet të ndërmarrë masa për ngritjen e kapaciteteve njerëzore duke kryer rekrutime, me qëllim plotësimin e strukturës.
3.1. Rekomandimi: ISUV duhet të ndërmarrë masa për plotësimin e kapaciteteve njerëzore duke bërë rekrutime me qëllim plotësimin e strukturës së institucionit.
Nga auditimi rezulton që: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë ka marrë masat e nevojshme për dërgimin e shkresave pranë MBZHR-së dhe DAP, kur krijohen rishtazi vendet vakante por edhe në rikujtesë të vendeve të pashpallura nga autoriteti përgjegjës DAP.

Rekomandimi është në ***proces zbatimi.***

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në strukturën e tij, ka vetëm një specialist TI, i cili është në varësi të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe përshkrimi i tij i punës bëhet sipas rregullave në fuqi të DAP.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë është konstatuar se specialistët e TI nuk kanë zhvilluar trajnime për kualifikime profesionale brenda dhe jashtë vendit, gjatë periudhës objekt auditimi. Po ashtu, ka rezultuar

se institucioni nuk ka identifikuar nevojat, nuk ka hartuar një plan mbi trajnimin e stafit të TI në fusha specifike të cilat do të ndihmonin stafin në rritjen profesionale, certifikimin dhe kualifikimin e mëtejshëm të tyre. Trajnimet që punonjësit kryejnë nga ASPA nuk janë të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e stafit për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

4.1. Rekomandimi: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë duhet të ndërmarrë masa për identifikimin e nevojave për specialist TI dhe ngritjen e një strukture TI duke bërë gjithashtu edhe identifikimin e nevojave për trajnim, hartimin e planeve të trajnimeve dhe kryerjes së tyre.

Nga auditimi rezulton që: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë nuk ka bërë identifikimin e nevojave për specialist TI dhe ngritjen e një strukture TI, pasi në bazë të Ligjit për nëpunësin civil Nr. 152/2013 i ndryshuar, ISUV ka 12 vende vakante të paplotësuara dhe nuk mund të bëj kërkesë për ristrukturim dhe shtesë të sektorit të TI. Për trajnim, administrata përfshihet vetëm në trajnimet të cilat kryhen online nga ASPA dhe specialisti i IT ka marr Certifikatë për trajnimet e kryera.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit "*Blerje e Vogël*" me vlerë nën 100.000 lekë u konstatua se procedurat janë zhvilluar pa hartuar procesverbalet sipas formularit nr. 5 të Udhëzim nr. 3, datë 27.01.2015.

5.1. Rekomandim: ISUV në të ardhmen në zhvillimin e procedurave të prokurimit "*Blerje e Vogël*" me vlerë nën 100.000 lekë të hartojë procesverbalet përkatëse.

Nga auditimi rezulton që: ISUV në procedurat e prokurimit "*Blerje e Vogël*" me vlerë nën 100.000 lekë që ka zhvilluar dhe do të zhvillojë në të ardhmen i ka hartuar dhe do të hartojë procesverbalet sipas formularit nr. 5 të Udhëzim nr. 3, datë 27.01.2015.

Rekomandimi është në proces zbatimi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit: "*Shërbim Marrëdhënie me publikun të vitit 2020*" dhe "*Shërbim Marrëdhënie me publikun të vitit 2021*" u konstatua se, nuk janë përcaktuar Specifikimet teknike për shërbimet që do të kryhen.

6.1. Rekomandim: ISUV në të ardhmen në procedurat që do të kryej duhet të marrë masa që në termat e referencës, të përfshihet objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

Nga auditimi rezulton që: ISUV në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në të ardhmen do përcaktojë Specifikimet teknike për shërbimet që do të kryhen.

Rekomandimi është në proces zbatimi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "*Shërbim Marrëdhënie me publikun 2020*" u konstatua se, nuk ka një situacion që të përcaktoj vlerën e secilit shërbim që kryhet.

7.1. Rekomandim: ISUV në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në të ardhmen duhet ti kërkojë kontraktuesit së bashku me raportet mujore dhe situacionin e shërbimeve të kryera**.**

Nga auditimi rezulton që: ISUV në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në të ardhmen do të kërkojë situacionet e shërbimeve që do të kryhen.

Rekomandimi është në proces zbatimi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "*Shërbim internet për Institucionin për vitet 2020 dhe 2021*" dhe procedurës së prokurimit "*Mirëmbajtjen e sistemit LIMS*", -*në Njësinë e Prokurimit dhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave nuk ka specialist të fushës së Teknologjisë së Informacionit.

8.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit dhe personat e autorizuar mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e ardhshme të prokurimit, gjatë krijimi të Njësive të Prokurimit dhe të Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave, të bazohen në kornizat ligjore dhe rregullative dhe të përfshijnë specialist të fushës përkatëse të procedurës së prokurimit.
Nga auditimi rezulton që: ISUV në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në të ardhmen do të bazohet në kornizat ligjore dhe rregullative dhe të përfshijë specialist të fushës përkatëse të procedurës së prokurimit.

Rekomandimi është në proces zbatimi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se niveli i shërbimeve TIK që i ofrohen nga AKSHI, Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë kryhen në mungesë të një marrëveshje midis palëve, kjo në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 "*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*".
9.1. Rekomandim: ISUV në bashkëpunim me MBZHR t'i kërkojnë AKSHI-t lidhjen e një marrëveshje nivel shërbimi, për mbarëvajtjen, monitorimin dhe dokumentimin e shërbimeve që AKSHI kryen ndaj ISUV.
Nga auditimi rezulton që: Me anë të shkresës nr.38 prot. datë 10.01.2022 dhe shkresës nr. 227/3 prot. datë 07.03.2022 ISUV i ka kërkuar informacion AKSHI-t mbi realizimin e procedurës së prokurimit për mirëmbajtjen e sistemit LIMS. Akshi ka kthyer përgjigje se procedura do të realizohej në muajin prill 2022, por sistemi LIMS është akoma pa mirëmbajtje.

Rekomandimi është në proces zbatimi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në nenin 9 të kontratës së mirëmbajtjes sistemit LIMS është përcaktuar një shumë prej 4,000,000 lekësh (pa TVSH) që Autoriteti Kontraktor duhet ti parapaguajë Operatorit Ekonomik. Shuma e parapagimit i është bashkangjitur situacionit të mirëmbajtës. Parapagimi është në kundërshtim me udhëzimin nr. 9 datë 20.07.2018 për procedurat Standarde të zbatimit të Buxhetit në të cilin thuhet se: *Në lidhjen e kontratave për investime nuk lejohet të parashikohet dhënia e fondeve buxhetore në formën e paradhënies, përveç rasteve kur parashikohet në kontratë me referencë të specifikuar të aktit ligjor/nënligjor. Në këto raste paradhënia mund të jetë deri në 10%, por jo më shumë se kufiri i garancisë së kontratës. Struktura përgjegjëse për thesarin evidenton vlerën totale të çdo kontratë/urdhër prokurimi, si dhe grafikun e shlyerjes së kontratës, pasi vërtetohet ekzistenca e fondeve buxhetore vjetore të mjaftueshme në SIFQ, për pjesën e vitit korrent të kontratës, të miratuara me ligjin vjetor të buxhetit në strukturën përkatëse buxhetore. Vlera e mbetur e kontratës shumëvjeçare regjistrohet për vitet pasardhëse*.
10.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit dhe personat e autorizuar mbi ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e ardhshme të bazohen në përcaktimet e kornizave ligjore.
Nga auditimi rezulton që: ISUV në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në të ardhmen do të bazohet në përcaktimet e kornizave ligjore.

Rekomandimi është në proces zbatimi

11. Gjetje nga auditimi: Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi plotësimin e kërkesave kontraktuale mbi mirëmbajtjen e sistemit "LIMS" u konstatua se raportet mujore nuk japin informacion mbi punën e kryer, por japin një konfirmim me "OK" që komponentët e sistemit janë funksional dhe kontrollet janë kryer, siç është kërkuar në specifikimet teknike Specifikimeve Teknike të përcaktuara në Nenin 8,pika 3 të kontratës së mirëmbajtjes së sistemit "Lims".

11.1. Rekomandim: ISUV në të ardhmen të zbatojë procedurat ligjore dhe kontraktuale të marrjes në dorëzim të shërbimeve.
Nga auditimi rezulton që: ISUV në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në të ardhmen do të zbatojë procedurat ligjore dhe kontraktuale të marrjes në dorëzim të shërbimeve.

Rekomandimi është në proces zbatimi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi kryerjen e shërbimit "*Mirëmbajtje e sistemit LIMS 2019*", u konstatua se procesverbalin e marrjes në dorëzim të shërbimeve e ka firmosur një prej punonjësve, pa një urdhër nga titullari, në procesverbalin e mbajtur më datë 02.12.2019 mbi kryerjen e shërbimit "*Mirëmbajtje e sistemit LIMS 2019*" me kompaninë A. sh.p.k.
12.1. Rekomandim: ISUV në të ardhmen të zbatojë të gjitha kornizat ligjore në delegimin dhe ndarjen e përgjegjësive në procedurat e prokurimeve.
Nga auditimi rezulton që: ISUV në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në të ardhmen do të zbatojë të gjitha kornizat ligjore në delegimin dhe ndarjen e përgjegjësive në procedurat e prokurimeve.

Rekomandimi është në proces zbatimi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ISUV nuk ka regjistër risku institucional. Nuk i menaxhon risqet institucionale dhe mbi teknologjinë e informacionit. Nuk janë identifikuar dhe vlerësuar ngjarjet e mundshme që mund të kenë efekt negativ përsa i përket arritjes së objektivave institucional.
13.1. Rekomandimi: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë të marrë masa për identifikimin dhe hartimin e regjistrit të riskut instiucional si dhe atë të teknologjisë së informacionit, në mënyrë që të analizohen dhe vlerësohen risqet dhe marrjen e masave për minimizimin e tyre.
Nga auditimi rezulton që: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë ka hartuar një regjistër risku duke identifikuar risqet e institucionit si dhe risqet e teknologjisë së informacionit.

Rekomandimi është zbatuar

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se faqja web e ISUV nuk ka elemente të sigurisë për garantimin e navigimit të sigurt në të. Portali nuk përdor një lidhje të sigurt, (connection security) HTTPS (HyperText Transfer Protocol Secure).
14.1. Rekomandimi: ISUV duhet të ndërmarrë masa për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e faqes web me elementët përkatës të sigurisë së navigimit online për të rritur sigurinë.
Nga auditimi rezulton që: Ky rekomandim është në proces zbatimi pasi pritet realizimi i procedurës së prokurimit për certifikatën e sigurisë SSL për faqen web të ISUV

Rekomandimi është në proces zbatimi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ISUV nuk ka implementuar kontrolle të qendërzuara dhe rrezikon kompromet imin e sigurisë së infrastrukturës network. Nuk përdor Active Directory për menaxhimin dhe administrimin e qendërzuar dhe të sigurt të rrjetit të ISUV.
15.1 Rekomandimi: ISUV të marrë masa për menaxhimin dhe administrimin e qendërzuar dhe të sigurt të rrjetit të ISUV nëpërmjet implementimit të Active Directory.
Nga auditimi rezulton që: Ky rekomandim është në proces zbatimi pasi ISUV ka bërë kërkesë për rialokim fondesh për rindërtimin e dhomës së serverëve dhe pritet miratimi i fondeve nga MBZHR.

Rekomandimi është në proces zbatimi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ISUV nuk ka marrë masa për sigurimin e vazhdueshmërisë së punës dhe të ruajtjes së informacionit. Nuk ka plan për vazhdimësinë e biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat.
ISUV, nuk ka dokumentim/implementim të planeve mbi sigurinë e informacionit. ISUV nuk ka dokumentacion përsa i përket planit të vazhdueshmërisë së punës (BCP).
16.1. Rekomandimi: ISUV të marrë masa për hartimin dhe miratimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit, duke përfshirë planet për backup, sistemet dhe pajisjet kompjuterike.
Nga auditimi rezulton që: Ky rekomandim është në proces zbatimi pasi ISUV ka bërë kërkesë për rialokim fondesh për rindërtimin e dhomës së serverëve, plan për backup-in e sistemet, pajisje kompjuterike dhe të dhënat e sistemit dhe pritet miratimi i fondeve nga MBZHR.

Rekomandimi është në proces zbatimi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi sigurinë e bazës së të dhënave të sistemit LIMS për periudhën 01.01.2019 deri më 30.06.2021 u konstatua se janë kryer veprime duke krijuar 951 "Hendeqe" në fushën ID. Ky konstatim tregon se të dhënat kur hidhen në sistem nuk marrin numrin e ID inkrimental rritës, si pasojë krijohet mundësia për ndryshimin e të dhënave në sistem dhe nuk është e mundur ndjekja e rrjedhës historike të dhënave të sistemit. Nisur sa më sipër personat të cilët kanë akses në bazën e të dhënave kanë kryer sistemime apo fshirje të të dhënave duke gjeneruar ID me Hendeqe, pa autorizim nga personat përgjegjës në ISUV.
17.1. Rekomandimi: ISUV të marrë masa për verifikimin e situatës së krijuar në lidhje me "Hendeqet" në fushën ID, duke hartuar rregullore për përdoruesit dhe administratorët e sistemit LIMS.
Nga auditimi rezulton që: ISUV nuk ka marrë asnjë masë për identifikimin e Hendeqeve në fushën ID (të dhënat e fshira). Nuk ka hartuar rregullore për përdoruesit dhe administratorët e sistemit LIMS.

Rekomandimi nuk është zbatuar

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ISUV nuk ka dhome serverësh, por janë 2 zyra të përshtatura si dhoma serverësh të cilat nuk plotësojnë standardet e përcaktuara sipas rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve miratuar nga AKSHI.
18.1. Rekomandimi: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomës të serverëve në bazë të standardeve dhe praktikave më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.
Nga auditimi rezulton që: Ky rekomandim është në proces zbatimi pasi ISUV ka bërë kërkesë për rialokim fondesh për rindërtimin e dhomës së serverëve dhe pritet miratimi i fondeve nga MBZHR.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në sistemin LIMS u konstatua se:
Menuja-Regjistra-Nën menuja Formularë Shoqërimi- qeliza KODI (përveç të dhënave numerike që duhet të marrë dhe duhet të ishte standarde) kjo fushë merr karaktere të tjera si shkronja "e", shenjat e pikësimit pikë "." dhe presje ",".
- Në menunë "*Subjekti që ka kërkuar provën*", përveç emrave të personave apo subjekteve të cilët sjellin provat për t'u kryer analizat, në këtë fushë dalin dhe numrat "147,148, 89" dhe karakteri vizë "-".

- Tek fusha "*Mënyra e kampionimit*" lejon të shkruhen numra dhe karaktere, ndërkohë që duhet të jetë e parapërcaktuar si fushë, pasi janë vetëm 3 mënyra kampionimi "*1. e rastësishme, 2. me zgjedhje, 3. me gjueti*."
- Nga 659 veterinerë të regjistruar, 507 prej tyre janë aktiv. Nga 507 veterinerë aktiv rezulton se 392 ose 77% prej tyre nuk kanë të regjistruar në sistem numrin e telefonit dhe adresën e e-mailit.

Vetëm 115 ose 23% e veterinerëve kanë të dhëna të plota në databazën e LIMS.
- Nga 58 pozicione pune për të cilët janë paraqitur të dhënat, 15 prej tyre nuk kanë numër telefoni në sistem.
- Fusha Ëork Postion, ka disa qeliza që duhet të kenë përshkrimin e punës. Edhe pse janë pa përshkrim pune, këto pozicione pune me user ID përkatës: "13,43,42,17,48" janë aktive dhe kanë numër telefoni.
- Përdoruesit me user: "*admin, super admin dhe suadim"* janë usera në të cilët nuk janë përcaktuar personat përgjegjës që i përdorin. Gjithashtu këta 3 usera kanë akses për kryer çdo lloj veprimi në databazë.
- Punonjësja Ederina Ninga me user "eninga" është larguar nga puna më datë 01.01.2021 por u konstatuase është loguar në sistem më 14.04.2021 ose katër muaj pasi është larguar nga puna. Ndërsa punonjësja Blerina Korra me user "bkorra" ka marrë akseset e sistemit LIMS me detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse, por nuk e ka përdorur asnjëherë sistemin.
- Punonjësit të cilët janë larguar, shfaqen në menunë Staf edhe pse janë të çaktivizuar. Gjithashtu të dhënat dhe veprimtaria e tyre duhet të ruhen edhe pasi të largohen për një periudhë kohe sipas ligjit të dokumentit elektronik.

19.1. Rekomandimi: ISUV të marrë masa për analizimin e situatës aktuale në lidhje me integritetin dhe plotësinë e të dhënave që përmbajnë sistemet informatike të LIMS duke përcaktuar edhe shkaqet prej të cilëve rrjedhin problematikat e konstatuara. Të merren masat e nevojshme për ngritjen dhe implementimin e mekanizmave të kontrollit dhe validimit të inputit të sistemeve informatike, duke përcaktuar tipin e të dhënave që mund të plotësojnë përdoruesit në përputhje me formatin dhe informacionin që përmban secila prej fushave, me qëllim parandalimin e përsëritjes së problematikave të konstatuara.

Nga auditimi rezulton që: ISUV nuk ka analizuar situatën në lidhje me integritetin dhe plotësinë e të dhënave që përmbajnë sistemi informatikë LIMS. Nuk ka marrë masat për ngritjen dhe implementimin e mekanizmave të kontrollit dhe validimit të inputit të sistemeve informatik.

Rekomandimi nuk është zbatuar

19.2 Rekomandimi: ISUV të marrë masa për plotësimin e sistemit LIMS me të dhënat që mungojnë për çdo përdorues, të ndërtojë kontrolle për mbylljen e përdoruesve në kohën e duhur, të mbyllë përdoruesit të cilët kanë përfunduar objektin e krijimit, me qëllim ruajtjen e sistemit nga ndërhyrjet e paautorizuara.

Nga auditimi rezulton që: ISUV nuk ka marrë masa për plotësimin e sistemit LIMS me të dhënat që mungojnë për çdo përdorues, nuk ka ndërtuar kontrolle për mbylljen e përdoruesve në kohën e duhur.

Rekomandimi nuk është zbatuar

19.3. Rekomandimi: ISUV të marrë masa për ndërtimin e mekanizmave të kontrollit për dokumentimin dhe miratimin fizik të ndryshimeve të lejuara për përdoruesit, për të cilat nuk gjenerohet një gjurmë elektronike auditimi.

Nga auditimi rezulton që: ISUV nuk ka marrë masa për ndërtimin e mekanizmave të kontrollit për dokumentimin dhe miratimin fizik të ndryshimeve të lejuara për përdoruesit.

Rekomandimi nuk është zbatuar

19.4. Rekomandimi: ISUV të marrë masa që të mos shfaqen në ndërfaqen Web të LIMS, punonjësit e larguar nga puna ose punonjës të cilët kanë ndryshuar pozicionin e punës dhe iu është hequr aksesi nga sistemi LIMS, por të ruhet veprimtaria e tyre në data bazë e sistemit.
Nga auditimi rezulton që: ISUV nuk ka marrë masa për mos shfaqen në ndërfaqen Web të LIMS, punonjësit e larguar nga puna ose punonjës të cilët kanë ndryshuar pozicionin e punës dhe iu është hequr aksesi nga sistemi LIMS

Rekomandimi nuk është zbatuar

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në sistemin LIMS u konstatua se:
- Ky sistem nuk të jep mundësinë e filtrimit dhe gjenerimit të raporteve.
-Nuk ka eksport për të dhënat (informacionet) jep vetëm total rekordesh.
Mungesa e gjenerimit të raporteve sjell pamundësinë e monitorimit të sistemit, mospërdorimin e data bazës për analizime statistikore dhe raportime javore ose mujore në varësi të nevojave të institucionit, si dhe mungesën e politik bërjes specifike sipas rajoneve, grupeve ushqimore, grup kafshësh, etj.
20.1. Rekomandimi: ISUV të kërkojë tek OE përmbushjen e funksionaliteteve që mungojnë, për gjenerimin e raporteve javore, mujore sipas nevojave të institucionit, analizime statistikore dhe monitorimin e veprimtarisë së sistemit LIMS.
Nga auditimi rezulton që: ISUV nuk ka marrë masa për t'i kërkuar OE, gjenerimin e raporteve javore, mujore sipas nevojave të institucionit, analizime statistikore dhe monitorimin e veprimtarisë së sistemit LIMS..

Rekomandimi nuk është zbatuar

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se politikat e vendosjes se fjalëkalimeve në sistemin LIMS nuk janë në përputhje me "*Kërkesat e Sigurisë*" përshkruar në "*Rregulloren për Administrimin e Fjalëkalimeve në Rrjetet dhe Sistemet Kompjuterike*", miratuar me Urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK)*;*
21.1. Rekomandimi: ISUV të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullores, për përdoruesit e sistemit LIMS ku të identifikohen qartë:
- rregullat e monitorimit,
- politikat e implementuara për fjalëkalimet e administrimit dhe përdoruesit fundor
- të dhënat e detyrueshme që nevojiten të plotësohen për çdo përdorues
- të dhënat e pandryshueshme për secilin prej tyre,
- ndalimin e krijimit të më shumë se një përdoruesi për punonjës
- ndalimin e krijimit të një përdoruesi të ri për punonjësin ekzistues.

Nga auditimi rezulton që: ISUV nuk ka marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullores, për përdoruesit e sistemit LIMS.

Rekomandimi nuk është zbatuar

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, pavarësisht se databaza e sistemit LIMS është miratuar si databazë shtetërore ISUV nuk ka ndërmarrë hapa të mëtejshme për ndërveprimin e saj me databazat e institucioneve të tjera.
22.1. Rekomandimi: ISUV me qëllim rritjen e efektivitetit të ndërsjellët të të dhënave që mbahen në sistemin LIMS në bashkëpunim me AKSHI-n dhe MBZHR të identifikojnë fushat e ndërveprimit të databazës LIMS me databazat e institucioneve të tjera për arritjen e ndërveprimit në fushat e interesit reciprok.

Nga auditimi rezulton që ISUV i ka kërkuar MBZHR përmirësim, mirëmbajtje dhe ndërveprim me databazat e institucioneve të tjera për arritjen e ndërveprimit në fushat e interesit reciprok.

Rekomandimi është në proces zbatimi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, të dhënave shtetërore të sistemit LIMS në ISUV, administrohen nga OE që kryen mirëmbajtjen e këtij sistemi, në mungesë të plotë dokumentacioni dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 10325, "*Për bazat e të dhënave shtetërore"*, neni 5: "*Rregulloret për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore përcaktohen nga institucioni administrues dhe miratohen nga titullari i tij, në përputhje me standardet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara sipas nenit 10 të këtij ligji*"
dhe VKM nr. 673, pika 6/y "*Regjistrat e të dhënave të këtyre institucioneve që përbëhen nga bazat e të dhënave mbeten nën administrim të institucioneve respektive*"**.**
Detyrat janë përcaktuar verbalisht në mungesë të plotë dokumentacioni për konfigurimet dhe indeksimet që janë ndërtuar për mirëfunksionimin e saj, si dhe në mirëbesim për ndërhyrjet e pa monitoruara nga ISUV, çfarë përbën risk shumë të lartë të gabimeve njerëzore apo të qëllimshme dhe ndërprerjen e punës si dhe më e rëndësishmja situata aktuale nuk të jep mundësinë të identifikohet përgjegjësi. ISUV nuk ka një përfaqësues, i cili mund të monitorojë ecurinë e mirëmbajtjes së sistemit.
23.1. Rekomandimi: Niveli drejtues në ISUV si institucion përgjegjës dhe administrues i të dhënave shtetërore të sistemit LIMS, të marrë masa për përmbushjen e këtij detyrimi me strukturë të posaçme për administrimin dhe mbrojtjen e të dhënave.
Nga auditimi rezulton që: ISUV nuk ka marrë masa për administrimin e të dhënave shtetërore të sistemit LIMS, të cilat administrohen nga OE që kryen mirëmbajtjen e këtij sistemi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurën e prokurimit "*Mirëmbajtjen e sistemit LIMS*", grupi auditimit analizoi komponentët e përshkruar në raportet e mirëmbajtjes mbi operimin e këtyre komponentëve onsite në sistem.
Nga auditimi onsite në sistem u konstatua se nga 13 komponentë në total të përshkuara dhe kërkuara në kontratën e mirëmbajtjes së sistemit LIMS**,** 7 (shtatë) prej këtyre komponentëve **n**uk janë të implementuara. Për këto komponentë Autoriteti Kontraktor ka kryer pagesa sipas raporteve dhe faturave të paraqitura nga Kontraktori (OE) (A. Shpk), me vlerën 1,704,000 Lekë., vlerë e cila përbën dëm ekonomik ndaj Buxhetit të Shtetit.
1.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të mundësuar arkëtimin e shumës 1,704,000 lekë e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit pasi është përfituar padrejtësisht nga Kontraktuesi A. sh.p.k.
Nga auditimi rezulton që: ISUV me anë të 3 shkresave ka kërkuar OE A. Shpk kthimin e shumës 1,704,000 lekë e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit. Operatori ekonomik A. shpk ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 70 prot. datë.18.01.2022, të cilën e ka nisur për dijeni edhe pranë KLSH-së, ku kundërshton gjetjen e grupit të auditimit. ISUV nuk ka ndërmarr hap ligjor për arkëtimin e shumës 1,704,000 lekë e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit pasi është përfituar padrejtësisht nga Kontraktuesi A. sh.p.k.

Rekomandimi është në proces zbatimi

Në vijim do të gjeni më mënyrë të detajuar situatën mbi zbatimin e rekomandimeve në Posta Shqiptare sh.a, në bazë të Programit të Auditimit nr.609/1 prot, datë 16.06.2022.

Në zbatim të pikave 1-4 të Programit të Auditimit "*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e dytë të vitit 2021*" në Posta Shqiptare sh.a.

Objekti i këtij auditimi është: Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e mëparshme me shkresën nr. *877/36 prot, datë 03.02.2022* drejtuar Postës Shqiptare.
Nga verifikimi i dokumentacionit, për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:
Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 58 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 52 masa dhe nuk janë pranuar 6 masa. Nga masat e pranuara situata në lidhje me rekomandimet rezultoi se: janë zbatuar 8 masa, janë në proces zbatimi 40 masa organizative, janë zbatuar pjesërisht 2 masa organizative, nuk janë zbatuar 2 masa organizative.

Përmbledhëse e masave të pranuara në %

Nga 52 masat e pranuara	Nr.	%
Zbatuar	8	15.4
Zbatuar pjesërisht	2	3.8
Në proces	40	76.9
Nuk janë zbatuar	2	3.8

2. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".
Posta Shqiptare me shkrese nr. 1667/69, datë. 25.02.2022 ka dërguar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit planin e veprimit, për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, për periudhën 01.07.2017 deri në 31.05.2019. (urdhër nr. 38, datë. 25.02.2022 Administratori i shoqërisë urdhëron të gjitha drejtoritë përkatëse për plotësimin dhe zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga raporti final i auditimit).

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
Posta Shqiptare nuk ka dërguar dokument shkresor pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"

4. Realizimi i rekomandimeve, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Posta shqiptare Sha, nuk ka plan strategjik institucional të miratuar me qëllim përcaktimin e prioriteteve dhe objektivave institucionale. Gjithashtu u konstatua se nuk ka një plan strategjik të shkruar e miratuar mbi teknologjinë e informacionit duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë institucionale dhe infrastrukturën IT si dhe duke mos pasqyruar qartë objektivat lidhur me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e objektivave. Mungesa e planifikimeve strategjike institucionale mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Postës.

1.1 Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sha, duke marrë në konsideratë rëndësinë e shërbimeve postare dhe financiare që ofron shoqëria si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni zotëron dhe përpunon me qëllim përcaktimin e objektivave dhe adresimin e burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Postës, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e Planit Strategjik Institucional ku të përfshihet edhe planifikimi strategjik mbi teknologjinë e informacionit dhe ku të adresohen qartë objektivat e institucionit duke reflektuar ndryshimet institucionale, strukturore dhe ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndodhura ndër vite në Postën Shqiptare. Gjithashtu organet drejtuese të Postës Shqiptare Sha të marrin masa për përcaktimin e elementëve dhe indikatorëve të matshëm për matjen e plotësimit të objektivave të përcaktuara.

Nga auditimi rezulton se: në dokumentacionin që I është vënë në dispozicion grupit të auditimit është hartuar relacioni mbi ppërcaktimin e produkteve dhe shërbimeve në TIK që ndihmojnë arritjen e objektivave institucional. Meqenëse hartimi I mëtejshëm do të mbështetet në këtë relacion, ky rekomandim do të konsiderohet në process pasi ka filluar zbatimi i tij.

Rekomandimi është në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Rregullorja e Brendshme, "*Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a*" miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të Posta Shqiptare nuk është përshtatur (*amenduar*) duke mos reflektuar ndryshimet institucionale të ndodhura ndër vite në Posta Shqiptare, konkretisht:

- Në rregulloren e brendshme të Posta Shqiptare Sh.a. detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara jo në mënyrë të detajuar. Në përcaktimin e kompetencave të drejtorit të IT dhe zhvillimit, në rregulloren e brendshme "*Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a*" ka mbivendosje të këtyre kompetencave, pasi disa prej tyre tejkalojnë nivelin hierarkik të drejtorit të drejtorisë. Për shembull në pikën 16 të rregullores së brendshme ku përcaktohen detyrat dhe kompetencat e drejtorit të IT dhe zhvillimit, ku citohet se drejtori i IT "*Përcakton, zhvillon dhe përsos më tej strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të automatizimit të Posta Shqiptare SH.A*", drejtori i IT, merr përgjegjësitë e Administratorit.

Në disa raste përgjegjësi i sektorit të sistemeve ka më shumë atribute se sa drejtori i drejtorisë, për shembull në pikën 2, të Detyrave dhe Përgjegjësive të përgjegjësit të sektorit dhe sistemeve. Kjo problematikë haset edhe në sektorët e tjerë ku ka raste që kalojnë kompetencat hierarkike.

- Në disa raste konstatohet se mungojnë përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësive për disa funksione që janë në strukturën organizative, por nuk gjenden të reflektuara në rregulloren e brendshme të funksionit të administratës qendrore.

2.1 Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sha dhe strukturat këshilluese mbi IT, të hartojë, amendojë dhe miratojë, rregulloren e brendshme, "*Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare Sha"*, me qëllim

reflektimin e ndryshimeve institucionale, strukturore dhe ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndodhura ndër vite në shoqëri. Hartimi i kësaj Rregulloreje të marrë në konsideratë vendosjen e kontrolleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme aktuale si dhe me legjislacionin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Shqipëri.
Nga auditimi rezulton se: Nga verifikimi i dokumentacionit vënë në dispozicion për zbatimin e këtij rekomandimi vlerësojmë se rekomandimi është iniciuar, por ende nuk ka përfunduar duke qenë se ndryshimet në rregulloren "*Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare Sha"*, nuk janë miratuar.

Rekomandimi është në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi: Gjatë fazës së auditimit në terren grupi i auditimit administroi një sërë rregulloresh dhe manualesh, të tjera nga ku u konstatua se institucioni administron dhe ka në përdorim një bazë rregullative, konkretisht:

- Rregullore mbi veprimtarinë operacionale;
- Rregullore për lidhjen në distancë (Remote Access);
- Rregullore për Transparencën;
- Log management user and administration manual;
- Përdorimi i e-mail në smart phone;
- Si të ndërrohet password në kompjuterin e punës në zyrë dhe nga faqja e web.

Nga auditimi u konstatua se këto dokumente nuk janë të miratuara nga asnjë prej organeve drejtuese të Posta Shqiptare.Ato i janë paraqitur grupit të auditimit si përgjigje ndaj pyetësorit dhe përdorën si bazë rregullatore nga administrata e Postës, pavarësisht se nuk janë të miratuara.
3.1 Rekomandimi: Organet drejtuese në Posta Shqiptare Sh.a, të marrin masa për miratimin e këtyre rregulloreve dhe amendimin e tyre me qëllim reflektimin e ndryshimeve institucionale, strukturore dhe ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndodhura ndër vite në shoqëri.
Nga auditimi rezulton se: me urdhrin nr.217 datë 06.07.2022, janë miratuar nga Administratori rregulloret dhe pritet të miratohen në mbledhjen e rradhës në Këshillin Mbikëqyrës.

Rekomandimi është në proces zbatimi

4.1 Gjetje nga auditimi: Nga administrimi dhe auditimi i bazës rregullatore si: Politikat e përdorimit dhe sigurisë së sisteme TIK (*shkresa 1952/2, datë 19.08.2008*); Analiza e riskut për sistemet TIK (*shkresa nr. 1952/2, datë 19.08.2008*); Standardi i menaxhimit të problemeve dhe incidenteve (*shkresa 1952/2, datë 19.08.2008*); Procedurat e sigurimit të Postës Shqiptare (*shkresa 3678, datë 16.11.2006*); u konstatua se kjo bazë rregullatorë nuk ka reflektuar ndryshimet institucionale të ndodhura ndër vite dhe ndryshimet në investime në fushën e teknologjisë së informacionit në Postën Shqiptare. Disa nga dokumentet e mësipërme mbajnë të njëjtën datë dhe numër protokolli në kundërshtim me nenet 36-41 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat". Aktualisht këto rregullore janë ende në përdorim nga administrata e Postës.
4.2 Gjetje nga auditimi: Nga administrimi i "Rregullores mbi procedurat e backup-it të Posta Shqiptare Sh.A" miratuar me shkresën nr. 583/1, datë 25.02.2019, të drejtorit të sigurisë dhe cilësisë u konstatua se kjo rregullore është nënshkruar jo nga organet drejtuese të Posta Sh.A, por nga një nivel menaxherial që nuk ka kompetenca juridike për nënshkrimin dhe nxjerrjen e akteve administrative institucionale, në kundërshtim me nenet 7, 11 dhe 14 të Statutit të Shoqërisë Posta Shqiptare.

4.3 Gjetje nga auditimi: Nga administrimi i Rregullores "*Për Administrimin e Rrezikut Operacional*" u konstatua se kjo rregullore është miratuar dy herë brenda vitit. Kjo rregullore është miratuar me shkresën nr. 583/2, datë 25.02.2019, të administratorit të shoqërisë, e cila ka shfuqizuar rregulloren nr.1579, datë 31.08.2011 "*Për administrimin e rrezikut operacional*". Nga auditimi u konstatua se kjo rregullore është miratuar edhe me shkresën nr. 2144, datë 09.08.2019 të administratorit të Postës, e cila është e njëjtë në përmbajtje por nuk ka shfuqizuar rregulloren me shkresën nr. 583/2, datë 25.02.2019. Kjo gjë sjell konfuzion në përdorim dhe në zbatim të këtij dokumenti nga administrata sepse në disa raste i referohen rregulloreve të ndryshme.

4.1 Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a dhe strukturat këshilluese mbi IT, të hartojnë, amendojnë dhe miratojnë, aktet rregullative të cituara më lart në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore me qëllim reflektimin e ndryshimeve institucionale, strukturore dhe ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndodhura ndër vite në Postën Shqiptare.

Gjatë hartimit dhe miratimit të tyre të respektohen rigorozisht përcaktimet ligjore për arkivat në Republikën e Shqipërisë.

Nga auditimi rezulton se: me urdhrin nr.217 datë 06.07.2022, janë miratuar nga Administratori rregulloret dhe pritet të miratohen në mbledhjen e rradhës në Këshillin Mbikëqyrës.

Rekomandimi është në proces zbatimi

5.1 Gjetje nga auditimi: Për vitin 2021 struktura e sektorit të sistemeve në Drejtorisë së IT-së dhe Zhvillimit është e paplotësuar sipas strukturës organike të përcaktuar. Gjatë periudhës së auditimit ka patur 3 (tre) largime të stafit IT 2 (dy) prej të cilave janë zëvendësuar me lëvizje brenda përbrenda Drejtorisë, dhe 3 (tre) pozicione janë zëvendësuar me staf të ri.

Nga auditimi u konstatua se mungojnë përshkrimet e punës për stafin e Drejtorisë së IT dhe Zhvillimit mbi mënyrën dhe ndarjen e përgjegjësive specifike të roleve, punëve dhe veprimeve operacionale brenda drejtorisë, në mospërputhje me përcaktimet në nenin 4 pika 20, neni 20 pika c dhe neni 22 pika b të ligjit nr.10 296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar.

5.2 Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi u konstatua se Posta Shqiptare, nuk ka plan trajnimi vjetor për vitet 2019-6-mujori i parë i vitit 2021 për burimet njerëzore të drejtorisë së Teknologjisë e Informacionit dhe Zhvillimit. Nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre. Mbështetur në rregulloren për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SH.A, është detyrë dhe kompetencë e niveleve menaxheriale propozimi dhe hartimi i kërkesave për trajnime.

5.1 Rekomandimi: Administratori i Përgjithshëm i Postës Shqiptare Sh.a në bashkëpunim me Departamentet përkatëse në Posta Sh.A dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrin masa për menaxhimin e burimeve njerëzore, me qëllim adresimin e përgjegjësive dhe përcaktimin e detyrave si dhe plotësimin e vendeve vakante sipas strukturës organike. Gjithashtu të marrin masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit IT dhe të çdo përdoruesi të sistemeve TIK si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

Nga auditimi rezulton se: meqenëse është miratuar struktura e re dhe drejtoria e burimeve njerëzore në bashkëpunim me drejtorinë e IT ka komunikuar nëpërmjet postës elektronike me firmën zhvilluese, si dhe me filialet për zhvillimine trajnimeve të stafit, ky rekomandim konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces zbatimi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ndërtimin dhe organizmin e strukturës së Posta Shqiptare Sh.a. u konstatua se Sektori i Sigurisë së Informacionit është në varësi të Drejtorisë së Sigurisë dhe Cilësisë pjesë e Departamentit të Zhvillimit dhe Standardeve. Ky sektor ka qenë nën varësinë e Drejtorisë TIK dhe që prej vitit 2018 ka kaluar në varësinë e Drejtorisë së Sigurisë dhe Cilësisë. Ndër detyrat dhe përgjegjësitë të përcaktuara në rregulloren e brendshme të këtij sektori përcaktohet kryerja e auditimit të rrjetit dhe sistemeve, gjetja e dobësive në sisteme si dhe shqyrtimi i raporteve të auditit të sistemeve, detyrë kjo e cila sjell mbivendosje të kompetencave me auditin IT. Një ndër detyrat e përcaktuara për Specialistin e Sektorit të Sigurisë së Informacionit është "*sigurimi që të jenë zhvilluar dhe zbatuar procedurat standarde, udhëzimet e sigurisë dhe masat që mbështesin sigurinë e të gjithë rrjetit dhe sistemeve si dhe të gjithë komponentët e rrjetit*".
Nisur nga shtrirja e teknologjisë së informacionit në institucion si dhe nga rëndësia e të dhënave që ruhen dhe përpunohen nga Sektori i Sigurisë së Informacionit dhe ofrimit të shërbimeve postare dhe financiare me anë të sistemit informatik "*Eterna*", gjykojmë se organizimi i kësaj strukture nën Drejtorinë e Sigurisë dhe Cilësisë, nuk i përgjigjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit në Postën Shqiptare.
6.1 Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a dhe strukturat këshilluese mbi IT, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme të analizojnë mundësinë e ndryshimeve strukturore të strukturës ekzistuese IT me qëllim rritjen e rolit të saj dhe të marrin masa për pozicionimin e Sektorit të Sigurisë së Informacionit në varësi të Drejtorisë së IT-së dhe Zhvillimit me qëllim përmbushjen në mënyrë sa më efektive të objektivave sektoriale dhe koordinimin e aktivitetit të saj me sektorët e tjerë që janë pjesë e të njëjtës fushë duke sjellë rritjen e ndikimit të IT-së në qeverisjen e Postës Shqiptare.
Nga auditimi rezulton se: është miratuar struktura e re me vendimin nr. 14, datë 09.12.2022 të Këshillit Mbikqyrës "Mbi ndryshimin e strukturës se adminsitrates se Postes Shqiptare, ku sektori i sigurisë së informacionit është pozicionuar nën Drejtorinë IT dhe Sigurisë.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht

7.Gjetje nga auditimi: Nga administrimi i dokumentacionit se si Posta Shqiptare, identifikon dhe menaxhon risqet institucionale dhe risqet në teknologjinë e informacionit, u konstatua se Posta Shqiptare nuk disponon regjistër risku të përgjithshëm institucional, ku të përfshihen edhe risqet mbi IT dhe të mbulohen të gjithë aktivitet duke përfshirë këtu risqet mbi sistemet Eterna, IPS, CDS, proceset e menaxhimit të ndryshimit, etj. Shoqëria Posta Shqiptare nuk ka identifikuar dhe vlerësuar ngjarjet e mundshme që mund të kenë efekte negative përsa i përket arritjes së objektivave institucionale.
Nisur sa më sipër rezulton se shoqëria Posta Shqiptare nuk ka hartuar regjistrin e riskut ku të përfshiheshin edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit, kjo mbështetur në nenin 11, pika 2, neni 12 pika 3/d dhe nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 21, datë 25.10.2016 "Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve", UMF nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike".
7.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë në bashkëpunim me Drejtorët e Departamenteve të marrin masa për identifikimin dhe hartimin e regjistrit të riskut me qëllim analizimin dhe vlerësimin e risqeve, për të mos riskuar përmbushjen e objektivave të shoqërisë në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, në të cilin të përcaktohen edhe risqet në teknologjinë e informacionit. Gjithashtu të marrin masa për hartimin dhe dokumentimin e një plani veprimi

për minimizimin/ parandalimin e risqeve të identifikuara, si dhe të bëhet monitorimi periodik i zbatimit të këtyre masave.
Nga auditimi rezulton se: është miratuar me urdhër nr. 91 datë 22.06.2022 është miratuar formati i regjistrit i identifikimit të risqeve. Njësia e menaxhimit të riskut ka identifikuar dhe problematikat sektorin e IT.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht

8.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:
Gjatë vizitës on site të zhvilluar nga grupi i auditimit në dhomën e serverave që ndodhet në zyrat qendrore pranë Postës Shqiptare Sha u konstatua:

- Ambienti nuk ka të instaluar një sistem akses kontrolli i cili garanton hyrjen e personave të autorizuar;
- Nuk ka një rregullore të miratuar për personat e autorizuar që mund të hyjnë në dhomën e serverëve;
- Kabllimet dhe lidhjet e rrjetit në sëitch dhe patch panel nuk janë të sistemuar;
- Në paradhomën e serverëve në të cilën janë të vendosur sistemi UPS dhe paneli elektrik, sistemi i kondicionimit ishte jashtë funksionit, kishte prani të lagështirës dhe hyrja në këtë ambient ishte e përbërë nga derë vetratë duralumini, faktor i cili ul nivelin e sigurisë në dhomën e serverëve;
- Nuk ka një plan testimi të sensorëve të zjarrit si dhe mirëmbajtje për sistemin elektrik dhe sistemin backup UPS;
- Nuk bëhen kolaudime për sistemin Antizjarr;
- Nuk ka të instaluar BMS (Building Managment System).

8.2 Gjetje nga auditimi: Gjatë vizitës onsite të zhvilluar nga grupi i auditimit në këtë site u konstatua:

- Largësia dhe pozicionimi i site-it DRC nuk përputhet me përcaktimet ligjore që parashtrojnë kushtet dhe distancën e ndërtimit të një DRC-je;
- Nuk ka një rregullore të miratuar për personat e autorizuar që mund të hyjnë në dhomën e serverëve;
- Nuk është instaluar akses kontrolli për të kontrolluar dhe monitoruar hyrjet dhe daljet e personave në ambientin e DRC. Hyrja në këtë ambient realizohet duke hapur derën me çelës;
- Nuk kishte sensorë për matjen e temperaturës dhe lagështirës;
- Sistemi i kondicionimit nuk ishte efektiv pasi për të arritur ftohjen e duhur të serverëve përdoreshin pajisje të tjera ndihmese, si freskuese;
- Muret e dhomës së serverave në site-in DRC nuk garantojnë sigurinë fizike, nuk janë të izoluara nga zhurmat, nxehtësia dhe nuk ka skermo kundër emetimeve të valëve elektromagnetike (Kafazi Faraday).

8.1 Rekomandimi: Posta Shqiptare Sh.a të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomës të serverave në bazë të rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve (*versioni 1.0, datë 02.12.2008*) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK si dhe në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim ruajtjen e sigurisë fizike të ambienteve të infrastrukturave kritike.
Nga auditimi rezulton se: megjithëse nuk është realizuar ende ky zhvillim, kërkesa është renditur dhe ka marrë miratim nga MIE ku në programin ekonomik është parashikuar të realizohet në vijim.

Rekomandimi është në proces zbatimi

9.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

Krijimi, mirëmbajtja dhe menaxhimi i përdoruesve të sistemit Eterna Financiare realizohet nga Sektori i Aplikimit & Administrimit të Dhënave, detyrë kjo e atribuar pa një shkresë zyrtare nga organet drejtuese të shoqërisë së Postës Shqiptare sh.a.
-Administratorin e sistemeve eterna postar dhe financiar si dhe IPS *(International Postal System)* dhe CDS *(Custom Declaration System)* e ushtron përgjegjësi i sektorit të aplikimit dhe administrimit të të dhënave në drejtorinë IT dhe zhvillimit. Detyra e Administratorit të sistemit eterna i është atribuuar pa asnjë shkresë zyrtare nga organet drejtuese të shoqërisë. Pavarësisht se nuk është e emëruar zyrtarisht si Administratore sistemi, ajo ushtron të gjitha detyrat e administratorit të sistemit. "*Administratori i Përgjithshëm*" i sistemit Eterna që ka të drejta universale është kompania H. e cila ka ndërtuar dhe zhvilluar sistemin Eterna.
-Atributet dhe rolet e userave në sistemin Eterna Postar dhe Financiar nuk janë të përcaktuara sipas detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara në rregulloren e brendshme administrative por sipas funksionaliteteve që punonjësi ushtron në praktikë përgjatë procesit të punës.
- Për periudhën objekt auditimi, Posta Shqiptare sh.a. nuk disponon një akt rregullativ për administrimin e përdoruesve të Sistemit Eterna Financiare dhe Eterna Postare në të cilin të përcaktohen procedurat që do të ndiqen për administrimin e përdoruesve.
Nuk dokumentohet në asnjë formë krijimi, ndryshimi, mbyllja dhe fshirja e përdoruesve, por i gjithë procesi administrohet nëpërmjet komunikimit sipas rastit me email. Kërkesat për krijim/aktivizim/çaktivizim apo modifikim të përdoruesve (*ndryshim i zyrës së aksesit apo i profilit të të drejtave*) realizohen me email në dijeni nga Drejtoritë e Shërbimeve përkatëse, ose nga shefja e shërbimit në filialin përkatës apo specialistet e shërbimit.
Ndërsa në sistemin IPS për krijimin e një përdoruesi është kusht krijimi më parë i userit në domain, pastaj krijimi i login-it në bazën e të dhënave i tipit 'Ëindoës Authentication".
9.2 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dhënat mbi përdoruesit u konstatuan raste për të cilat "loginID" është e ndryshme nga "fullname", duke sjellë risk të lartë për ndërhyrje të paautorizuara në sistem si dhe duke mos lënë gjurmë se cili punonjës ka kryer një veprim të caktuar.
9.1 Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a të marrin masa për hartimin dhe miratimin e rregulloreve përkatëse për funksionimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit që ka në përdorim institucioni, me qëllim pasqyrimin e saktë të përgjegjësive, detyrave dhe të drejtave për menaxhimin e përdoruesve të këtyre sistemeve. Në rregullore të përcaktohet edhe politika për menaxhimin e gabimeve njerëzore dhe teknike në lidhje me përdorimin e sistemeve të IT.
Nga auditimi rezulton se: me urdhrin nr.217 datë 06.07.2022, janë miratuar nga Administratori rregulloret dhe pritet të miratohen në mbledhjen e rradhës në Këshillin Mbikëqyrës.

Rekomandimi është në proces zbatimi

9.2 Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a të marrin masa për përcaktimin e administrator-it/ëve të sistemeve të teknologjisë së informacionit që Posta Sh.a ka në përdorim me qëllim përcaktimin e përgjegjësive dhe të drejtave të administratorit të sistemeve IT.
Nga auditimi rezulton se: janë përcaktuar administratorët e sistemeve TIK.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përdoruesit e sistemit Eterna Financiare dhe Eterna Postare u konstatua se:
- Nuk janë aplikuar në sistem kritere të detyrueshme për rritjen e sigurisë së fjalëkalimit si: fjalëkalim i ndryshëm nga përdoruesi, gjatësia, përfshirja e karaktereve speciale apo numrave

si dhe periodiciteti për ndryshimin e tij, me qëllim rritjen e sigurisë në identifikimin e përdoruesit;
- Nuk janë dokumentuar në asnjë formë politikat e implementuara për përdoruesit fundor të sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten në fjalëkalimin e tyre të aplikohen, bazuar në pikën 4 "*Kërkesat e Sigurisë*" pika a. të rregullores për "*Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike*" miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.
- Nuk janë dokumentuar në asnjë formë politikat e implementuara për fjalëkalimet e sistemeve qendrore dhe administrimit bazuar në pikën 4 "*Kërkesat e Sigurisë*" pika b, të rregullores për "*Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike*" miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.
-Përdoruesit e rinj nuk aktivizohen automatikisht, nëse opsioni "Aktiv" nuk është zgjedhur, çfarë parandalon së pari veprime të tjera operacionale, por dhe si një veprim i shpeshtë i cili duhet të jetë standard.
-Nuk janë aplikuar në sistem kritere të detyrueshme për rritjen e sigurisë së fjalëkalimit si: fjalëkalim i ndryshëm nga përdoruesi, gjatësia, përfshirja e karaktereve speciale apo numrave si dhe periodiciteti për ndryshimin e tij, me qëllim rritjen e sigurisë në identifikimin e përdoruesit.
10.1.Rekomandimi: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit të marrë masa për adresimin e çështjeve të konstatuar nga grupi i auditimit, me qëllim rritjen e sigurisë së identifikimit të përdoruesit si: fjalëkalim i ndryshëm nga përdoruesi, gjatësia, përfshirja e karaktereve speciale apo numrave si dhe periodiciteti për ndryshimin e tij, me qëllim rritjen e sigurisë në identifikimin e përdoruesit. Të merren në konsideratë praktikat e përcaktuara në rregulloren për "*Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike*" miratuar nga AKCESK.
Gjithashtu, të aktivizohen automatikisht:
-Opsioni "Aktiv" për përdoruesit e rinj, çfarë parandalon së pari veprime të tjera operacionale, por dhe si një veprim i shpeshtë i cili duhet të jetë standard.
-Ndryshimi i fjalëkalimit me forcë nëpërmjet opsionit "Ndrysho fjalëkalimin në log-imin e radhës", as në rastet kur fjalëkalimi gjenerohet në mënyrë automatike si emri i përdoruesit për përdoruesit e rinj.
Nga auditimi rezulton se: me urdhrin nr.217 datë 06.07.2022, janë miratuar nga Administratori rregulloret dhe pritet të miratohen në mbledhjen e rradhës në Këshillin Mbikëqyrës.

Rekomandimi është në proces zbatimi

11.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përdoruesit e Sistemit Eterna Financiare u konstatua se:
- Fusha "user_id" është në formë progresiv rritës, por jo i vazhdueshëm dhe pa ndërprerje, e cila mund të na tregojë se janë fshirë përdorues nga sistemi. Nga verifikimi i përdoruesve në sistem u konstatua se mungojnë 25 "user_id" të përdoruesve. Mungesa e këtyre Id-ve tregon se këto user-a janë fshirë. Nga auditimi u konstatua se për këto veprime nuk është mbajtur asnjë dokument justifikues për fshirjen e këtyre userave.
-Mbajnë statusin "aktiv" përdorues të cilët nuk kanë asnjë marrëdhënie pune me Posta Shqiptare Sh.a, gjithashtu janë aktiv në sistem dhe punonjës që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Postën Shqiptare.
-Në të dhënat mbi përdoruesit rezultojnë 5 raste për të cilat ekziston user i përsëritur.
-Nuk është respektuar i njëjti standard në krijimin e "username" dhe "fullname" ku pjesa më madhe është krijuar me emër.mbiemër për "username" dhe Emër Mbiemër për "fullname". Në shumë raste ky model nuk është ndjekur dhe rezultuan 57 raste të përdoruesve për të cilët "fullname" është me gërma kapital;

-Emri i plotë “fullname” në disa raste është plotësuar me nga një prapashtesë “GABIM”, “GABIMM”, “_gabim” ose me emër qyteti. Rezultojnë 8 raste me prapashtesën “GABIM”, 1 rast me prapashtesën “GABIMM”, 1 rast me prapashtesën “_gabim”;
-Për “fullname” të përdoruesit rezultojnë 8 raste kur vetëm mbiemri është me gërma kapitale, 3 raste kur emri fillon me germë të vogël, 1 rast kur emri dhe mbiemri fillon me germë të vogël dhe 2 raste kur mbiemri nuk fillon me germë kapitale;
-Rezultojnë 46 përdorues për të cilët “username” dhe “fullname” kanë të njëjtin format emër.mbiemër, si dhe për 2 përdorues “username” është vendosur si standardi i “fullname” dhe “fullname” si standardi i përdorur për “username”;
-Rezultojnë 38 usera të pa identifikuar për financat e filialeve, për këto përdorues është përdorur standard financa.emri filialit si për fushën “username” dhe “fullname”. 1 rast prej të cilave është i përsëritur. Nga verifikimi i të dhënave mbi përdoruesit rezultojnë user të pa identifikuar. Raste për user-at “burimetraporte”, “ana.test” dhe “eposta”, si dhe për user-at “user2” , “test” , “usertest”, “menaxhertest” për të cilët atributi “last_login” është NULL.
Rezultojnë 298 user-a të cilët atributin e “last_login” e kanë NULL, fakt i cili tregon se për këto user-a është fshirë gjurma e veprimeve të fundit që kanë kryer në sistem.
11.2 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përdoruesit e Sistemit Eterna Postare u konstatua se:
- fusha “user_id” nuk është e strukturuar në formë progresive rritëse e cila tregon se mund të jenë fshirë të dhëna nga sistemi dhe sjell risk për kompromet imin e të dhënave dhe humbjes së gjurmës audituese;
- mbajnë statusin “aktiv” përdorues të cilët nuk kanë asnjë marrëdhënie aktive me Postën Shqiptare sh.a.
- emri i plotë “fullname” në disa raste është plotësuar me një prapashtesë me emër qyteti ose fshati. Rezultojnë 12 raste me prapashtesën _PE, Ulez, (Klos), Elb, (eruje), ELBASAN, FIER, (Benj), LIS, Selishte, Macukull dhe (Klos);
- nuk është respektuar i njëjti standard në krijimin e “loginID” dhe “fullname” ku pjesa më madhe është krijuar me emër.mbiemër për “loginID” dhe Emër Mbiemër për “fullname”. Në shumë raste ky model nuk është ndjekur, ku rezultuan 121 raste për të cilat “fullname” është me gërma kapital, ose raste kur atributi loginID përveç formatit emër.mbiemër ka prapashtesë gërma dhe dy raste me numrin “2”;
- për “fullname” të përdoruesit ka 9 raste kur vetëm mbiemri është me gërma kapitale, 4 rast kur emri dhe mbiemri fillon me gërmë të vogël dhe 1 raste kur mbiemri nuk fillon me gërmë kapitale;
- janë 39 përdorues për të cilët “loginID” dhe “fullname” kanë të njëjtin format emër.mbiemër, si dhe për 2 përdorues “loginID” është vendosur si standardi i “fullname” dhe “fullname” si standardi i përdorur për “loginID”;
- ekzistojnë 22 user-a me rolin “shofer” për të cilët nuk ka asnjë atribut në sistem. Përveçse atributit mungon edhe identifikimi i userit p.sh, mund të shtohej emër mbiemër për të identifikuar veprimtarinë e gjithsecilit, pasi janë 22 usera me rolin shofer por të pa identifikuar.
- janë 5 usera të pa identifikuar për ZVRPP, për këto përdorues është përdorur standard ZVRPP-Tirana Veri/ ZVRPP-Tirana Jug dhe ZVRPP- Rulale 1/ ZVRPP- Rulale 2 si për fushën “loginID” dhe “fullname”;
- ka usera të pa identifikuar si “test.test”, “fab.test”, “tranzit”, “fier.qender”, “KosovaEMS”, ”KosovaPosta” dhe “EternaWeb”. Gjithashtu ekziston user me loginID “silvana.topulli” për të cilën fullname është “d”.
11.1 Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit të marrë masa për unifikimin e të dhënave për përdoruesit e sistemit Eterna financiare dhe postare të të njëjtës kategori, të plotësojë të dhënat që mungojnë për çdo përdorues, të ndërtojë kontrolle për mbylljen e përdoruesve në

kohën e duhur, të mbyllë përdoruesit të cilët kanë përfunduar objektin e krijimit, me qëllim ruajtjen e sistemit nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu të marrë masa për analizimin e situatës aktuale të evidentuara nga auditimi në lidhje me integritetin dhe plotësinë e të dhënave mbi përdoruesit e sistemeve Eterna financiare dhe postare.
Nga auditimi rezulton se: ky rekomandim është në proces pasi unifikimi i të dhënave ende nuk ka përfunduar.

Rekomandimi është në proces zbatimi

11.2 Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit të ndërtojë mekanizma kontrolli për dokumentimin dhe miratimin fizik të ndryshimeve të lejuara për përdoruesit e sistemeve, me qëllim evidentimin dhe parandalimin e problematikave që lidhen me sigurinë e të dhënave.
Nga auditimi rezulton se: me urdhrin nr. 217 datë 06.07.2022, janë miratuar nga Administratori i Përgjithshëm rregulloret dhe pritet të miratohen në mbledhjen e rradhës në Këshillin Mbikëqyrës.

Rekomandimi është në proces zbatimi

12.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në postën Shqiptare nuk ka zbatuar praktikat me të mira në ngritjen dhe menaxhimin e infrastrukturës netëork. Infrastruktura network në Postën Shqiptare menaxhohet pa krijuar grup userash me role të ndara me të drejta konfigurimi.
- Useri admin është i aktivizuar dhe nuk ka një user me emërtim ndryshe me të drejtat e Administratorit si dhe Routerat e ndodhura në filialet e Postës Shqiptare kanë të aktivizuar userin admin.
- Nuk ka të implementuar një procedurë kontrolli të log-eve për të parë erroret ose problemet e ndryshme;
- Posta Shqiptare nuk ka marrë masa për lidhje të dytë Backup, problem që evidentohet në të gjitha Filialet e saj.

12.2 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në postën Shqiptar nuk ka marrë masa për krijimin e një filtri i cili bllokon një IP të caktuar e cila ka tentuar të aksesojë porta ose subnete kritike.
-Posta Shqiptare për të bërë DST NAT përdor porta standarde Remote Desktop, SSH dhe Telnet;
-Posta Shqiptare nuk ka krijuar grup userash të cilët kanë role të ndara dhe të drejta konfigurimi.
12.1.Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në postën Shqiptare të marri masa për:
-Konfigurimin në routerin kryesor të një scripti i cili monitoron subnetet ku posta ka shërbimet e saj me qëllim detektimin në rastin e një sulmi ose hyrje të pa autorizuar IP-në e aksesimit dhe në mënyrë automatike ta vendosi në një "blacklist ".
-Të merren masa për të ndryshuar të gjitha portat e aksesimit të serverave, pajisjeve nga standarde në custom pasi sulmet bëhen gjithnjë në portat standarde të aksesimit Remote, me qëllim uljen e riskut për thyerje të sigurisë.
-Të bllokohet useri "admin" dhe të krijohet një user me emërtim ndryshe dhe me privilegje të plota.
-Të krijohen grup userash me të drejta të limituara. Një user i cili shërben për monitorimin SNMP me të drejta vetëm Read dhe një user i cili aksesohet nga stafi me të drejta vetëm Read.
-Të krijohet një procedure e kontrollit të log-eve javore për të parë dhe analizuar a ka patur tentative sulmesh, ose skanime të userit admin.
-Posta Shqiptare duhet të marrë masa për lidhje backup për të gjitha filialet e saj, duke garantuar shmangien e bllokimit të punës në rast të një defekti në lidhjen primare.

Gjithashtu të merren masa për administrimin dhe implementimin e të gjitha konfigurimeve të nevojshme të evidentuara nga auditimi dhe të tjera të mundshme, me qëllim rritjen e sigurisë së infrastrukturës network.
Nga auditimi rezulton se: Me implementimin e SIEM është iniciuar procesi mbi monitorimin e log-eve, por ka dhe cështje të tjera të cilat mbështeten tek aktet rregullative që janë në fazë miratimi për të vepruar edhe më tej. Në këto kushte rekomandimi do të konsiderohet në process meqënëse zbatimi ka nisur nga Drejtoria e IT dhe Zhvillimit.

Rekomandimi është në proces zbatimi

13.1 Gjetje nga auditimi: Posta Shqiptare përdor për storage EMC Clarion i cili shërben për tek datacenteri primar. Gjithashtu është edhe një storage i dytë i cili është IBM Storewize. IBM dhe EMC shërben për makinat virtuale dhe për ruajtjen e të dhënave dhe data bazat e aplikacioneve që Posta ka në përdorim. Storage EMC Clarion është një produkt i cili është End Of Life dhe prodhuesi nuk ofron me suport për këtë model. Nisur nga zhvillimet që Posta Shqiptare ka bërë në sistemet e saj, storage aktualisht ndodhet drejt ezaurimit të hapësirës dhe nevojitet shtimi i kapacitetit të hard drive.
13.2 Gjetje nga auditimi: Posta Shqiptare ka në përdorim Fujitsu Blade Server Primergy BX920S2 i cili shërben për hostimin e të gjitha makinave virtuale dhe janë të konfiguruara me Storage IBM dhe EMC. Modeli i Fujitsu Blade Server Primergy BX920S2 nuk ofrohet më suport nga prodhuesi pasi është End of Life.
13.1.Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në Postën Shqiptare të marri masa për rritjen e kapacitet të storage apo zëvendësimin e tyre në përputhje me nevojat institucionale që Posta Sh.a ka, duke marrë në konsideratë dhe zhvillimet teknologjike për të ardhmen në shoqërinë Posta Shqiptare, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së punës.
Nga auditimi rezulton se: Meqënëse nga Drejtoria e IT dhe Zhvillimit kjo kërkesë është dokumentuar në programin ekonomik që pritet të miratohet dhe meqë vetë shoqëria është në ndryshime statuti, ky rekomandim do të konsiderohet në process zbatimi.

Rekomandimi është në proces zbatimi

14. Gjetje nga auditimi: *Nga auditimi u konstatua se Posta Shqiptare Sh.a.:*
- Nuk disponon akte rregullatore për menaxhimin e log-eve digjitale në administratën e Postës, në kundërshtim me pikën 4 shkronja a) të *"Rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në Administratën Publike*", miratuar me Urdhrin nr. 109 datë 10.06. 2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT). Institucioni duhet të përcaktojë një rregullore të shkruar për menaxhimin e log-eve sipas kërkesave të institucionit. Kjo rregullore duhet të specifikojë qartë të gjitha kërkesat për ruajtjen e log-eve përkatëse për çdo sistem/pajisje të institucionit, procedurat e administrimit dhe përgjegjësitë në përputhje me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi;
- Nuk janë përcaktuar burimet e nevojshme si dhe detyrat e personelit për menaxhimin e tyre;
- Posta Shqiptare Sh.a. nuk zhvillon kontrolle mbi Audit Log, pavarësisht rëndësisë që kanë këto të dhëna në përmirësimin e sistemit, konstatimin dhe analizimin e problematikave të ngjashme.
14.1.Rekomandim: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a t'i japin rëndësi sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave duke filluar së pari me hartimin e një procedure apo rregullore për menaxhimin e gjurmës elektronike të auditimit, me qëllim uljen e riskut mbi sigurinë e të dhënave me pasojë humbjen dhe tjetërsimin e tyre. Në këtë dokument duhet të specifikohet qartë vendi ku ruhen gjurmët, për cilat veprime të përdoruesit ruhen këto gjurmë, koha, struktura përgjegjëse për monitorimin dhe analizimin e tyre, detyrat dhe përgjegjësitë, e çdo element që i shërben sigurisë së të dhënave dhe parandalimit në tjetërsimin e tyre.
Nga auditimi rezulton se: është kryer nga Administratori ië Përgjithshëm miratimi i projekt

rregulloreve me nr. 1625/3, dt. 06.07.2022, “Mbi menaxhimin dhe administrimin e logeve te sistemit eterna te PSH” me qëllim monitorimin e log-ut në pajisje apo në sistem janë sistemi Kibana dhe SIEM të cilët do të ofrojnë ruajtjen e këtyre gjurmëve në funksion të auditimit por dhe cdo nevoje tjetër. Ky rekomandim do të konsiderohet në proces zbatimi meqënëse aktet rregullative do të kalohen në mbledhjen e radhës së Këshillit Mbikqyrës.

Rekomandimi është në proces zbatimi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Posta Shqiptare nuk ka marrë masa për mbrojtjen nga Cyber Security përmes një sistemi inteligjent i cili detekton dhe monitoron në kohë reale të gjitha strukturat Rrjet/Aplikacion/Database/Users si dhe sulme të tipit DDOS.

15.1.Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në Postën Shqiptare të marri masa për ndërtimin e mekanizmave inteligjent me qëllim monitorimin në kohë reale të të gjitha protokolleve të sigurisë për sistemet e operimit, databazat si edhe protokollet e rrjetit.

Nga auditimi rezulton se: meqënëse është implementuar zgjidhja e SIEM - Security Information and Event Management, ky rekomandim do të konsiderohet i zbatuar.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Posta Shqiptare Sh.a, pavarësisht se ka marrë masa të konsiderueshme për ngritjen e një infrastrukture të nevojshme për sigurimin e vazhdueshmërisë së punës, nuk ka hartuar dokumente të politikave të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013.

Këto dokumente përcaktojnë masat, procedurat dhe objektivat të mirë dokumentuara për rivendosjen në funksionim të sistemit në rastet e emergjencave dhe që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve si dhe përcaktimin e RTO (*Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes*) dhe RPOs (*Objektivat e Punës së Ripërtëritjes*) për çdo proces kritik.

-Procedura e hartuar/e ndjekur nuk është e pasqyruar apo e dokumentuar në ndonjë dokument administrativ si rregullore e brendshme apo dokument tjetër TIK ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve, procesin e ruajtjes së të dhënave për sistemet.

-Posta Shqiptare nuk ka një plan testimi për sistemet kyçe, të paktën 1 herë në muaj, duke përdorur Restore si dhe të gjitha replikimet të testohen duke analizuar të dhënat më të fundit në rastin e një strukture me baza të dhënash.

-Backup-et i kalojnë në një file server të dedikuar për ruajtjen e backup-eve për nuk përdoret enkriptim në transferim.

-nuk realizohet backup për loget e sistemit të hyrje-daljeve të personelit.

16.1.Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në bashkëpunim me strukturat drejtuese në Postën Shqiptare të marrin masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, me qëllim uljen e riskut për ndërprerjen e shërbimeve dhe vazhdimësisë së punës.

Nga auditimi rezulton se: është kryer miratimi pararak i projekt rregulloreve nga Administratori i Përgjithshëm, pritet të miratohen nga Këshilli Mbikqyrës.

Rekomandimi është në proces zbatimi

17.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Postën Shqiptare Sh.a, nuk është dokumentuar gjurma e auditimit për rrjedhën e transaksioneve financiare dhe të tjera, si një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të

njësisë dhe institucionit, si dhe jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta apo për t'i verifikuar ato.

17.2 Gjetje nga auditimi: Shoqëria Posta Shqiptare Sh.a, kryen veprime operacionale në sisteme informatike të cilat janë zhvilluar me qëllim informatizimin e veprimeve që kjo shoqëri ofron për shtetasit e saj, por në mungesë të diagrameve shpjeguese se si informacioni rrjedh nëpërmjet sistemit të TI që mbështet proceset kryesore të institucionit. Mungesa e diagrameve krijon pengesa në kuptueshmërinë, vlerësimin dhe gjurmimin e veprimeve që kryhen nëpërmjet sistemit.

17.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë, në bashkëpunim me drejtorët e përgjithshëm të cilët drejtojnë sipas strukturës Departamentin e Shërbimeve, Administrimin e Shoqërisë dhe Zhvillimit dhe Standardeve të hartojnë, dokumentojnë dhe miratojnë gjurmën e auditimit për rrjedhën e transaksioneve financiare dhe të tjera, ku të jenë identifikuar procedurat dhe operacionet që shoqëria ndjek me qëllim qartësinë dhe kuptueshmërinë e mjedisit të kontrollit.

Nga auditimi rezulton se: ka filluar hartimi i gjurmës së auditimit, prandaj ky rekomandim do të konsiderohet në proces.

Rekomandimi është në process zbatimi

17.2 Rekomandimi: Drejtuesit e Departamentit të Shërbimeve, Administrimit të Shoqërisë dhe Zhvillimit dhe Standardeve krahas identifikimit të proceseve që nevojiten për dokumentimin e gjurmës audituese, në bashkëpunim me Drejtorinë e IT dhe Zhvillimit dhe Drejtorinë e Sigurisë dhe Cilësisë duhet të hartojnë dhe dokumentojnë diagramet e rrjedhës së informacionit për çdo proces që realizohet nëpërmjet sistemit me qëllim përcaktimin e të dhënave hyrëse, roleve, ndryshimin, miratimin dhe përfundimin për çdo shërbim që realizohet nëpërmjet sistemit informatik.

***Nga auditimi rezulton se*:** projekt rregullorja është miratuar nga Administratori I Përgjithshëm, por nuk është miratuar nga Këshilli Mbikqyrës. Për këtë arsye do të konsiderohet në process.

Rekomandimi është në process zbatimi

18.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ndryshimin e statusit të përdoruesve në sistem, rezulton se nuk pasqyrohen ndryshime për përdoruesit përkohësisht jo aktiv apo përdorues të cilët mund të jenë larguar me leje të gjatë si raport shëndetësor apo leje lindje, çfarë cenon sigurinë e të dhënave e cila nuk është përgjegjësi e punonjësit të larguar, por e Burimeve Njerëzore dhe Drejtorisë së TI dhe Zhvillimit, mbi pasqyrimin e ndryshimeve në sistem.

18.1 Rekomandimi: Burimet Njerëzore të përditësojnë në sistem ndryshimet e punonjësve me status të larguar me leje të gjatë apo përkohësisht jo aktiv, me qëllim gjenerimin sistematik për këto të dhëna nga Drejtoria e TI dhe Zhvillimit të cilat duhen administruar për kufizimin e të drejtave të këtyre përdoruesve, veprime të cilat do të përmirësonin procesin e statusit të përdoruesve dhe do të parandalonte çdo mundësi për akses të paautorizuar në të dhëna. Gjithashtu të marren masa për monitorimin e vazhdueshëm të statusit të përdoruesve.

Nga auditimi rezulton se: për përdorues të cilët kanë qenë aktiv me marrëdhënie pune të shkëputura prej Postës Shqiptare, janë c'aktivizuar dhe në sistem. Meqënëse rregullorja e hartuar nga Burimet Njerëzore dhe Drejtoria e IT ka marrë miratimin e Administratorit, rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht

19. Gjetje nga auditimi: Mbështetur në testimet e ndryshme të zhvilluara në sistemin Eterna rezultuan disa mangësi të sistemit të cilat pengojnë kryerjen e veprimeve automatike, konkretisht:
- Nuk është e mundur në sistem të hidhet kursi ditor për monedhën EUR, apo të ndryshohet.
- Përditësimi i manualeve të Eternës nuk është bërë duke siguruar shtimin e produkteve/shërbimeve të reja.
- Raporti i pagave nga sistemi Eterna Financiar në modulin e burimeve njerëzore tregon se paga neto është e njëjtë me pagën bruto çfarë tregon se të dhënat për të dy fushat regjistrohen manualisht, duke rritur mundësinë për gabime operacionale. Theksojmë se kjo është më pak se sa ofron Excel në të cilën paga neto del si rezultat i implementimit të formulave të thjeshta.
- Fletëdaljet e artikujve dërgohen fizikisht në filiale, dhe po manualisht filiali i regjistron në sistem edhe pse disponojnë një modul magazine nga i cili këto veprime duhet të realizoheshin automatikisht.
- Moduli i blerjeve dhe moduli për menaxhimin e dokumenteve nuk rezultojnë se kanë të dhëna, që do të thotë se nuk janë në përdorim, edhe pse nevoja për të administruar nëpërmjet sistemit është e madhe.

19.1 Rekomandimi: Posta Shqiptare Sh.a, të marrë masa për përditësimin e manualeve të sistemit Eterna me qëllim shtimin e produkteve/shërbimeve të reja si dhe të marrë masa për sistemimin e mangësive në sistem për mirëmbajtjen e kursit të këmbimit për monedhën EUR.
Nga auditimi rezulton se: kërkesa i është komunikuar operatorit zhvillues, por asnjë përgjigje nuk është marrë.

Rekomandimi është në proces zbatimi

19.2 Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore të përfundojë regjistrimin e të dhënave të sakta në modulin e burimeve njerëzore dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e TI dhe Zhvillimit të identifikojë të dhëna që nevojiten të regjistrohen nga përdoruesi dhe të dhënat që gjenerohen automatikisht prej sistemit si në rastin e raportit të pagave nga sistemi Eterna Financiar ku paga neto rezulton e njëjtë me pagën bruto që tregon se të dhënat për të dy fushat regjistrohen manualisht, duke rritur mundësinë për gabime operacionale, me qëllim uljen e problematikave me veprimet operacionale të përdoruesve.
Nga auditimi rezulton se: është ndryshuar raporti për pagën neto dhe bruto, gjithashtu të dhënat e punonjësve janë regjistruar në sistem nga filialet dhe ky proces vazhdon për çdo punonjës të ri, meqënëse janë hartuar dhe rregulloret për menaxhimin e përdoruesve dhe kanë marrë miratimin paraprak të Administratorit të Përgjithshëm, ky rekomandim do të konsiderohet i zbatuar.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht

19.3 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse në shoqërinë Posta Shqiptare Sh.a, të marrin masa për vënien në funksion sa më shpejtë të funksionaliteteve ekzistuese në Eterna lidhur me fletëdaljet e artikujve të modulit magazine me qëllim realizimin e këtyre veprimeve në mënyrë automatike si dhe vënien në funksion modulin e blerjeve dhe modulin për menaxhimin e dokumenteve të cilët nuk janë në përdorim, edhe pse nevoja për të administruar nëpërmjet sistemit është e madhe.
Nga auditimi rezulton se: meqënëse menaxhimi i kërkesës për blerje nuk realizohet nëpërmjet Modulit të blerjeve dhe Moduli i menaxhimit të dokumenteve ende nuk është populluar me të dhëna, ky rekomandim konsiderohet pjesërisht i realizuar.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

20.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi raportet e gjeneruara prej sistemit Eterna Financiar u konstatuan disa problematika në lidhje me gjenerimin e tyre, konkretisht:

- Të gjitha raportet që u gjeneruan, kërkojnë patjetër përpunime në Excel sepse dhe raportet përmbledhëse janë konceptuar në nivel filiali edhe në rastet kur kërkesa për informacion ekzekutohet në nivel republike;
- Nuk ka asnjë opsion të gjenerosh të dhëna për të dy monedhat EUR dhe LEK;
- Nuk ka asnjë raport për përdoruesit, roli dhe zyrat në të cilat kanë akses;
- Për përdoruesit në modulet Magazina, Moduli i Blerjeve, Inventari, Menaxhimi i Dokumenteve rezulton se nuk është ndërtuar asnjë raport në strukturën e raporteve, madje për këto shërbime nuk rezulton se janë hedhur të dhëna me qëllim vënien në funksion të tyre.

20.2. Gjetje nga auditimi: Nga testime të ndryshme në sistemin Eterna Postar përgjatë gjenerimit të raporteve nga pema e raporteve u konstatuan disa parregullsi/mangësi, konkretisht:
- sistemi nuk gjeneron raporte dorëzimi për një periudhë të gjatë kohore;
- nuk shfaqet asnjë e dhënë që përdoruesi të përzgjedhi me qëllim gjenerimin e raporteve;
- opsioni RPO40 shfaq një tabelë pa asnjë të dhënë për opsionet e përzgjedhura nga përdoruesi;
- raporte supervizori kanë shumë vonesa në gjenerimin e raporteve.

20.1.Rekomandimi: Drejtoria e TI dhe Zhvillimit, të analizojë dhe adresojë tek ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes parregullsitë, mangësitë e konstatuara nga auditimi mbi raportet që gjenerojnë të dhëna të sistemit të cilat nuk kanë filtrat e aplikuar, nuk zgjidhin kërkesat e përdoruesve të cilët krijojnë mënyra alternative të përpunimit të mëtejshëm të informacionit jashtë sistemit Eterna Financiar dhe Postar, çfarë do të lehtësonte veprimet manuale të punonjësve.

Nga auditimi rezulton se: jemi vënë në dijeni për komunikimet elektronike ndërmjet Drejtorisë TIK dhe operatorit zhvillues. Meqënëse komunikimi dhe kërkesat janë iniciuar nga kjo drejtori rekomandimi do të konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces zbatimi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi onsite në zyrat postare të Posta shqiptare në Tiranë u konstatuan raste kur janë fshirë në mënyrë automatike nga sistemi Eterna Postar, të dhënat e klientit (*marrësit*) i cili do të marri këtë objekt. Këto raste kanë ndodhur kur pakot nuk i janë dorëzuar klientit përkatës dhe kanë ngelur në zyrat postare, gjë për të cilën punonjësit detyrohen ti hedhin përsëri manualisht në sistem duke bërë edhe njëherë popullimin e të dhënave nga fillimi, proces i cili rrit riskun për gabime njerëzore në hedhjen e të dhënave.
- Të dhënat për pakot e ardhura që popullohen nga specialistët janë: emër, mbiemër, id dhe adresën e pritësit të postës. Nga auditimi në sistemin Eterna Postar u konstatua se ky sistem nuk ofron si opsion që të dhënat e klientit marrës të cilat janë populluar njëherë në sistem të shfaqen si sugestion (*propozime*) nga sistemi me idenë që këto të dhëna mund të hidhen në mënyrë automatike, pa qenë nevoja të ri plotësohen në mënyrë manuale edhe njëherë.

21.1.Rekomandimi: Drejtoria e TI dhe Zhvillimit, të analizojë dhe adresojë tek ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes parregullsitë, mangësitë e konstatuara nga auditimi mbi fshirjen në mënyrë automatike nga sistemi Eterna Postar të të dhënave të marrësit të pakove që janë në pritje si dhe të merren masa për shtimin e funksionaliteteve të reja mbi popullimin e informacioneve të klientëve ekzistues në mënyrë të automatizuar, çfarë do të lehtësonte veprimet manuale të punonjësve.

Nga auditimi rezulton se: nuk është vepruar ende nga firma zhvilluese për këtë cështje që i është kërkuar nga Drejtoria IT. Meqënëse kërkesa është bërë nga kjo drejtori, por ende nuk ka një përgjigje apo status të kësaj kërkese ky rekomandim do të konsiderohet në proces.

Rekomandimi është në proces zbatimi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ndërmjet Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Posta Shqiptare është nënshkruar një marrëveshje "*Për shërbimet publike elektronike në portalin unik qeveritar e-Albania*", me objekt ofrimin e shërbimeve elektronike nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania ndaj subjekteve fizikë dhe juridikë, shtetëror dhe privat, miratuar me shkresën nr. 221, datë 25.01.2019.
Mbështetur në marrëveshjen e sipërcituar, Administratori i Posta Sh.a ka nxjerrë udhëzimin "*Mbi kryerjen e shërbimit bazuar në marrëveshjen e lidhur me AKSHI-n*" miratuar me shkresën nr. 221/1, datë 28.01.2019.
Nga auditimi u konstatua se vlefshmëria e marrëveshjes së lidhur ndërmjet dy institucioneve ka përfunduar dhe rrjedhimisht edhe vlefshmëria e udhëzimit (*pikat 5.1 dhe 5.2, të nenit 5, Kohëzgjatja të marrëveshjes*). Posta shqiptare vazhdon ta ofrojë këtë shërbim edhe pse marrëveshja e ka mbaruar vlefshmërinë e saj.
22.1.Rekomandimi: Posta Shqiptare Sh.a. në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masat e nevojshme për rinovimin/hartimin dhe miratimin e marrëveshjes me qëllim koordimin për ofrimin e shërbimeve elektronike nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania, ndaj subjekteve fizikë dhe juridikë, shtetëror dhe privat.
Nga auditimi rezulton se: megjithëse PSH sha me anë të shkresës nr. 732/2, datë 16.06.2022 i ka dërguar AKSHIT listën emërore të punonjësve që aksesojnë sistemin e-albania, ky i fundit e ka ndaluar këtë shërbim për PSH përvec gjenerimit të certifikatës personale në funksion të kryerjes së shërbimit për palët e treta si prsh ISSH, Tatimet etj. PSH në komunikimin zyrtar ka kërkuar dhe dy përdorues në rolin e administratorit me qëllim që dinamika e përdoruesve të menaxhohet nga vetë Posta Shqiptare. Aktualisht këto shërbime nga moduli i e-albania janë pezulluar pa afat prandaj ky rekomandim nuk mund të zbatohet më tej. Për këtë PSH e konsideron këtë rekomandim të paranueshëm për ta zbatuar.

Rekomandimi nuk është pranuar

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ofrimin e shërbimeve nga e-Albania, nga shoqëria Posta Shqiptare u konstatua se:
- Rregullorja për mbrojtjen e të dhënave personale, e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a. me vendimin nr. 43, datë 28.12.2015 dhe e përditësuar në vitin 2019 e cila është ende e pa miratuar, tregon se nuk janë marrë masat e nevojshme nga Posta Shqiptare për sigurinë e të dhënave personale si detyrim ky që rrjedh nga ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", neni 20 "*Detyrimet e përpunuesit*", neni 21 "*Përgjegjësia për të njoftuar*" dhe neni 27 "*Masat për sigurinë e të dhënave personale*". Kjo do të thotë se punonjësit e Postës Shqiptare nuk janë të informuar se nëpërmjet shërbimeve e-Albania janë duke punuar me të dhëna personale të shtetasve, të cilat mbrohen me ligjin e përmendur më lart.
- Në disa raste, i njëjti punonjës rezulton të ketë më shumë se dy përdorues aktiv tek portali e-Albania. Gjithashtu, ka punonjës që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Posta Shqiptare dhe rezultojnë të kenë përdorues aktiv për leximin e shërbimeve nga e-Albania, nën llogarinë e shoqërisë.
- Sipas të dhënave të gjeneruara nga moduli i e-Albania për Posta Shqiptare, numri i printimeve nga e-Albania është 198,585 dokumente që mendohet të jetë dhe numri i transaksioneve për të cilat është arkëtuar një komision. Nga sistemi Eterna Financiar në total dalin 62,292 transaksione. Përgjatë vitit 2019, filialet i kanë raportuar shërbimet e-albania si të ardhura në zëra të ndryshëm dhe përgjatë vitit 2020 ky shërbim identifikohet si shërbim biznesi pavarësisht faktit se dokumenti mund të tërhiqet si biznes apo individ. Kjo do të thotë se drejtoria ekonomike e ka pothuajse të pamundur të evidentojë numrin e rekordeve për të cilat është arkëtuar.

23.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a të marrin masa për gjetjen e mekanizmave të kontrollit në ofrimin e shërbimeve nga e-albania, që garantojnë regjistrimin e çdo dokumenti të printuar apo elementëve të tij unik, në sistemin e brendshëm Eterna Financiar me qëllim monitorimin dhe parandalimin e keqpërdorimit si rezultat i aksesit të paautorizuar.
Gjithashtu të merren masa për adresimin e konstatimeve të auditimit mbi trajtimin e të dhënave personale sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore, mbi "*përgjegjësinë për të njoftuar"* "*detyrimet e përpunuesit"* si dhe *"masat për sigurinë e të dhënave personale".*
Nga auditimi rezulton se: Megjithëse PSH sha me anë të shkresës nr. 732/2, datë 16.06.2022 i ka dërguar AKSHIT listën emërore të punonjësve që aksesojnë sistemin e-albania, ky i fundit e ka ndaluar këtë shërbim për PSH përvec gjenerimit të certifikatës personale në funksion të kryerjes së shërbimit për palët e treta si prsh ISSH, Tatimet etj. Meqenëse PSH ka kërkuar dhe dy përdorues në roline administratorit dinamika e përdoruesve do të menaxhohet nga vetë Posta Shqiptare. Aktualisht nuk ka një marrëveshje ndërmjet PSH dhe AKSHI-t, gjithashtu këto shërbime nga moduli i e-albania janë pezulluar pa afat, prandaj ky rekomandim konsiderohet i paparanur për zbatueshmërinë e tij.

Rekomandimi nuk është pranuar

23.2 Rekomandimi: Drejtoria e TI dhe Zhvillimit, të analizojë dhe të marri masa mbi përdoruesit që kanë më shumë se dy user-a aktiv tek portali e-Albania si dhe përdoruesit që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Postën Shqiptare dhe rezultojnë të kenë përdorues aktiv për leximin e shërbimeve nga e-Albania, me qëllim uljen e riskut për akses të paautorizuar dhe keqpërdorimin e të dhënave.
Nga auditimi rezulton se: megjithëse PSH sha me anë të shkresës nr. 732/2, datë 16.06.2022 i ka dërguar AKSHIT listën emërore të punonjësve që aksesojnë sistemin e-albania, ky i fundit nuk ka kthyer përgjigje lidhur me kërkesën mbi verifikimin e statusit të përdoruesve për të vetmin dokument që gjenerojnë certifikatën personale.

Rekomandimi është në proces zbatimi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi të dhënat "output" gjeneruar prej sistemit si dhe të dhënave të raportuara tek institucionet që administrojnë dhe hartojnë politikat e shoqërisë Posta Shqiptare, u konstatuan disa parregullsi , konkretisht:
- Aktrakordimet që kryen zyra qendrore, me Drejtorinë e Përgjithshme, rezultuan se disa prej tyre kryhen duke gjeneruar të njëjtat të dhëna në trajtën e raporteve nga sistemi. Ky kontroll apo siç quhet akt-rakordim nuk është i vlefshëm për sa kohë bazohet në të dhëna të njëjta dhe jo në kryqëzime të dhënash të cilat do t'i jepnin kuptim kontrollit në një hallkë më sipër, por dhe verifikimit dhe saktësisë së të dhënave të regjistruara në sistem.
- Nuk gjenerohet asnjë evidencë prej sistemit edhe pse pjesa më e madhe e të dhënave që kërkohen në raportim, punonjësit i regjistrojnë në sistem. Punonjësit në filiale, kryejnë të njëjtën punë dy herë, një herë nëpërmjet regjistrimit në sistem dhe një herë në përmbledhjen e të dhënave për muajin e kaluar, 3 mujorin e kaluar, 6 mujorin apo 1 vjetorin ku në disa raste këto raportime janë progresive. Punonjësit në drejtorinë ekonomike përmbledhin të gjithë informacionin e ardhur për efekt raportimi.
- Raportimi që kryen Posta në MFE, MIE dhe INSTAT për të gjitha periudhat e ndryshme që raporton, është një mbledhje të dhënash plotësisht manuale. Raportimi në këto institucione është me periodicitet 3 mujor, 6 mujor dhe 1 vjeçar.

- Kontrolli i brendshëm realizohet me dokumentacion fizik nga filiali në drejtorinë qendrore.
- Asnjë nga tipet e evidencave nuk rezulton të jetë kërkuar të gjenerohet nga Datawarehouse BI, të cilin posta e ka implementuar në vitin 2020, qëllimi i të cilit është orientuar po tek veprimet e përdoruesit dhe aspak tek raportimi të cilit kjo magazinë të dhënash do i shërbente më shumë

24.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a, të marrin masat e nevojshme për:

a. informatizimin e shërbimeve që kryhen manualisht;

b. importimin e të dhënave në Datawarehouse BI, për shërbimet që kryhen tek sistemet e të tretëve në mënyrë automatike, ditore;

c. implementimin e raporteve me të dhëna përmbledhëse nga Dataëarehouse BI, që i shërbejnë monitorimit, vendimmarrjes, raportimit dhe transparencës.

Nga auditimi rezulton se: janë kryer informatizime të shërbimeve që kryheshin manualisht si prsh lëvizjet e mallrave ne magazine per letrat me vlere, por duke qene se nuk janë implementuar të gjitha, ky rekomandimi do të konsiderohet në proces.

Rekomandimi është në proces zbatimi

25 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi monitorimin e Intranetit/Internetit, u konstatua se:
- në rregulloret e brendshme për: Filialin e Postës Shqiptare Sh.a, Qendra Tranzit, Filialet e kategorisë së parë dhe të dytë, dhe të degëve të kategorisë së parë dhe të dytë të Shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a. nuk është e përcaktuar mënyra se si ndiqet monitorimin i linjave data nga specialistët IT.
- në lidhje me problematikat, komunikimi me drejtorin e përgjithshme bëhet me telefon dhe email, zgjidhja ndiqet rast pas rasti, nuk monitorohet apo dokumentohet koha dhe natyra e problematikës së konstatuar apo punonjësit që janë angazhuar për zgjidhjen e saj.
- Filiali Kukës nuk ka akses në Sistemin PRTG, çka do të thotë se për këtë filial nuk bëhet monitorimi i shërbimit dhe konstatim i konektivitetit të linjave.

25.1.Rekomandimi: Posta Shqiptare Sh.a. të marri masa për përditësimin e rregulloreve të brendshme me qëllim përcaktimin e mënyrave se si ndiqet monitorimi i linjave data, gjithashtu të konsiderojë dhe implementojë zgjidhje të tjera "open source" për monitorimin e linjave data për pikat e filialeve me qëllim monitorim më të detajuar mbi konsumin e bandëith-it, çfarë do të ndihmonte Postën Shqiptare në një planifikim më të mirë të kapaciteteve që i nevojiten.

Nga auditimi rezulton se: në raportin e monitorimit që na u vu në dispozicion rezulton se ky monitorim kryhet, për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i zbatuar.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht

26.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se pozicionimi i strukturës së auditit të brendshëm në organikën e Postës Shqiptare rezulton të jetë nën Këshillin Mbikëqyrës, për të garantuar pavarësinë e kësaj strukture, por nga auditimi u konstatua se është përgjegjësi e Administratorit të shoqërisë të bëjë emërimet e punonjësve në strukturën e auditimit të brendshëm, ndërkohë që emërimi i drejtorit të auditit të brendshëm është kompetencë e Këshillimit Mbikëqyrës. Emërimi i audituesve të kësaj strukture nga Administratori, është në kushtet e konfliktit të interesit, për arsye se vendimmarrjet e Administratorit duhet gjithashtu të jenë objekt kontrolli pasi ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a.

26.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës të miratojë ndryshimet e nevojshme për marrjen e kompetencës për emërimet e audituesve në Auditin e Brendshëm dhe heqjen e kësaj të drejtë nga Administratori i shoqërisë, me qëllim garantimin e pavarësisë së funksionaliteteve dhe objektivave që kërkohen të arrihen nga struktura e Auditit të Brendshëm si dhe shmangien nga kushtet e konfliktit të interesit për ushtrimin e detyrave të audituesit.
Nga auditimi rezulton se: në të gjitha shoqëritë aksionere me mbi 50% te aksioneve shtet, emërimet në strukturën e auditit të brendshëm bëhen nga këshilli mbikqyrës dhe jo nga administratori, për arsye të krijimit të kushteve të pavarësisë së funksionimit të auditit të brendshëm si dhe në praktikat më të mira është që kjo strukturë mos ushtrojë detyrat në konflikt interesi sic ndodh aktualisht tek PSH. Për këtë, arsyetimi juaj për mos zbatimin e këtij rekomandimi nuk qëndron dhe do të konsiderohet i pazbatuar. Posta Shqiptare në mbledhjen e radhës duhet të kërkojë ndryshimin e statutit të shoqërisë në mënyrë që të zbatohet rekomandimi i mësipërm.

Rekomandimi nuk është zbatuar

27.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:
- Planifikimi për auditimin e brendshëm dhe sidomos në drejtimin e TI nuk është bazuar mbi sistemet e informacionit që disponon shoqëria të cilat ndikojnë tek kontrolli i brendshëm dhe raportimi financiar, në kundërshtim me manualin për auditimin e brendshëm.
- Nga administrimi i raporteve të auditit të brendshëm për filialet Fier, Lushnje, Shkodër, Tranzit dhe Gjirokastër, Korçë, Mat, Sarandë dhe Vlorë u konstatua se në drejtim të auditimit të teknologjisë së informacionit nuk është ndjekur metodika që përcakton manuali i auditimit të brendshëm. Pikat e programit të auditimit të ushtruar nga auditi i brendshëm në çdo filial dhe trajtimi i tyre nga audituesi i brendshëm me profil në teknologjinë e informacionit, është shumë i ngjashëm në të gjitha raportet e periudhës 2018-2020.
- Nga administrimi i raporteve të auditit të brendshëm në drejtim të auditimit të sistemeve të TI-së nuk janë konstatuar çështje që mund të ndihmonin në përmirësimin e sistemit, por vetëm çështje me karakter udhëzues mbi përdoruesit, në kundërshtim me detyrat 1 dhe 5 të përshkruara për Audituesin e TI në rregulloren e brendshme institucionale të Posta Shqiptare.
- Posta Shqiptare nuk ka zhvilluar burimet njerëzore të auditit të brendshëm me njohuri të mjaftueshme mbi teknologjinë e informacionit dhe nuk ka planifikuar, kryer misione auditimi mbi sistemet e TI-së në Drejtorinë e IT-së dhe Zhvillimit dhe Sektori i Sigurisë së Informacionit pranë Posta Shqiptare.
27.1.Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a dhe Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të vlerësojnë me prioritet auditimin e IT, duke implementuar metodologjinë e përcaktuar në manualin e auditimit IT, dhe duke u thelluar në kontrolle të vazhdueshme me qëllim dhënien e sigurisë objektive, si dhe këshillimin e menaxhimit për arritjen e objektivave nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike të veprimeve që realizohen nëpërmjet sistemit për të garantuara sigurinë e të dhënave, si dhe minimizimin e kostove operacionale.
Gjithashtu të merren masa për mbulimin me auditim të brendshëm IT të sistemeve IT, në Drejtorinë e IT-së dhe Zhvillimit në përputhje me përcaktimet ligjore.
Nga auditimi rezulton se: programi i auditimit është miratuar për këtë vit në Këshillin Mbikqyrës përpara këtij rekomandimi. Gjatë kësaj periudhe nuk është zhvilluar asnjë auditim me drejtime në IT, megjithëse angazhimi është marrë. AB nuk ka hartuar asnjë propozim për ndryshim programi deri në këto momente me qëllim miratimin në Këshillin Mbikqyrës të auditimit IT, për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.

Rekomandimi nuk është zbatuar

28. Gjetje nga auditimi: Posta Shqiptare, që prej vitit 2012 e në vazhdim, për ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të Eternës ka investuar (blerë) në totale **176,091,320** lekë, pa

TVSH. Ndërsa për mirëmbajtjen e këtyre sistemeve që nga viti 2014 ka lidhur10 kontrata të njëpasnjëshme që vazhdojnë të kenë afat deri në mesin e vitit 2024, me vlerë të përgjithshme **158,200,000 lekë pa TVSH**. Sistemet e Eterna përfshijnë dhe mbulojnë, shërbimet financiare (arkëtime, pagesa, transferta bankare, etj.) dhe proceset e shërbimeve postare. Të gjitha procedurat e prokurimeve si të blerjeve të sistemit ashtu edhe të mirëmbajtjes së tij, janë fituar nga i njëjti Operator Ekonomik**,** "H. S.". Fillimisht në korrik të vitit 2012 është realizuar procedura e prokurimit me objekt: "Blerje informatizimi i sporteleve, gjurmimi kombëtar i objekteve postare dhe euroxhiro kombëtare". Kjo blerje e sistemit është realizuar me procedurë me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për arsye të së drejtës së autorit dhe është konkretizuar më lidhjen kontratës së furnizimit nr.1029/4, datë 21.08.2012, me operatorin fitues "H. S.", ***me vlerë 51,791,320 lekë***, pa TVSH. Mbas vënies në funksionim së sistemit, në datën 03.04.2014 është realizuar edhe procedura me negocim për mirëmbajtjen e këtij sistemi, me afat 3 vjet, me vlerë totale 26,850,000 lekë, pa TVSH. Në këtë procedurë për arsye të së drejtës së autorit i është dërguar ftesë për ofertë operatorit "H. S." me të cilin është lidhur edhe ***kontrata e mirëmbajtjes nr.1069/7, datë 14.05.2014, me vlerë 26,850,000 lekë***, pa TVSH, me afat 3 vjet (deri në datën 13.05.2017). Hartimi dhe kohëzgjatja e kontratës së mirëmbajtjes, ka buruar nga kërkesat e VKM nr. 723, datë 01.09.2010, i ndryshuar me VKM. 710, datë 21.8.2013, "*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit",* e cila përcakton se, kontratat e mirëmbajtjes duhet të jenë jo më të shkurtra se 2 (dy) vjet. Në zbatim të kësaj VKM, Ministrit për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit, ka nxjerrë Udhëzimin nr.2, datë 02.09.2013 **"***Për Standardizimin e Hartimin e Termave të Referencës për Projektet TIK në Administratën Publike".* Në germën "e", të pikës 8, të kreut II, të këtij udhëzimi përcaktohet se, për propozimet e kërkuara, institucionet gjatë hartimit të termave të referencës për projektet TIK duhet të marrin në konsideratë çështjet që: **"*Të sigurojnë pronësinë e Kodeve Burimore (source code) dhe /ose të drejtën për të blerë Kodet Burimore. Pronësinë e Kodeve Burimore, analiza e projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha sistemeve të aplikimit të zhvilluara do ti kalojnë institucionit pa asnjë kosto shtesë*"**
Kontrata e mirëmbajtjes e sipërcituar me nr.1069/7, datë 14.05.2014, në asnjë nen të saj nuk ka të përcaktuar këtë dispozitë, por në nenin 11, ka përcaktuar se: *"Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik.* ***Pronësia intelektuale dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit"***. Pra, Posta Shqiptare ndryshe nga ç 'kërkohet në përcaktimet apo rekomandimet e këtij udhëzimi, nuk ka marrë dhe nuk ka bërë pronë të saj Kodet në Burim, Analizat e Projektimit, burimin dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha moduleve të sistemeve të Eternës.

28.1. Rekomandimi: Posta Shqiptare, në Dokumentet e Tenderit dhe në kushtet e kontratave të çdo procedure prokurimi që do të realizojë për blerjen edhe mirëmbajtjen e çdo sistemi teknologjie informacioni që do të aplikojë dhe zhvillojë, duhet të përcaktojë që:

-"Posta Shqiptare, në përfundim të kontratës së furnizimit apo të afatit të garancisë së pajisjeve dhe sistemit, apo në përfundim të afatit të kontratës së parë të mirëmbajtjes (sipas përcaktimeve të VKM. 710, datë 21.8.2013), pronësia e Kodeve Burimore (source code), analizat e projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të sistemit, do ti kalojnë Postës Shqiptare Sh.a, pa asnjë kosto shtesë".

Nga auditimi rezulton se: PSH e ka bërë kërkesën për kodin në burim tek operatori zhvillues i sistemit Eterna me shkresën me nr. 1596 dt.04.07.2022 dhe ka kërkuar kalimin e pronësisë së kodit burim, brenda afatit 10 ditor. Deri në një përgjigje nëse kjo kërkesë do të pranohet apo jo nga zhvilluesi atëherë do të mund të zbatohet pjesa tjetër e rekomandimit.

Rekomandimi është në proces zbatimi

29. Gjetje nga auditimi: Problematika e trajtuar më sipër, është mbartur dhe konstatuar në të gjitha procedurat e prokurimeve të realizuara për blerjen edhe mirëmbajtjen e sistemeve Eterna edhe gjatë periudhës objekt auditimi. Gjate kësaj periudhe, janë realizuar 6 procedura prokurimi të "Hapura" me fond limit në totale 103,649,850 lekë, pa TVSH dhe janë lidhur 6 kontrata për mirëmbajtjen e sistemeve të Eterna me vlerë totale 103,550,000 lekë, pa TVSH. Konkretisht: "Blerje Posta retail outlet dhe mirëmbajte për 4 vjet", me fond limit: 30,999,850 lekë, pa TVSH, të realizuar në datën 13.05.2019, me fitues OE "H. S.", me vlere oferte të barabartë me fondin limit; "Mirëmbajtje Eterna Gateëay Application për 4 vite", me fond limit 20,000,000 lekë, pa TVSH, të realizuar në datën 14.05.2019, me fitues OE "H. S.", me vlerë oferte të barabartë me fondin limit; "Mirëmbajtja e Moduleve të Eternes për 4 vjet", me fond limit 9,450,000lekë, pa TVSH, të realizuar në datën 31.05.2019, me fitues OE "H. S.", me vlere oferte të barabartë me fondin limit; "Blerje Eterna BI dhe Mirëmbajtje BI për 4 vite", me fond limit 41,000,000 lekë, pa TVSH, të realizuar në datën 22.07.2019, me fitues OE "H. S.", me vlere oferte të barabartë me fondin limit; "Mirëmbajtja e Sistemit Eterna për 3 vite", me fond limit 27,000,000 lekë, pa TVSH, të realizuar në datën 05.05.2020, me fitues OE "H. S.", me vlere oferte të barabartë me fondin limit; "Mirëmbajtja E-Posta për 4 vite", me fond limit 20,000,000 lekë, pa TVSH, të realizuar në datën 03.08.2020, me fitues OE "H. S.", me vlere oferte të barabartë me fondin limit. U konstatua:

29.1. Gjetje nga auditimi: Të 6 procedurat janë zhvilluara të hapura, por në procedura ka pasur mungesë të theksuar konkurrence pasi në to ka marrë pjese vetëm operatori "H. S.", i cili është shpallur edhe fitues dhe ka lidhur kontratat e zbatimit. Mungesa e theksuar e konkurrencës ka ardhur si pasojë e hartimit dhe vendosjes në DT të kërkesave të veçantë në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik. Konkretisht është kërkuar që: *"OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Softëare të instaluar tek Posta Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program"; "Operatori ekonomik, qofte zotëruesi i të drejtës se autorit ose i autorizuar prej tij, duhet te disponoje kodin ne burim,* ***pasi Posta Shqiptare nuk e disponon këtë kod".***

Kërkesa këto që sipas germës b, të pikës 2, të nenit 33 ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" dhe germës b, të pikës 2, të nenit 36, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave te Prokurimit Publik" duhet të vendoset dhe përdoret për procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, pasi në këto dispozita përcaktohet se: për arsye, që lidhen me mbrojtjen e së drejtës ekskluzive ose së drejtës së autorit, kontrata mund të lidhet me një operator të vetëm ekonomik dhe ekzistenca e kushti duhet të vërtetohet dhe të dokumentohet nga autoritetet kontraktore.

Pra në bazë të këtyre dispozitave zhvillohen vetëm procedurat me negocim, dhe jo procedurat e hapura apo dhe procedurat e tjera. Vendosja e këtyre kërkesave nuk argumentohet sepse, Posta Shqiptare mbas përfundimit të kontratës së mirëmbajtjes të lidhur me ***nr. 1069, datë 14.05.2014***, duhet të kishte marrë dhe të bënte pronë të saj, Kodet në Burim të sistemeve të Eternës.

29.2. Gjetje nga auditimi: Përveç se është konstatuar nga auditimi që këto kritere të veçanta kualifikuese janë hartuar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, janë vërejtur si të tilla dhe janë rekomanduar për ti ndryshuar edhe nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP).

Me shpalljen e të 6 procedurave në sistemin elektronik, APP për çdo procedurë, nëpërmjet email-eve, ka njoftuar Postën Shqiptare duke i sjell në vëmendje nevojën e saktësimit dhe mirë argumentimin ligjor dhe teknik në lidhje me disponimin e së Drejtës së Autorit për programin Eterna Softëare, duke mbajtur parasysh faktin se, kriteret e veçanta të kualifikimit duhet të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohen, jo diskriminuese dhe konform rregullave të prokurimit publik. Po kështu, rekomandon një

argumentim teknik në lidhje me faktin e mos disponimit të Kodit në Burim nga ana e AK se, sistemi në fjalë është ekzistues, dhe rrjedhimisht ***mund të ishte i disponueshëm nga vetë AK pas implementimit të sistemit aktual, nga OE fitues***.
Mirëpo, AK nuk ka bërë ndryshimin e këtyre kritereve, por për të 6 procedurat i ka dërguar informacion APP se, vendosja e këtyre kritereve mbështetet në, germën b, të pikës 2, të nenit 33 ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" dhe nenit 55, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave te Prokurimit Publik". Dhe ka interpretuar se, këto kërkesa janë vendosur, për arsye teknike dhe artistike që kanë lidhje me të drejtën ekskluzive të pronësisë intelektuale dhe kontrata mundë të ekzekutohet vetëm me një operatorë të veçantë. Ky sqarim apo interpretim i AK është i pakuptimit sepse nga njëra anë përpiqet të argumentojë se, hartimi dhe vendosja e këtyre kërkesave është mbështetur dhe bazuar në nenin 33 të LPP dhe nenin 55 te VKM, dispozita të cilat përcaktojnë rastet kur përdoret procedura "me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës" dhe nga ana tjetër ka organizuar procedura të "Hapura".
29.3. Gjetje nga auditimi: Po kështu në të 6 kontratat e mirëmbajtjes së lidhur me OE "H. S." është vendosur kushti që: "Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. ***Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit***".
Ky veprim ka bërë që ky operatorë të këtë të drejtën ekskluzive ose të drejtën e autorit për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e këtij sistemi për një kohë të gjatë, të paktën deri në përfundimin e kontratës së datës 31.08.2020 që ka afat deri në mesin e vitit 2024.
Pra, me vendosjen e këtij kushti në përfundim të çdo kontrate, kodet në burim nuk i kalojnë në pronësi Postës Shqiptare, por mbeten përsëri pronë e kontraktuesit, madje deri në amortizimin e plotë dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të sistemit Eterna. Për pasojë nga vendosja e këtij kushti kontraktual, blerja e moduleve të tjera të sistemit Eterna dhe shërbimi i mirëmbajtjes së tyre, përqendrohet dhe monopolizohet vetëm te operatori "H. S.".
29.1. Rekomandim: Posta Shqiptare Sh.a, të gjejë rrugët e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit për të negociuar me OE "H. S." me qëllim heqjen nga kontrata e datës 31.08.2020, për "Mirëmbajtjen E-Posta për 4 vite" të kushtit**:** "Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit".
Nga auditimi rezulton se: PSH e ka bërë kërkesën për kodin në burim tek operatori zhvillues i sistemit Eterna me shkreswn me nr. 1596 dt.04.07.2022 dhe ka kërkuar kalimin e pronwsisw së kodit burim, brenda afatit 10 ditor. Deri në një përgjigje nëse kjo kërkesë do të pranohet apo jo nga zhvilluesi atëherë do të mund të zbatohet pjesa tjetër e rekomandimit.

Rekomandimi është në proces zbatimi

29.2. Rekomandim: Posta Shqiptare, në Dokumentet e Tenderit të çdo procedure prokurimi të hapur që do të realizojë për blerjen e moduleve dhe për mirëmbajtjen e sistemeve Eterna, të marrë në konsideratë rekomandimet e APP, dhe të mos vendosë kërkesat e veçanta që: "OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Softëare të instaluar tek Posta Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program"; "Operatori ekonomik, qofte zotëruesi i të drejtës se autorit ose i autorizuar prej tij, duhet te disponoje kodin ne burim, pasi Posta Shqiptare nuk e disponon këtë kod".
Nga auditimi rezulton se: PSH e ka bërë kërkesën për kodin në burim tek operatori zhvillues i sistemit Eterna me shkresën me nr. 1596 dt.04.07.2022 dhe ka kërkuar kalimin e pronësisë

së kodit burim, brenda afatit 10 ditor. Deri në një përgjigje nëse kjo kërkesë do të pranohet apo jo nga zhvilluesi atëherë do të mund të zbatohet pjesa tjetër e rekomandimit.

Rekomandimi është në proces zbatimi

29.3. Rekomandim: Posta Shqiptare Sh.a, me përfundimin të kontratës së lidhur në datën 31.08.2020, me OE "H. S." për "Mirëmbajtjen E-Posta për 4 vite", me vlerë 20,000,000 lekë, pa TVSH, në kushtet e Veçanta dhe të Përgjithshme të kontratave që do të realizohen në procedurat e prokurimeve vijuese për shërbimin e mirëmbajtjes të sistemeve Eterna, të vendosë kushtin që: "*Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit do të jetë dhe do të mbetet pronë e Postës Shqiptare*".

Nga auditimi rezulton se: PSH e ka bërë kërkesën për kodin në burim tek operatori zhvillues i sistemit Eterna me shkresën me nr. 1596 dt.04.07.2022 dhe ka kërkuar kalimin e pronësisë së kodit burim, brenda afatit 10 ditor. Deri në një përgjigje nëse kjo kërkesë do të pranohet apo jo nga zhvilluesi atëherë do të mund të zbatohet pjesa tjetër e rekomandimit.

Rekomandimi është në proces zbatimi

30. Gjetje nga auditimi: Në të 6 procedurat e prokurimit, vlerat e kontratave të mirëmbajtjes (fondet limite) janë llogaritur në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 për "Prokurimin Publike" dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Për çdo procedurë janë marrë në treg, 3 apo 4 oferta dhe fondi limit është llogaritur bazuar në ofertën më të ulët. Në të 6 procedurat e prokurimit, një nga operatorët që u është kërkuar dhe marrë ofertë është edhe OE "H. S.".

Pra nga njëra anë AK, vendos kufizimin e konkurrencës në treg nëpërmjet të drejtës së autorit dhe nga ana tjetër ka marrë oferta në treg të cilat nuk mundë të përgjigjen vlerës së shërbimit të prokuruar sepse të drejtën e mirëmbajtjes së këtij sistemi sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të mëparshme të mirëmbajtjes e ka në mënyrë ekskluzive vetëm operatori "H. S.". Po kështu, në llogaritjen e fondit limit për të gjitha kontratat e mirëmbajtjes nuk është marrë në konsideratë raporti kosto-përfitim, bazuar në amortizimin moral dhe fizik të këtij sistemi dhe në vlerën e mbetur në kontabilitet sipas pasqyrave financiare të çdo viti.

30.1. Rekomandim: Posta Shqiptare, të analizojë shpenzimet dhe kostot faktike të shërbimeve të mirëmbajtjes së sistemeve Eterna dhe në procedurat e tjera të prokurimeve që do të realizojë, të llogarisë vlerën e kontratës së mirëmbajtjes (fondin limit) duke marrë në konsideratë, amortizimin moral dhe fizik të këtij sistem, vlerën e pasqyruar në kontabilitet dhe raportin kosto-përfitim.

Nga auditimi rezulton se: Programi ekonomik për shpenzimet i miratuar për 2022 nga MIE ka si vlerë mirëmbajtje një vlerë 25% më pak se vitet e kaluara, por mungon analiza kosto përfitim se si u arrit në këtë përllogaritje.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

31. Gjetje nga auditimi: Siç u trajtua më sipër, mungesa e pronësisë së kodeve në burime ka bërë që të gjitha kontratat e mirëmbajtjes së sistemit Eterna duke filluar që nga viti 2017, edhe pse janë zhvilluar me procedura të hapura, janë lidhur në mungesë të theksuar të konkurrencës, pasoja e të cilës ka sjellë ekskluzivitetin dhe monopolizimin e blerjeve dhe të mirëmbajtjes së sistemit Eterna, duke i përqendruar këto mallra dhe shërbime vetëm te i njëjti operatorë, te operator "H. S.".

Nga ky veprim nuk është rritur pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit dhe nuk është siguruar mirë përdorimi i fondeve dhe ulja e shpenzimet procedurale për shërbimin e mirëmbajtjes, pasi ky operatorë në të gjitha procedurat e prokurimit ka ofruar ofertën ekonomike pothuajse të barabartë me fondin limit. Për pasojë shpenzimet e mirëmbajtjes janë relativisht të larta kundrejt kostos së blerjeve së vetë sistemit Eterna, të cilat shkojnë rreth 15-18 % për çdo vit.

Kështu, për gjatë gjithë kohës së funksionimit të sistemit që nga viti 2014 deri në vitin 2024, shpenzimet progresive për shërbimin e mirëmbajtjes kanë shkuar në vlerën **158,200,000** lekë pa TVSH, ose përbëjnë 90%, të vlerës progresive të blerjeve të gjithë sistemit Eterna që janë në shumën **176,091,320** lekë, pa TVSH.
Megjithatë kosto e lartë e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemeve të teknologjisë së informacionit vjen edhe si pasojë e vetë natyrës së këtij shërbimi, të cilat nuk janë shumë të mirënjohura në tregun vendas sepse ato nuk janë të natyrës fizike por me tepër janë të një natyre intelektuale që lidhen me të drejtën ekskluzive apo të drejtën e autorit dhe për këto shpenzime në treg nuk ka kosto të normuara apo çmime referuese. Kjo dhe për faktin se, AKSH apo ministria e linjës që mbulon fushën e Teknologjisë së Informacionit nuk kanë hartuar normativa, manuale, preventiva, apo udhëzues të veçantë, për përcaktimin e çmimeve orientuese, mbështetur në specifikimet teknike të çdo lloj sistemi teknologjie informacionit dhe në modelet dhe praktikat më të mira të vendeve Evropiane dhe mbi bazën e këtyre çmimeve të llogariteshin shpenzimet e mirëmbajtjes.
31.1. Rekomandim: Posta Shqiptare, bazuar në modelet dhe praktikat më të mira të vendeve Evropiane, të marrë iniciativën dhe ti kërkojë, MFE me cilësinë e aksionarit, AKSHI dhe Ministrisë së linjës që mbulon fushën e teknologjisë së informacionit që, të hartojnë normativa, manuale, apo udhëzues të veçantë, për përcaktimin e çmimeve orientuese për çdo lloj sistemi që ka të bëjë me teknologjinë e informacionit dhe mbi bazën e tyre të llogariten vlerat e kontratave të blerjeve dhe kontratave të shërbimeve për mirëmbajtjen e tyre.
Nga auditimi rezulton se: Ky rekomandim nuk është papranuar.

Rekomandimi nuk është pranuar

32. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitin 2013, por dhe para këtij viti, Posta Shqiptare Sh.a. ka blerë dhe ka vendosur në funksionim rrjetin dhe pajisjet e rrjetit Data Center (serverët). Sipas regjistrimit në kontabilitet në fund të vitit 2013, këto pajisje janë në vlerën **totale 35,500,200 lekë,** pa TVSH. Deri në fund të vitit 2018 (31.12.2018) kane akumuluar një amortizim në vlerën 29,908,996 lekë dhe vlera e mbetur e tyre në fund të këtij viti është 5,591,2014 lekë. Po në vitin 2018 është bërë rivlerësimi i aseteve të Postës Shqiptare dhe rrjeti dhe pajisjet e Data Center kanë marrë një vlerë të re, duke u rivlerësuar në vlerën 10,650,080 lekë.
Për mbulimin me shërbimin e mirëmbajtjes së Data Center, nga vënia në funksionim në vitin 2014 dhe deri në datën 30.06. 2021, Posta shqiptare ka realizuar 6 procedura prokurimi të hapura dhe ka lidhur 6 kontrata me afate 1 vjeçare, me vlerë totale 73,291,455 lekë, pa TVSH (87,949,746 lekë, me TVSH). Konkretisht: kontrata me nr.1751/5, datë 16.09.2013, me vlerë 16,187,280 lekë; kontrata me nr.3388/5, datë 30.12.2015, me vlerë 15,208,376 lekë; kontrata me nr.406/15, datë 22.12.2017, me vlerë 13,721,520 lekë; kontrata me nr.3377/13, datë 18.03.2019, me vlerë 14,277,720 lekë; kontrata me nr.751/13, datë 23.06.2020, me vlerë 14,277,720 lekë; kontrata me nr.1069/8, datë 06.08.2021, me vlerë 14,277,600 lekë.
Siç tregojnë këto shifra, vlera vjetore e shpenzimeve për mirëmbajtjen kundrejt vlerës së blerjes së sistemit dhe të pajisjeve Data Center, shkojnë për çdo vit rreth 34-35%, ose, vlera e shpenzimeve progresive të mirëmbajtjes kundrejt vlerës totale të blerjes së sistemit dhe pajisjeve Data Center që, nga viti 2014 deri në datën 30.06.2021, ka shkuar rreth 206% (73,291,455 lekë/ 35,500,200 lekë). Kosto e lartë e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve dhe të rrjetit Data Center vjen edhe si pasojë e vetë natyrës së këtij shërbimi, të cilat nuk janë shumë të mirënjohura në treg vendas sepse përveç se janë të natyrës fizike janë edhe të një natyre intelektuale profesionale dhe për shpenzimet e këtij shërbimi në tregun vendas nuk ka kosto të normuar apo çmime referuese.
Kosto e lartë e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit dhe pajisjeve Data Center, tregohet qartazi edhe në procedurat prokurimeve të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, për shërbimin e mirëmbajtjes. Konkretisht, gjatë kësaj periudhe janë realizuar 3 procedura prokurimi të hapura

me fond limit në total 36,000,000 lekë, pa TVSH (12,000,000 lekë për procedurë). Të tre procedurat të realizuara për çdo vit, janë fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik (BOE) "D. & B." me ofertë ekonomike pothuajse të barabartë me fondin limit, me një kursim të vogël në vlerën 305,800 lekë. Me këtë BOE janë lidhur 3 kontrata për shërbimin e mirëmbajtjes së Data Center, me vlerë totale 35,694,200 lekë, pa TVSH (42,833,040 lekë, me TVSH), përkatësisht, kontrata e datës 18.03.2019, me vlerë 14,277,720 lekë; kontrata e datës 23.06.2020, me vlerë 14,277,720 lekë dhe kontrata e datës 06.08.2021, me vlerë 14,277,600 lekë.

32.1. Rekomandim: Posta Shqiptare, të ngrejë një grup pune të veçantë me specialistë të fushës për të analizuar gjendjen teknike e fizike të rrjetit dhe pajisjeve Data Center dhe në varësi të amortizimit të tyre, të analizoje kostot e mirëmbajtjes duke marrë në konsideratë raportin kosto-përfitim. Në rast se, përfitimi është në raport të zhdrejtë me koston, pra shpenzimet e mirëmbajtjes tejkalojnë vlerën e sistemit dhe të pajisjeve, atëherë të shikohet mundësia e blerjes së sistemit dhe pajisjeve të reja. Në procedurat e prokurimit që do të realizohen, në dokumentet e tenderit të kërkohet që, shërbimi i mirëmbajtjes të kryhet nga operatori fitues, me afat sipas përcaktimeve të VKM 710, datë 21.8.2013, "*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*".

Nga auditimi rezulton se: gjendja teknike është analizuar dhe janë parshikuar në programin ekonomik të vitit 2022 miratuar nga MIE me shkresën nr. 23408/3, datë 11.02.2022 disa zëra për pajisje te rrjetit në dhomën primare të Data Center, për të cilat është lidhur një kontratë me nr.1483/27, datë 20.04.2022 për blerjen e pajisjeve hardware në dhomën primare të serverëve, blerje licensash virtualizimi, upgrade dhe migrim Exchange server dhe active directory.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht

33. Gjetje nga auditimi: Të shtrirë në vitin 2020 dhe vitin 2021, Posta Shqiptare ka realizuar procedurën e prokurimit me objekt "Blerje Tonerë, Bojëra Printeri", me fond limit 60,034,800 lekë. Në tenderin e zhvilluar në datën 13.05.2020, kanë marrë pjesë 2 operatorë: OE "I. O.", me ofertën ekonomike në vlerën 38,597,810.82 lekë, pa TVSH, ose 35.7%, më të ulët se fondi limit dhe OE "E. C." me ofertën ekonomike në vlerën 47,130,000 lekë, pa TVSH, ose 21.5 %, më ulët se fondi limit. U konstatua se, AK në kundërshtim me parashikimet e neneve 20 dhe 46 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" dhe nenit 27, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ka kërkuar dhe vendosur në DT, disa kritere të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk janë hartuar në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohen dhe nuk janë konform rregullave të prokurimit publik. Pikërisht këto kërkesa janë bërë shkak që, KVO gjatë shqyrtimit të ofertave teknike të 2 operatorëve pjesëmarrës, ka s'kualifikuar OE "I. O." i cili ka ofertën ekonomike më të ulët se operatori tjetër, me diferencë ***10,238,628 lekë me TVSH***.

Për pasojë, OE "I. O.", ka bërë disa ankime pranë AK dhe KPP, dhe për këtë arsye procesi i realizimit të kësaj procedurë është tej zgjatur, gati rreth 1 vit (ka filluar me shpalljen e kontratës për prokurim në datën 26.03.2020 dhe ka përfunduar me lidhjen e kontratës së furnizimit në datën 15.02.2021). Veprime apo mosveprime këto që, kanë cenuar, qëllimin e ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" të parashikuar në pikën 2 të nenit 1, që është: "Rritja efiçencës dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik; sigurimi për mirë përdorimin e fondeve publike dhe për uljen e shpenzimeve procedurale; nxitja e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë; nxitja e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë; trajtimin e barabartë dhe jo diskriminues të operatorëve ekonomikë, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit; sigurimin e integritetit, besimit publik dhe transparencës në

procedurën e prokurimit publik". Pasojat e kësaj parregullsie janë shmangur nga KPP, e cila me Vendimin nr. 600, datë 24.12.2020, ka vendosur kualifikimin dhe shpalljen fitues të OE "I. O.", duke eliminuar kështu, shkeljet dhe dëmin ekonomik që mund ti shkaktohej Postës Shqiptare në vlerën 10,238,628 lekë.

33.1. Rekomandimi: Posta Shqiptare Sh.a, në të gjitha procedurat e tjera të prokurimeve, duhet të mbajë parasysh faktin që, kriteret e veçanta të kualifikimit, të hartohen konform rregullave të prokurimit publik, të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohet dhe të sigurojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Nga auditimi rezulton se: për vitin 2022 nuk rezulton të jetë hapur ndonjë procedurë prokurimi në drejtim të IT. Meqënëse ky rekomandim është pranuar dhe nga PSH është marrë angazhimi për ta mbajtur në konsideratë dhe afati për zbatimin e tij është në vijimësi do të konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces zbatimi

34. Gjetje nga auditimi: Në të 6 procedurat e prokurimit të mirëmbajtjes së sistemeve Eterna, në 3 procedurat e prokurimit të mirëmbajtjes së Data Center dhe në procedurën e prokurimit për blerjen e tonerëve dhe bojërave te printerit, të trajtuar më sipër, konstatohet se: dy nga kriteret e veçanta kualifikuese që kanë lidhje me përmbushjen e kapacitetit ekonomik dhe teknik, janë vendosur në interpretim të gabuar të pikës 3 dhe germës b, të pikës 4, të nenit 28 të, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Konkretisht në DT të çdo procedure është kërkuar që: "*OE duhet të paraqesë furnizime me natyrë ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlere jo me pak* ***se 39 %*** *e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet"; "OE duhet të paraqesë, vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore të tre viteve të fundit me vlerë jo më pak* ***se 39 %*** *e vlerës limit të kontratës që prokurohet"*. Pra vendosja e kufirit 39% për përmbushjen e këtyre kërkesave, kuptohet sikur vlera e xhiros vjetore dhe vlera e kontratave të ngjashme duhet të jene mbi 40% të vlerës që prokurohet, në kundërshtim kjo me dispozitat e sipërcituara të cilat përcaktojnë se:

"Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit dhe në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit";

"Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon, kopje të deklaratave të xhiros vjetore, dhe në çdo rast, vlera e kërkuar nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet".

34.1. Rekomandimi: Posta Shqiptare Sh.a, në të gjitha procedurat e tjera të prokurimeve, duhet të mbajë parasysh faktin që, për përmbushjen e kapacitetit ekonomik dhe teknik kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen dhe të jenë në përputhje dhe brenda kufijve të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik.

Nga auditimi rezulton se: për vitin 2022 nuk rezulton të jetë hapur ndonjë procedurë prokurimi në drejtim të IT. Meqënëse ky rekomandim është pranuar dhe nga PSH është marrë angazhimi për ta mbajtur në konsideratë dhe afati për zbatimin e tij është në vijimësi do të konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces zbatimi

35. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit *"Mirëmbajtje Sistemit VOIP"* u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, krahas faturës së shërbimit mungojnë procesverbalet e monitorimit të ofrimit të shërbimit nga ana e përfaqësuesit të "Posta Shqiptare Sh.a" dhe përfaqësuesit të

Kontraktuesit, ashtu siç janë sjell për muajin Nëntor, Dhjetor 2019 dhe Janar, Shkurt, Mars 2020.

35.1.Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të mbajnë procesverbalet mbi monitorimin e ofrimit dhe cilësisë të shërbimit sipas kushteve të kontratës.

Nga auditimi rezulton se: nuk kemi asnjë rast të realizuar të cilin të verifikojmë nëse eshtë realizuar, por meqë ky rekomandim nuk është kundërshtuar nga PSH dhe afati për zbatimin e tij është në vijimësi do të verifikohet zbatueshmëria e tij në auditimet e ardhshme.

Rekomandimi është në proces zbatimi

36. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "*Mirëmbajtje Sistemit VOIP"* u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, mungojnë librat e historikut (LogBook) për secilën pajisje në të cilën shënohen të gjitha veprimet e kryera mbi pajisje.

36.1.Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të bëjnë të mundur që për secilën pajisje të shoqërohet me logbook-un përkatës sipas kushteve të kontratës.

Nga auditimi rezulton se: Drejtoria e IT ka vendosur që të kryejë me specialistët e saj mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve, duke sjellë një kursim të fondeve të shoqërisë për këtë qëllim. Kjo vendimmarrje e cila mbështetet në kapacitetet profesionale të specialistëve të kësaj drejtorie, bën që ky rekomandim të mos jetë i pranueshëm për zbatim.

Rekomandimi nuk është pranuar

37. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit *"Mirëmbajtje Sistemit VOIP"* u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, mungon njoftimi me shkrim për listën e pajisjeve të mbuluar me shërbimin e mirëmbajtjes duke përfshirë sasinë, vendndodhjen e këtyre pajisjeve 90 ditë para fillimit të negocimi për rinovim të marrëveshjes së mirëmbajtjes pasi më datë 1.10.2021 ka përfunduar Kontrata e mirëmbajtjes së Sistemit VOIP.

37.1.Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të bëjnë të mundur që 90 ditë para fillimit të negocimit për rinovim të marrëveshjes së mirëmbajtjes të bëjnë njoftimin me shkrim për ndryshimet në listën e pajisjeve të mbuluar me shërbimin e mirëmbajtjes.

Nga auditimi rezulton se: Drejtoria e IT ka vendosur që të kryejë me specialistët e saj mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve, duke sjellë një kursim të fondeve të shoqërisë për këtë qëllim. Kjo vendimarrje e cila mbështetet në kapacitetet profesionale të specialistëve të kësaj drejtorie, bën që ky rekomandim të mos jetë i pranueshëm për zbatim.

Rekomandimi nuk është pranuar

38. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit *"Mirëmbajtje Sistemit VOIP"* u konstatua **s**e pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, mungojnë raportet mujore që duhet të ishin sjellë nga O.E. ku parashtrohen të gjitha aktivitetet e realizuara në atë muaj edhe nëse nuk ka pasur problematika, në kundërshtim me Nenin 10 pika 5 të Kontratës me objekt "Mirëmbajtje Sistemi VOIP" nr.1702/9 datë 01.10.2019.

38.1 Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të bëjnë të mundur që 90 ditë para fillimit të negocimit për rinovim të marrëveshjes së mirëmbajtjes të bëjnë njoftimin me shkrim për ndryshimet në listën e pajisjeve të mbuluar me shërbimin e mirëmbajtjes.

Nga auditimi rezulton se: Drejtoria e IT ka vendosur që të kryejë me specialistët e saj mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve, duke sjellë një kursim të fondeve të shoqërisë për këtë qëllim. Kjo vendimmarrje e cila mbështetet në kapacitetet profesionale të specialistëve të kësaj drejtorie, bën që ky rekomandim të mos jetë i pranueshëm për zbatim.

Rekomandimi nuk është pranuar

39. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit *"Blerje Hibrid Mail"* u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, shpenzimet për projekte investimesh ku përfshihen shpenzimet kapitale në infrastrukturë, ku në këtë rast janë blerje e pajisjeve të mëdha teknologjike, në fazën e planifikimit buxhetor të shpenzimeve nuk është kryer një analizë kosto-përfitim e projektit për një menaxhim sa më efektiv të shpenzimeve.
39.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi planifikimin buxhetor të shpenzimeve të njësisë, në rastet kur vlera e shpenzimeve/investimeve është në vlera të larta, të kryejnë një analizë kosto-përfitim të shpenzimeve/investimeve në fjalë.
Nga auditimi rezulton se: ky rekomandim do të konisderohet në process zbatimi me aprovimin nga Administratori i shoqërisë. Rekomandimi do të konsiderohet i zbatuar kur të merret miratimi nga Këshilli Mbikqyrës.

Rekomandimi është në proces zbatimi

40. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit *"Blerje Hibrid Mail"* u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, meqenëse Sistemi i Hibrid Mail është sistem i ri në fushën e TIK-ut dhe ka nevojë për mirëmbajtje, duhet të ishte parashikuar MNSH-në, si pjesë të procedurës së realizimit të investimit për këtë sistem si dhe kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje duhet ishte jo më e shkurtër se 4 (katër) vjet.
40.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e procedurës së prokurimit në fjalë të hartojnë MNSH-në bazuar në praktikat më të mira.
Nga auditimi rezulton se: është parashikuar në programin ekonomik të miratuar me shkresën nr.23408/3, datë 11.02.2022, prandaj do të konsiderohet në process.

Rekomandimi është në proces zbatimi

41. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit *"Blerje Hibrid Mail"* u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit, me anë të urdhrit nr. 34/26 datë 23.01.2020 është ngritur Komisioni mbi marrjen në dorëzim të "Blerje Hibrid Mail", por mungon Procesverbali mbi marrjen në dorëzim gjithashtu i cili shoqërohet dhe më një kolaudim mbi funksionimin e saj.
41.1Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të bëjnë të mundur kryerjen e kolaudimit të pajisjes dhe mbajtjen e procesverbaleve në mënyrë intervalore.
Nga auditimi rezulton se: meqënëse ky rekomandim është kërkuar të zbatohet në vijimësi ky proces do të konsiderohet në zbatim pasi nuk është një proces i cili fillon dhe përfundon vetëm një herë por i vazhdueshëm në cdo rast të ndjekjes dhe zbatimit të kontratave të nënshkruara nga PSH.

Rekomandimi është në proces zbatimi

42. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "*Blerje e vendosje pajisje sigurie (kamera vëzhgimi (VVTV), kamera për automjete, sisteme alarmi, Videowall për monitorimin e sistemeve të sigurisë"* u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, gjatë hartimit të specifikimeve teknike nuk janë sqaruar

qartë zërat mbi skicimet mbi instalimin e pajisjeve, pozicionet e tyre për të arritur më pas në caktimin e dy zërave si F.V. Kabull Alarmi dhe F.V. Kabull rg59 + Ushqimi.

42.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e specifikimeve teknike në procedurat e ardhshme të prokurimeve, gjatë hartimit të specifikimeve teknike, të bazohen në rregulloret dhe legjislacionin përkatës.

Nga auditimi rezulton se: ky rekomandim është pranuar nga PSH sh.a dhe ka një afat zbatimi në vijimësi, çfarë do të verifikohet në auditimet e ardhshme, për këtë arsye do të konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces zbatimi

43. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "*Blerje e vendosje pajisje sigurie (kamera vëzhgimi (VVTV), kamera për automjete, sisteme alarmi, Video ëall për monitorimin e sistemeve të sigurisë"* u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, vendosja e kritereve të veçanta që O.E duhet të ketë kompatibiliteti me sistemet ekzistuese që janë kamerat Hikvision, sistemet e alarmit Messer GPRS dhe Radio, Sistemet GPS Meitrack nuk lejon zhvillimin e një gare të barabartë, dhe duket një kriter diskriminues.

43.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe të kritereve të veçanta në procedurat e ardhshme të prokurimeve, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe të kritereve të veçanta, të kenë kujdes që kriteret e vendosura të mos jenë diskriminuese duke penalizuar operatorë që të jenë pjesëmarrës në garë.

Nga auditimi rezulton se: ky rekomandim është pranuar nga PSH sh.a dhe ka një afat zbatimi në vijimësi, çfarë do të verifikohet në auditimet e ardhshme, për këtë arsye do të konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces zbatimi

44. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit *"Blerje palmar profesional, barkod reader me ëireless, lexues barkodesh"* u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, kriteri i veçantë nr. 2.5 ku thuhet që produktet e ofruara duhet të jenë Brand i njohur Ndërkombëtar është kriter diskriminues.

44.1.Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe të kritereve të veçanta në procedurat e ardhshme të prokurimeve, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe të kritereve të veçanta, të kenë kujdes që kriteret e vendosura të mos jenë diskriminuese duke penalizuar operatorë që të jenë pjesëmarrës në garë, pasi në shpjegimin tuaj ky lloj kriteri do të plotësojë kërkesat e cilësisë, origjinalitetin e mallrave nuk qëndron sepse janë certifikatat ato që i japin këto atribute dhe jo emri.

Nga auditimi rezulton se: ky rekomandim është pranuar nga PSH sh.a dhe ka një afat zbatimi në vijimësi, çfarë do të verifikohet në auditimet e ardhshme, për këtë arsye do të konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces zbatimi

47. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "*Shërbim Printimi dhe fotokopje*" u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, në caktimin e kritereve të veçanta cilësohet se shërbimi i kërkuar është i bazuar në një nivel të caktuar shërbimi SLA (Service Level Agreement), por që në asnjë rast kontrata nuk është trajtuar si një SLA.

47.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e procedurës së prokurimit në fjalë të hartojnë MNSH-në bazuar në praktikat më të mira.

Nga auditimi rezulton se: ky rekomandim është pranuar nga PSH sh.a dhe ka një afat zbatimi në vijimësi, çfarë do të verifikohet në auditimet e ardhshme, për këtë arsye do të konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces zbatimi

48. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "*Shërbim Printimi dhe fotokopje*" u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, nuk është mbajtur asnjë procesverbal mbi ecurinë e shërbimit, duke matur cilësinë e shërbimit për të arritur afrimin optimal të tij.
48.1 Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të bëjnë të mundur kryerjen e kolaudimit të pajisjes dhe mbajtjen e procesverbaleve në mënyrë intervalore
Nga auditimi rezulton se: ky rekomandim është pranuar nga PSH sh.a dhe ka një afat zbatimi në vijimësi, çfarë do të verifikohet në auditimet e ardhshme, për këtë arsye do të konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces zbatimi

49. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "*Blerje pajisje sigurie (sisteme alarmi, sisteme vëzhgimi DVR/NVR 4 kamera, 8 kamera, 16 kamera + instalim kabull …"* u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, salla e monitorimit të O.E. për eliminimin e defekteve mbulohet nga O.E. për 2 vite që është dhe garancia e produkteve. Pas dy vitesh meqenëse tërësia e produkteve funksionon si një sistem nuk është parashikuar mirëmbajtje dhe nuk është përcaktuar se kujt do ti kalojnë të drejtat e sallës së monitorimit. Meqenëse është zhvilluar një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit atëherë në procedurën e prokurimit duhet të ishte parashikuar dhe mirëmbajtja me qëllim ofrimin e shërbimit pa ndërprerje dhe parandalimin e humbjes ose të shkatërrimit të të dhënave.
49.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e procedurës së prokurimit në fjalë të hartojnë MNSH-në bazuar në praktikat më të mira.
Nga auditimi rezulton se: ky rekomandim është pranuar nga PSH sh.a dhe ka një afat zbatimi në vijimësi, çfarë do të verifikohet në auditimet e ardhshme, për këtë arsye do të konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces zbatimi

50. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "*Blerje Licenca Microsoft + shërbime të ndryshme për 2 vite"* u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, në caktim e specifikimeve teknike është përfshirë pika "Shërbime trajnimi dhe konsulence për paketën M365, Poëer BI, Ëindoës server, SQL server, Ëindoës Desktop" si dhe në kriteret e veçanta është kërkuar "Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar nga prodhuesi si trajnues zyrtarë të produkteve Microsoft", por nuk është mbajtur asnjë procesverbal që fakton kryerjen e trajnimeve dhe konsulencave nga specialistët e certifikuar nga prodhuesi si trajnues zyrtarë të produkteve Microsoft.
50.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi marrjen në dorëzim të kontratës dhe zbatimit të saj të bëjnë të mundur së bashku me operatorin ekonomik fitues të zhvillojnë trajnime të stafit sipas pikave të specifikimeve teknike.
Nga auditimi rezulton se: Në kushtet kur nuk janë lidhur kontrata të reja, nuk janë zhvilluar as trjanime mbi modulet e shërbimeve. Ky rekomandim do të verifikohet në auditimet e ardhshme, për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet në process.

Rekomandimi është në proces zbatimi

51. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "*Blerje Licenca Microsoft + shërbime të ndryshme për 2 vite"* u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, gjatë hartimit të procedurës së prokurimit nuk është parashikuar zëri për mirëmbajtjen e procedurës në fjalë. Meqenëse janë shërbime të ndryshme në objektin e prokurimit atëherë duhet parashikuar dhe zëri i mirëmbajtjes për të siguruar krijimin e sistemit të vazhdueshmërisë së punës (Business Continuity) dhe sistemit të ruajtjes së informacionit (Backup).
51.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e procedurës së prokurimit në fjalë të hartojnë MNSH-në bazuar në praktikat më të mira.
Nga auditimi rezulton se: ky rekomandim është pranuar nga PSH sh.a dhe ka një afat zbatimi në vijimësi, çfarë do të verifikohet të verifikohet në auditimet e ardhshme, për këtë arsye do të konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces zbatimi

52. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "*Blerje Licenca Microsoft + shërbime të ndryshme për 2 vite"* u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, kriteret e veçanta që Kompania duhet të ketë specializimet e mëposhtme me prodhuesit Microsoft:
-Gold Data Analytics për të demonstruar kapacitetin e kompanisë për të ofruar shërbime lidhur me platformën analitike Microsoft BI.
-Gold Data Platform për të demonstruar kapacitetin e kompanisë për të ofruar shërbime lidhur me platformën e bazës së të dhënave të Microsoft SQL.
-Gold Collaboration and Content për të demonstruar kapacitetin e kompanisë për të ofruar shërbime lidhur me platformat e bashkëpunimit që ofrohet nga Microsoft,
përbëjnë favorizim për kompani të caktuara duke mos lejuar Operatorë të tjerë të jenë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.
52.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe të kritereve të veçanta në procedurat e ardhshme të prokurimeve, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe të kritereve të veçanta, të kenë kujdes që kriteret e vendosura të mos jenë diskriminuese duke penalizuar operatorë që të jenë pjesëmarrës në garë.
Nga auditimi rezulton se: ky rekomandim është pranuar nga PSH sh.a dhe ka një afat zbatimi në vijimësi, çfarë do të verifikohet në auditimet e ardhshme, për këtë arsye do të konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces zbatimi

Në vijim do të gjeni më mënyrë të detajuar situatën mbi zbatimin e rekomandimeve në Bashkinë Shkodër, në bazë të Programit të Auditimit nr.609/1 prot, datë 16.06.2022.

Në zbatim të pikave 1-4 të Programit të Auditimit "*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e dytë të vitit 2021*", në Bashkinë Shkodër.

Objekti i këtij auditimi është: Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e mëparshme me shkresën nr.552/7 prot, datë 19.09.2021 drejtuar Bashkisë Shkodër.
Nga verifikimi i dokumentacionit, për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:
Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 26 masa organizative. Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 26 masa. Janë zbatuar 4 masa, janë në proces zbatimi 8 masa organizative, janë zbatuar pjesërisht 5 masë organizative dhe nuk janë zbatuar 9 masa organizative.

Përmbledhëse e masave të pranuara në %

Nga 26 masat e pranuara	Nr.	%
Zbatuar	4	15.4
Zbatuar pjesërisht	5	19.2
Në proces	8	30.8
Nuk janë zbatuar	9	34.6

2. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", me shkresën *552/7 prot, datë 19.09.2021*, është dërguar "Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për, auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit" në Bashkinë Shkodër".

Bashkia Shkodër nuk ka dërguar në Kontrollin e Lartë të Shtetit planin e masave për rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit mbi auditimin e zhvilluar në Bashkinë Shkodër me objekt "Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit".

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", me shkresën *552/7 prot, datë 19.09.2021*, është dërguar "Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për, auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit" në Bashkinë Shkodër".

Bashkia Shkodër nuk ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

4. Realizimi i rekomandimeve, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Shkodër për vitet 2015-2030 nuk përcakton politika shteruese për veprimtarinë mbi Teknologjinë e Informacionit. Kjo strategji është hartuar si një strategji ndër sektoriale gjithëpërfshirëse e Bashkisë në nivel makro. Ky dokument strategjik nuk është përditësuar me ndryshimet që ka pësuar Bashkia për një periudhë 6 vjeçare në lidhje me teknologjinë e informacionit.

Nga auditimi mbi masat e marra për plotësimin objektivave të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë 2015-2030 u konstatua se nuk ka indikatorë të matshëm për plotësimin e këtyre objektivave dhe nuk flitet për element konkret dhe mënyrën se si do të arrihet përmbushja e këtyre objektivave

Gjithashtu, duke pasur parasysh që Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë është hartuar për një periudhë 15 vjeçare do të ishte e nevojshme hartimi i një plan-veprimi për strategjinë si dhe përcaktimin e indikatorëve të matjes së perfomancës së strategjisë.

1.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër duke patur parasysh ndryshimet strukturore dhe infrastrukturore të ndodhura në institucion të marrë masa për përditësimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë për vitet 2015-2030 me element të teknologjisë së Informacionit dhe të bëjë rishikimin e këtij dokumenti strategjik çdo 5 vjet.

Gjithashtu strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme të marrin masa për përcaktimin e elementëve dhe indikatorëve të matshëm për matjen e plotësimit të objektivave të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë.

Nga auditimi rezulton që: Bashkia Shkodër nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi

Rekomandimi nuk është zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se bashkia Shkodër nuk ka strategji për teknologjinë e informacionit, mungesa e të cilës sjell mos planifikim dhe mos pasqyrim të qartë të objektivave lidhur me infrastrukturën IT dhe sigurinë institucionale si dhe burimet e nevojshme për matjen e objektivave. Mungesa e planit strategjik, mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së bashkisë.

2.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit.

Nga auditimi rezulton që: Bashkia Shkodër nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi

Rekomandimi nuk është zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se rregullorja e brendshme, "Për miratimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shkodër" miratuar me vendimin nr. 96, datë 20.03.2017 të Kryetarit të Bashkisë nuk është përshtatur (amenduar) duke mos reflektuar ndryshimet institucionale të ndodhura ndër vite në Bashkinë Shkodër. Në rregullore përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë duke ju referuar sektorit të administrimit të sistemeve dhe menaxhimit të zyrës së integruar me një ndalesë, por nuk përmenden fare Përgjegjësit, specialistët për sistemet e tjera si "Sistemi i Taksave dhe Tarifave Vendore; Sistemi i Shërbimit Social; Transparenca e Buxhetit". Të gjithë këto sisteme nuk janë të reflektuar në Rregulloren e Brendshme duke mos përcaktuar elementë përkatës për të siguruar funksionim të përshtatshëm të strukturës IT në institucion.

3.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër dhe strukturat këshilluese mbi IT, të hartojë, amendojë dhe miratojë, rregulloren e brendshme, "Për miratimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shkodër" duke reflektuar ndryshimet institucionale, strukturore dhe kompjuterike të ndodhura ndër vite në bashki. Hartimi i kësaj Rregulloreje të marrë në konsideratë vendosjen e kontrolleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme aktuale si dhe me legjislacionin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Shqipëri.

Nga auditimi rezulton që: Bashkia Shkodër nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

-Struktura e burimeve njerëzore në Sektori i Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të Z1N, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit është e paplotësuar sipas strukturës organike të përcaktuar.
-Bashkia Shkodër, nuk ka plan trajnimi vjetor për vitet 2019-2020 për burimet njerëzore të sektorit të Teknologjisë e Informacionit. Nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre. Trajnimet e përfituara nga ASPA apo zhvilluesit e sistemeve janë të pa mjaftueshme e nuk plotësojnë nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacioni për stafin IT.
-Për punonjësit e sektorit të Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të Z1N, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit nuk janë hartuar dhe miratuar përshkrimet e punës si dhe kriteret për kualifikimet e punonjësve për këtë sektor.
4.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrin masa për menaxhimin e burimeve njerëzore, gjithashtu të marrin masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit IT dhe të çdo përdoruesi të sistemeve TIK si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.
Nga auditimi rezulton që: Me anë të një Marrëveshje bashkëpunimi nr. 06 prot, datë 06.12.2021 ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Universitetit Luarasi, është zhvilluar një trajnim për një nga punonjësit TIK, por nuk janë marrë masa për menaxhimin e burimeve njerëzore pasi janë reduktuar nga 4 në 2 punonjësit e Menaxhimit të Z1N, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit si dhe nuk janë marrë masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit IT dhe të çdo përdoruesi të sistemeve TIK si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se funksionimi dhe organizimi i strukturës së IT-së në nivel sektori nën Drejtorinë e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, nuk i përgjigjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit në bashki dhe njësive të vartësisë duke sjellë uljen e ndikimit të IT-së në qeverisjen e bashkisë si dhe zbeh ndikimin e varësisë direkt nga menaxhimi i lartë.
5.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme të analizojnë mundësinë e ndryshimeve strukturore të strukturës ekzistuese IT me qëllim rritjen e rolit të saj dhe të marrin masa për ngritjen në nivel të strukturës së IT nga nivel sektori në nivel Drejtorie.
Nga auditimi rezulton që: Ky rekomandim është zbatuar plotësisht me vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.304, datë 06.06.2022" Për një ndryshim në vendimin nr.1 ,date 05.01.2022 për miratimin e strukturës së nëpunësve dhe punonjësve të administratës dhe të institucioneve në varësi të Bashkisë Shkodër për vitin 2022" është krijuar struktura Drejtoria e Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të Z1N,Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit.

Rekomandimi është zbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Nga administrimi i dokumentacionit për identifikimin dhe menaxhimin e riskut në teknologjinë e informacionit, konstatohet se Bashkia disponon një regjistër risku të përgjithshëm për të gjithë institucionin, ku përfshihen edhe disa risqe mbi IT por nuk mbulohen të gjithë aktivitet duke përfshirë këtu risqet mbi sistemin e tarifave dhe taksave, proceset e menaxhimit të ndryshimit, etj. Për periudhën nën auditim konstatohet se nuk është bërë përditësim i risqeve mbi TIK, në mospërputhje me: nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimi

nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", Udhëzimin nr. 21, datë 25.10.2016 "Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve", UMF nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike".

6.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër në bashkëpunim me strukturat këshilluese mbi TIK dhe sektorin TIK, të marrin masat e nevojshme për përditësimin dhe dokumentimin e regjistrit të risqeve dhe për hartimin dhe dokumentimin e një plani veprimi për minimizimin/ parandalimin e risqeve të identifikuara, si dhe të bëhet monitorimi periodik i zbatimit të këtyre masave.

Nga auditimi rezulton që: Bashkia Shkodër nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi

Rekomandimi nuk është zbatuar

1. **7. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën e audituar, u konstatua se bashkia Shkodër nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, dhe në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Mbështetja teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit, kryhet nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve.

7.1 Rekomandim: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Shkodër në bashkëpunim me sektorin TIK të marrin masa për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve si dhe menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.

Nga auditimi rezulton që: Bashkia Shkodër nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi

Rekomandimi nuk është zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm në bashkinë Shkodër për vitet 2019-2020 nuk ka kryer asnjë auditim mbi sistemet e teknologjisë së informacionit, në kundërshtim me nenet 14 dhe 8 të Ligjit nr. 114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik". "Të kryejë auditime IT sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 6 dhe nenit 9 dhe në përputhje me Standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm.

Njësia e auditimit të brendshëm në Bashkinë Shkodër:

- në strukturën e saj nuk ka auditues me profil teknologji informacioni;
- ka akses por nuk shfrytëzon për auditim informacion nga sistemet informatike të bashkisë;
- nuk vlerëson nëse qeverisja e teknologjisë së informacionit në bashki mbështet strategjitë dhe objektivat institucionale.

Në këtë mënyrë, nuk ka një strukturë kontrolli të mirëfilltë për auditimin e teknologjisë së informacionit në bashkinë Shkodër, duke rritur riskun e mos identifikimit të parregullsive që mund të ndodhin në sisteme.

8.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër të marri masa për zhvillimin e burimeve njerëzore të Auditit të brendshëm me njohuri të mjaftueshme mbi teknologjinë e informacionit dhe mbulimin me auditim të brendshëm IT të sistemeve IT, sektorit IT pranë bashkisë si dhe përdoruesit e sistemeve informatike në përputhje me përcaktimet ligjore.

Nga auditimi rezulton që: Bashkia Shkodër nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi

Rekomandimi nuk është zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ambienti fizik i dhomës së serverëve në bashkinë Shkodër nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara në rregulloren për

ndërtimin e dhomës së serverëve të miratuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

9.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomës të server-ave në bazë të rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK si dhe në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Nga auditimi rezulton që: Me anë të shkresës nr. 1925/b prot, datë 22.06.2022 drejtuar Kryetarit të Bashkisë Shkodër z. B. S. nga Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse znj. A. P., ka kërkuar Rikonstruksionin e Dhomës së Serverave

Rekomandimi është në proces zbatimi

10. Gjetje nga auditimi: Referuar pikave kryesore të sigurisë së informacionit në rrjetin privat dhe publik janë verifikuar konfigurimet e sigurisë mbi switch-et dhe firewall-in e institucionit, dhe nga verifikimi rezultoi se:

-Rrjeti i bashkisë nuk është i ndarë në rrjet privat dhe në rrjet publik (internet);

-Për konfigurimet aktuale për switch-et kryesore, nuk janë marrë masat e nevojshme që useri admin të limitohet në logimin vetëm nga IP-të brenda rrjetit privat dhe nuk është e bllokuar që useri admin të logohet nga jashtë rrjetit, pra nga një rrjet publik;

-Nuk janë krijuar zona me limite të caktuara për brenda LAN si dhe rrjeti nuk është i ndarë në VLAN (rrjete virtuale) çka do të bënte të mundur menaxhimin dhe lejimin e grupeve të IP-ve në shërbime të ndryshme sipas nevojave. Gjithashtu nuk është krijuar edhe një zonë Untrust e cila sipas konfigurimeve shërben për bllokimin e portave të shërbimeve si dhe bllokimin e IP-ve të cilat mund të paraqesin problematika ose sulme;

-Pajisjet switch aksesohen në çdo moment në qoftë se je lidhur në rrjetin e bashkisë dhe aksesimi i tyre realizohet me të njëjtat kredenciale të njëllojta. Kjo gjë do të rrit mundësinë për sulme nga scripte/viruse;

-Koha e vendosur tek të gjitha switchet është manuale duke mos treguar kohen dhe datën reale të ndodhjes së një problematike, duke ndikuar në të dhënat e logeve, pasi çdo log dhe gjurmë e dokumentuar nuk ka të dhëna të sakta se çfarë date/ore ka ndodhur;

-Për administrimin e firewall nuk janë krijuar group users me nivele të ndara menaxhim/monitorim. Çdo veprim bëhet nga useri admin.

10.1 Rekomandim: Sektori TIK pranë Bashkisë Shkodër të marrë masat e nevojshme për krijimin e konfigurimeve përkatëse në rrjetin e institucionit mbi logimin, konfigurimin dhe sigurinë e switch-ve dhe firewall-it. Të krijohen zona me limite të caktuara brenda LAN si dhe rrjeti të konfigurohet në VLAN (rrjete virtuale) për menaxhimin dhe lejimin e grupeve të IP-ve në shërbime të ndryshme sipas nevojave. Gjithashtu të merren masa për administrimin dhe implementimin e të gjitha konfigurimeve të nevojshme të evidentuara nga auditimi dhe të tjera të mundshme, me qëllim rritjen e sigurisë së infrastrukturës network.

Nga auditimi rezulton që: Rrjeti i Bashkisë Shkodër është ndarë në rrjet privat dhe në rrjet publik (internet);

-Janë kryer konfigurimet për switch-et kryesore, është limituar useri admin në log-imin vetëm nga IP-të brenda rrjetit privat dhe është e bllokuar që useri admin të logohet nga jashtë rrjetit, pra nga një rrjet publik;

-Është shtuar një VLAN i ri vetëm për përdorim publik, kurse 2 VLAN-et e tjera janë konfiguruar për përdorim të brendshëm. Nuk është krijuar edhe një zonë Untrust

-Pajisjet switch janë konfiguruar që aksesimi të kryhet vetëm nga rrjeti i brendshëm si dhe passwordet janë vendosur unike me mbi 20 karakter;

-Koha e vendosur tek të gjitha switchet është bërë automatike;

-Për administrimin e firewall nuk janë krijuar grupe përdoruesish.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

11. Gjetje nga auditimi: Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe mbikëqyrja e faqes web u konstatua se:
-Portali nuk përdor një lidhje të sigurtë (connection security) HTTPS (HyperText Transfer Protocol Secure) (Not secure status) pra komunikimi ndërmjet web browser-it dhe serverit kryhet duke përdorur protokollin HTTP, që do të thotë se serveri i faqes së internetit nuk përdor një certifikatë sigurie për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletues.
-Në kuadrin e transparencës bashkia Shkodër ka afishuar në faqen e saj web, organigramën e institucionit, ku përfshihen, strukturat e të gjithë administratës dhe njësive administrative, statutin, kodin e etikës, rregulloren e brendshme, etj. Faqja web:
-nuk ka të afishuar numrat e kontaktit dhe orarin e ofrimit të shërbimeve ndaj publikut;
-tek menuja "shërbime dhe kontakte" ka të afishuar linkun e bashkisë që të dërgon te adresa faqes zyrtare të bashkisë në rrjetin social facebook.
-nuk administrohet rregullore për faqen e web;
-nuk realizohet monitorimi i statistikave të vizitorëve të faqes web (p.sh.me google analytics).
-faqja web vetëm në version shqip kufizon përdoruesit e kësaj faqeje dhe promovimin e shërbimeve dhe aseteve të kësaj bashkie.
-Në total janë zbuluar përkatësisht 17 dobësi të faqes së webit, në 4 nivele të ndryshme të riskut. Këto dobësi i ekspozojnë aplikacionet e prekura ndaj rrezikut të qasjes së paautorizuar në të dhënat konfidenciale dhe rrit mundësinë e sulmeve (denial of service).
11.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për mbarëvajtjen e faqes web, të marrin masa për përmirësimin e faqes web me elementët përkatës të sigurisë (certifikatën e sigurisë) së navigimit online për të rritur sigurinë si dhe të merren masa për përmirësimin dhe përditësimin e faqes web me (informacione, ligje, rregullore, akte, etj) për të rritur ndihmesën ndaj qytetarëve. Të reflektohen dobësitë e dala nga auditimi dhe të kihet parasysh që në të ardhmen të shtohen elementë inovativ në faqen web për ta bërë atë sa më interaktive dhe ndihmëse për qytetarët.
Nga auditimi rezulton që: Nga verifikimi i faqes web të Bashkisë Shkodër rezultoi se Portali ka një lidhje të sigurtë (connection security) HTTPS (HyperText Transfer Protocol Secure) (Not secure status), pra përdor një certifikatë sigurie për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletues.
-nuk ka të afishuar numrat e kontaktit dhe orarin e ofrimit të shërbimeve ndaj publikut;
-nuk administrohet rregullore për faqen e web;
-nuk realizohet monitorimi i statistikave të vizitorëve të faqes web (p.sh.me google analytics).
-faqja web vetëm në version shqip kufizon përdoruesit e kësaj faqeje dhe promovimin e shërbimeve dhe aseteve të kësaj bashkie.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se bashkia Shkodër, nuk rezulton të ketë, dokumentim/ implementim të politikave/planeve mbi sigurinë e informacionit dhe nuk disponon dokumentacion në lidhje me:
- Planet e vazhdueshmërisë së punës (BCP), në rastet e dështimit të dhomës së server-ave që suportojnë sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore sistemin e Zyrës me Një Ndalesë, sistemin e Shërbimit Social dhe transparenca e Buxhetit.
- Procedurat e rikthimit (restore) të të dhënave nuk testohen për t'u siguruar që ato janë të efektshme dhe që ato mund të ekzekutohen brenda kohës së lejuar për sistemet e sipërpërmendura.
- ruajtja e backup në vende jashtë godinës së bashkisë, në distancë nuk realizohet;
- nuk realizohet backup për loget e sistemit të hyrje-daljeve të personelit;
- pajisjet e rrjetit (switch dhe router), konfigurimet e tyre, nuk janë bërë backup;

- nuk është e qartë nëse kontrollohet statusi i backup-it nëse procedura është kryer me sukses;
- ruajtja e backup në google drive që nuk është në pronësi të bashkisë rrit cenueshmërinë e të dhënave dhe sigurinë e tyre. Në rast të përfundimit të kontratës së mirëmbajtjes me operatorin që ofron shërbimin, nuk është e përcaktuar se ku do të ruhet backup pas kësaj dhe si do ti kalojë backupi më i vjetër që ndodhet tashmë në drive-in e operatorit.

12.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në bashkinë Shkodër në bashkëpunim me sektorin e IT-së të marrin masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat.

Gjithashtu të merren masat e nevojshme që ruajtja e të dhënave dhe backup-eve të sistemeve të realizohet në memorie dhe hapësira virtuale që janë në pronësi të bashkisë me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit dhe cenimin e të dhënave të sistemeve. .

Nga auditimi rezulton që:

-Bashkia Shkodër nuk ka, dokumentim/ implementim të politikave/planeve mbi sigurinë e informacionit dhe nuk disponon dokumentacion në lidhje me:

- Bashkia Shkodër nuk ka plane për vazhdueshmërisë së punës (BCP).
- Bashkia Shkodër nuk ka procedurat e rikthimit (restore) të të dhënave dhe nuk i teston për t'u siguruar që ato janë të efektshme dhe që ato mund të ekzekutohen brenda kohës së lejuar për sistemet e sipërpërmendura.
- Bashkia Shkodër nuk ka ruajtur backup në vende jashtë godinës së bashkisë.
- Bashkia Shkodër nuk ka realizon backup për loget e sistemit të hyrje-daljeve të personelit;
- Bashkia Shkodër ka bërë backup dhe konfigurimet e switch-eve dhe routerit ;
- Bashkia Shkodër kontrollon statuset të backup-it.
- Bashkia Shkodër nuk ka krijuar një backup për bashkinë në google drive .

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

13. Gjetje nga auditimi: Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimeve për blerjet me vlerë të vogël, u konstatua se, në dy procedura prokurimi, në përbërje të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nuk janë përfshirë specialist të fushës së Teknologjisë së Informacionit. Konkretisht:

a)"Mirëmbajtje e faqes zyrtare web www.bashkiashkodër.gov.al dhe moduleve të integruara të saj" Viti 2019, procedurë prokurimi "Blerje me Vlerë të Vogël, me fond limit 250,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E "ARK IT" me ofertë 242,000 lekë pa TVSH;

b)"Mirëmbajtje pajisje informatike" Viti 2019, procedurë prokurimi "Blerje me Vlerë të Vogël, me fond limit 498,898 lekë pa TVSH, me fitues O.E "Bekim Oroshi Oroshi" me ofertë 455,500 lekë pa TVSH.

13.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit dhe personat autorizues mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e ardhshme , gjatë krijimi të Njësive të Prokurimit dhe të Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave, të bazohen në kornizat ligjore dhe rregullative dhe të përfshijnë minimumi një specialist të fushës përkatëse të procedurës së prokurimit.

Nga auditimi rezulton që: Ky rekomandim është në proces zbatimi mbasi bazohet në kontrollin e procedurave të prokurimit që do të zhvillohen në të ardhmen.

Rekomandimi është në proces zbatimi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për procedurën e prokurimit "Mirëmbajtje Pajisje Informatike" viti 2020, procedurë prokurimi "Blerje me Vlerë të Vogël", me fond limit 264,961 lekë pa TVSH, me fitues O.E "Bekim Oroshi Oroshi" me ofertë 251,400 lekë pa TVSH, pas verifikimit të dokumentacionit dërguar nga O.E. "Bekim Oroshi Oroshi", data e lëshimit të vërtetimit të shlyerjes së taksave dhe tarifave vendore mban datën 04.12.2020 nr.376 prot, ndërkohë që afati i dërgimit të ofertave ka qenë data 25.11.2020 ora 12:00.

14.1 Rekomandimi: Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të kenë parasysh që gjatë vlerësimit të O.E pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, të bazohen në legjislacionin përkatës që të mos lejojnë asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në dokumentacion apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme..
Nga auditimi rezulton që: Ky rekomandim është në proces zbatimi mbasi bazohet në kontrollin e procedurave të prokurimit që do të zhvillohen në të ardhmen.

Rekomandimi është në proces zbatimi

15. Gjetje nga auditimi: Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se procedurën e prokurimit "Shërbim GPS + Monitorim" viti 2019, procedurë prokurimi "Kërkesë për Propozim" me fond limit 510,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E "A-T-D" shpk me ofertë 510,000 lekë pa TVSH, pas verifikimit të dokumentacionit të procedurës së prokurimit rezulton që në Njësinë e Prokurimit dhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave asnjë nga anëtarët nuk është specialist i fushës.
15.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit dhe personat autorizues mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e ardhshme të prokurimit, gjatë krijimi të Njësive të Prokurimit dhe të Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave, të bazohen në kornizat ligjore dhe rregullative dhe të përfshijnë minimumi një specialist të fushës përkatëse të procedurës së prokurimit. .
Nga auditimi rezulton që: Ky rekomandim është në proces zbatimi mbasi bazohet në kontrollin e procedurave të prokurimit që do të zhvillohen në të ardhmen.

Rekomandimi është në proces zbatimi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në disa procedura prokurimi kontratat e zbatimit nuk janë hartuar dhe lidhur sipas kërkesave të pikës 2, të VKM-së nr. 710, datë 21.08.2013 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit" i ndryshuar, dhe sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 1159 datë 17.3.2014 "Për hartimin e marrëveshjes së Nivelit Të Shërbimit", i ndryshuar, në të cilën cilësohet që kontratave të llojeve të mësipërme duhet t'ju bashkëngjitet Aneksi nr.1 i MNSH (Marrëveshjes të Nivelit të Shërbimit). Konkretisht kjo shkelje është konstatuar ne këto procedura prokurimi:
-"Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj" viti 2019, procedurë prokurimi "Blerje me Vlerë të Vogël" me fond limit 250,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E "ARK IT" me ofertë 242,000 lekë pa TVSH;
-"Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Bashkisë Shkodër" viti 2019, procedurë prokurimi "Kërkesë për Propozim" me fond limit 2,168,333 lekë pa TVSH, me fitues O.E "Endrit Xhina" me ofertë 2,107,917 lekë pa TVSH;
-"Shërbim GPS+Monitorim" viti 2019, procedurë prokurimi "Blerje me Vlerë të Vogël" me fond limit 510,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E "A-T-D" me ofertë 510,000 lekë pa TVSH;
-"Shërbim Interneti" viti 2019, procedurë prokurimi "Kërkesë për Propozim" me fond limit 1,750,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E "Itcom" me ofertë 980,000 lekë pa TVSH;
-"Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj", viti 2020, procedurë prokurimi "Kërkesë për Propozim" me fond limit 750,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E "Ark IT" me ofertë 747,000 lekë pa TVSH;
-"Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Bashkisë Shkodër" viti 2020, procedurë prokurimi "Kërkesë për Propozim" me fond limit 7,144,989 lekë pa TVSH, me fitues O.E "Endrit Xhina" me ofertë 7,131,000 lekë pa TVSH.
16.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit dhe personat autorizues mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e prokurimit, me bazë shërbimet në

Teknologjinë e Informacionit të kenë parasysh që në hartimin e kontratave të shërbimit të bazohen në legjislacionin e sipërpërmendur duke hartuar Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit.
Nga auditimi rezulton që: Ky rekomandim është në proces zbatimi mbasi bazohet në kontrollin e procedurave të prokurimit që do të zhvillohen në të ardhmen.

Rekomandimi është në proces zbatimi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në dy raste, procedurat e prokurimit dhe kontratat e zbatimit janë realizuar me shumë vonesë, duke lenë pa mbuluar me shërbimin përkatës periudha kohore nga përfundimi i afatit te kontratës së mëparshme deri në lidhjen e kontratave të reja. Konkretisht:
-"Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj" viti 2019, procedurë prokurimi "Blerje me Vlerë të Vogël" me fond limit 250,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E "ARK IT" me ofertë 242,000 lekë pa TVSH, data e lidhjes së kontratës është 09.04.2019 nr.4824/6, ndërkohë që afati i kontratës së mëparshme për të njëjtin shërbim ka përfunduar më datë 31.12.2018 dhe diapazoni kohor midis 01.01.2019-09.04.2019 mbetet pa shërbim;
-"Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj" viti 2020, procedurë prokurimi "Kërkesë për Propozim" me fond limit 750,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E "ARK IT" me ofertë 747,000 lekë pa TVSH, data e lidhjes së kontratës është 19.11.2020, ndërkohë që afati i kontratës së mëparshme për të njëjtin shërbim ka përfunduar më datë 31.12.2019 dhe diapazoni kohor midis 01.01.2020-19.11.2020 mbetet pa shërbim.
17.1 Rekomandimi: Personat autorizues mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e prokurimit, me bazë shërbimet në Teknologjinë e Informacionit, në sistemet ekzistuese, të parashikojnë MNSH-në, kohëzgjatja e së cilës duhet të jetë jo më e shkurtër se 2 (dy) vjet.
Nga auditimi rezulton që: Ky rekomandim është në proces zbatimi mbasi bazohet në kontrollin e procedurave të prokurimit që do të zhvillohen në të ardhmen.

Rekomandimi është në proces zbatimi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, gjatë zbatimit të 6 kontratave nuk është kryer matja e cilësisë së shërbimit dhe mungojnë raportet e shërbimit dhe të vlerësimeve mbi performancën e shërbimit. Konkretisht kjo shkelje është konstatuar në këto kontrata:
-"Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj" viti 2019, procedurë prokurimi "Blerje me Vlerë të Vogël" me fond limit 250,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E "ARK IT" me ofertë 242,000 lekë pa TVSH;
-"Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Bashkisë Shkodër" viti 2019, procedurë prokurimi "Kërkesë për Propozim" me fond limit 2,168,333 lekë pa TVSH, me fitues O.E "Endrit Xhina" me ofertë 2,107,917 lekë pa TVSH;
-"Shërbim GPS + Monitorim" viti 2019, procedurë prokurimi "Blerje me Vlerë të Vogël" me fond limit 510,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E "A-T-D" me ofertë 510,000 lekë pa TVSH;
-"Shërbim Interneti" viti 2019, procedurë prokurimi "Kërkesë për Propozim" me fond limit 1,750,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E "Itcom" me ofertë 980,000 lekë pa TVSH.
-"Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj", viti 2020, procedurë prokurimi "Kërkesë për Propozim" me fond limit 750,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E "Ark IT" me ofertë 747,000 lekë pa TVSH;
-"Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Bashkisë Shkodër" viti 2020, procedurë prokurimi "Kërkesë për Propozim" me fond limit 7,144,989 lekë pa TVSH, me fitues O.E "Endrit Xhina" me ofertë 7,131,000 lekë pa TVSH.

18.1 Rekomandimi: Personat autorizues mbi ndjekjen e zbatimit të kontratës të kryejnë matjen e cilësisë së shërbimeve dhe të kryejnë raporte periodike mbi ecurinë e shërbimit bazuar në kontratën e lidhur midis O.E dhe A.K.
Nga auditimi rezulton që: Ky rekomandim është në zbatuar pjesërisht, vetëm për kontratën "Shërbim Interneti, për procedurat e tjera ku rekomandim nuk është zbatuar.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se bashkia Shkodër nuk disponon një politikë/rregullore të dokumentuar dhe miratuar për procesin e menaxhimit të përdoruesve (krijimi, fshirja, ndryshimi i roleve/të drejtave, ndryshimi i fjalëkalimeve etj.) për sistemet SZ1N dhe SiTTV.
Bashkia Shkodër nuk disponon bazë rregullatore në lidhje me menaxhimin e të dhënave, të drejtat dhe menaxhimin e përdoruesve të Sistemit të Integruar të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe të Sistemit të Zyrës me Një Ndalesë.
19.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër të marrin masa për hartimin dhe miratimin e rregulloreve përkatëse për funksionimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit të cilët ka në përdorim institucioni, në të cilat të jenë të pasqyruara saktë përgjegjësitë, detyrat dhe të drejtat për menaxhimin e përdoruesve të këtyre sistemeve. Në rregullore të përcaktohet edhe politika për menaxhimin e gabimeve njerëzore dhe teknike në lidhje me përdorimin e sistemeve të IT.
Nga auditimi rezulton që: Bashkia Shkodër nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

19.2 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër të marrin masa për përcaktimin e administrator-it/ëve të sistemeve të teknologjisë së informacionit që Bashkia Shkodër ka në përdorim. Detyrat, përgjegjësitë dhe të drejtat e administratorit të sistemeve IT përcaktohen në rregulloren përkatëse të sistemit.
Nga auditimi rezulton që: Ky rekomandim është në proces zbatimi mbasi bazohet në kontrollin e procedurave të prokurimit që do të zhvillohen në të ardhmen.

Rekomandimi është në proces zbatimi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan mangësi mbi masat organizative dhe teknike në lidhje me sigurinë e të dhënave. Më konkretisht:
-Në Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore, ekzistojnë aktiv në sistem tre përdorues, të cilët në bazë të Vendimit Nr. 2, Datë 05.01.2021, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, nuk janë pjesë e strukturës së Bashkisë Shkodër.
-Në listën e përdoruesve të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga Bashkia Shkodër, ekzistojnë aktiv, katër përdorues me kredenciale gjenerike (teardhurat.dajc@shkodra.work, teardhurat.berdice, teardhurat.gurizi, teardhurat.rrethina), kredencialet e të cilëve nuk janë të dokumentuar se nga cilët punonjës të Bashkisë apo njësive administrative posedohen dhe përdoren;
-Bashkia Shkodër nuk ndjek një politikë të përcaktuar për analizimin e gjurmëve të auditimit për veprimet që kryejnë përdoruesit në Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sistemin e Zyrës me Një Ndalesë. Në bazën e të dhënave të këtyre dy sistemeve ruhen gjurmët e auditimit (audit trail) për veprimet e kryera nga përdoruesit, por nuk ekzistojnë procedura për analizimin e këtyre gjurmëve;
-Bashkia Shkodër nuk kryen analizime periodikë të gjurmëve të auditimit të veprimeve, me qëllim evidentimin dhe parandalimin e problematikave të ndryshme që lidhen me sigurinë e informacionit dhe mirëfunksionimin dhe mirë përdorimin e këtyre dy sistemeve;

-Aksesimi i dy sistemeve (SZ1N dhe SiTTV) përmes rrjetit Wifi të Bashkisë Shkodër, ambiente të cilët aksesohen edhe nga persona të tjerë përveç punonjësve të Bashkisë, përmban risk për problematika në lidhje me sigurinë e informacionit të këtyre sistemeve.

20.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, në bashkëpunim me strukturën e teknologjisë së informacionit të marrin masa për analizimin e hollësishëm të të gjithë përdoruesve aktivë në sistemet që ka në përdorim Bashkia Shkodër me të drejta në sistem sipas pozicioneve të punës. Pas analizimit dhe evidentimit të të gjithë përdoruesve, të merren masa për bllokimin e aksesit dhe çaktivizimin e të gjithë përdoruesve të cilët në bazë të vendimeve të Kryetarit të Bashkisë nuk janë më punonjës të institucionit.

Nga auditimi rezulton që: Nga verifikimet e kryera mbi përdoruesit aktiv në sistemet e Bashkisë Shkodër dhe çaktivizimin e përdorueseve të larguar, rezultoi i zbatuar.

Rekomandimi është zbatuar

20.2 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, në bashkëpunim me strukturën e teknologjisë së informacionit të marrin masa për minimizimin e rasteve të krijimit të përdoruesve me kredenciale gjenerike. Nëse do të përdoren të tillë, të përcaktohet me Urdhër të veçantë se cili punonjës do të posedojë dhe do të përdorë këto kredenciale.

Nga auditimi rezulton që: Ky rekomandim është në proces zbatimi mbasi bazohet në krijimin e përdorueseve të rinj për sistetmet e Bashkisë Shkodër.

Rekomandimi është në proces zbatimi

20.3 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, në bashkëpunim me strukturën e teknologjisë së informacionit të marrin masa për aplikimin e certifikatave të sigurisë SSL (Secure Socket Layer) për SiTTV dhe SZ1N në web app.

Nga auditimi rezulton që: Nga verifikimet e kryera mbi aplikimin e certifikatave të sigurisë SSL (Secure Socket Layer) për SiTTV dhe SZ1N në web app, rezultuan të implementuara.

Rekomandimi është zbatuar

20.4 Rekomandimi: Struktura e teknologjisë së informacionit, të marri masa për bllokimin e mundësisë për aksesimin e SiTTV dhe SZ1N nga rrjeti Wifi i Bashkisë Shkodër.

Nga auditimi rezulton që: Nga verifikimet e kryera rezultoi se janë marrë masat për bllokimin e aksesimit të SiTTV dhe SZ1N nga rrjeti Wifi i Bashkisë Shkodër.

Rekomandimi është zbatuar

20.5 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, në bashkëpunim me strukturën e teknologjisë së informacionit të marrin masa për hartimin dhe miratimin e një politike të mirë dokumentuar për analizimin periodik të gjurmëve të auditimit të veprimeve të kryera në sistemet IT me qëllim evidentimin dhe parandalimin e problematikave të mundshme në lidhje me mirëfunksionimin dhe mirë përdorimin e sistemeve IT të Bashkisë Shkodër.

Nga auditimi rezulton që: Bashkia Shkodër nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i bazës së të dhënave të Sistemit të Integruar të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sistemit të Zyrës me Një Ndalesë u konstatua se këto dy sisteme kanë nevojë për përmirësime në drejtim të garantimit të integritetit dhe plotësisë së të dhënave që krijohen, menaxhohen dhe ruhen përmes tyre. Më konkretisht:

-Në Sistemin e Integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore, janë konstatuar 5 problematika në lidhje me plotësinë e të dhënave përgjatë popullimit të tabelave dhe fushave;

-Në Sistemin e Zyrës me Një Ndalesë janë konstatuar 4 problematika: në lidhje saktësinë e fushave të populluara; në lidhje me statusin e aplikimeve për marrjen e shërbimeve; në lidhje me plotësinë e fushave, etj.

21.1 Rekomandimi: Struktura e teknologjisë së informacionit, të marrë masa për analizimin e situatës aktuale në lidhje me integritetin dhe plotësinë e të dhënave që përmbajnë sistemet informatike të Bashkisë Shkodër duke përcaktuar edhe shkaqet prej të cilëve rrjedhin problematikat e konstatuara. Të merren masat e nevojshme për ngritjen dhe implementimin e mekanizmave të kontrollit dhe validimit të inputit të sistemeve informatike, duke përcaktuar dhe kornizuar tipin e të dhënave që mund të plotësojnë përdoruesit në përputhje me formatin dhe informacionin që përmban secila prej fushave, me qëllim parandalimin e përsëritjes së problematikave të konstatuara.

Nga auditimi rezulton që: Bashkia Shkodër nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi

Rekomandimi nuk është zbatuar

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME - AKSHI

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 3 masa si përmirësim ligjor dhe 15 masa organizative. Nga masat për përmirësim ligjor 2 masa janë pranuar nga të cilat një masë është në proces zbatimi, 1 nuk është zbatuar. Masat organizative janë pranuar plotësisht nga të cilat janë zbatuar 4 masa, janë në proces zbatimi 2 masa organizative dhe nuk janë zbatuar 9 masa organizative.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit"*, për përmirësimin e gjendjes, Ju ***rikërkojmë*** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të zbatuara pjesërisht dhe në proces zbatimi si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

Gjetje nga auditimi 1: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.820/13 prot, datë 24.09.2021, **nuk është zbatuar rekomandimi numër 2.1, si vijon:**
2.1 Rekomandimi: AKSHI dhe QKB të marrin masa për ngritjen e një grupi të përbashkët me qëllim hartimin, përcaktimin e propozimin e ndryshimeve të nevojshme në bazën rregullatore për të drejtat Administruese të Regjistrit Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

Rekomandimi 1: Titullarit të AKSHIT dhe strukturave për rekomandimet e pazbatuara të marrin masat e nevojshme rast pas rasti me qëllim përshpejtimin e procesit për zbatimin e tyre.

Brenda 3-mujorit të IV të vitit 2022 dhe në vijimësi

Gjetje nga auditimi 2: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.820/13 prot, datë 24.09.2021, **është në proces zbatimi rekomandimi numër 1.1, si vijon:**
1.1 Rekomandimi: AKSHI në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të ndërmarrë hapat e nevojshëm ligjore për hartimin e projekt ligjit "Për funksionimin dhe organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit".

Rekomandimi 2: Titullarit të AKSHIT dhe strukturave për rekomandimet që janë në proces zbatimi të marrin masat e nevojshme rast pas rasti me qëllim përshpejtimin e procesit për zbatimin e tyre.

Brenda 3-mujorit të IV të vitit 2022 dhe në vijimësi

A. MASA ORGANIZATIVE

Gjetje nga auditimi 1: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.820/13 prot, datë 24.09.2021, **nuk janë zbatuar rekomandimet me numër 3.1; 5.1; 6.1; 9.1; 11.1; 12.1; 13.1; 14.1; 15.1, si vijon:**

3.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të AKSHI, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për përcaktimin e elementëve dhe indikatorëve të matshëm për matjen e plotësimit të objektivave të Programit Kombëtar TIK 2018-2021.
5.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të AKSHI-t në bashkëpunim institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave të marrin masa për hartimin e miratimin e një plan veprimi të detajuar për përfundimin e procesit të qendërzimit të infrastrukturës TI.
6.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të AKSHI-t në vijimësi të marrin masa për vazhdimin e procesit të ngritjes së grupeve të punës për identifikimin dhe analizimin e gjendjes në fushën TIK dhe gjenerimin e raporteve përkatëse mbi situatën, për të gjitha institucionet të cilat përmbushin kalimin te AKSHI, në përputhje me përcaktimet ligjore
9.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të AKSHI-t në bashkëpunim me institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, për përfundimin e procesit të kalimit të burimeve njerëzore nën strukturën e AKSHI-t sipas përcaktimeve ligjore të marrin masa për hartimin dhe miratimin e një plan veprimi për detajimin dhe organizimin e procesit të qendërzimit të strukturës TIK.
11.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të AKSHI-t të marrin masa për hartimin e planit të veprimit ndërinstitucional të transferimit nën administrimin e AKSHI-t të aseteve dhe aktiveve të sistemeve të informacionit që preken nga fusha e veprimit të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtarë të Shoqërisë së Informacionit", i ndryshuar.
12.1 Rekomandimi: AKSHI në bashkëpunim me institucionet e administratës shtetërore sipas përcaktimeve të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 me qëllim monitorimin e ofrimit të shërbimeve, rritjen e efektivitetit, kufizimin e risqeve teknike, ruajtjen e integritetit dhe vazhdueshmërinë e punës të marri masa për hartimin e zbatimin e MNSH sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi
13.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të AKSHI-t në vijimësi të marrin masa për rishikimin e MNSH-ve me institucionet që është nënshkruar MNSH duke marrë në konsideratë, tipin, formën dhe rëndësinë e institucionit, ngarkesën apo sasinë e informacionit që institucioni përpunon dhe përfshirjen e plotë të elementëve të Marrëveshjeve në Nivel Shërbimi sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
14.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të AKSHI-t në vijimësi të kryejnë analizimin, prioritarizimin dhe ofrimin e shërbimeve të përcaktuara në MNSH-në ndërmjet institucioneve, hartimin e raporteve javore dhe mujore të shërbimeve të ofruara, me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme për kryerjen me rigorozitet të suportit.
15.1 Rekomandimi: AKSHI në bashkëpunim me institucionet e administratës shtetërore sipas përcaktimeve të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 me qëllim monitorimin e ofrimit të shërbimeve, rritjen e efektivitetit, kufizimin e risqeve teknike, ruajtjen e integritetit dhe

vazhdueshmërinë e punës të marri masa për hartimin e zbatimin e MNSH sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Rekomandimi 1: Titullarit të AKSHIT dhe strukturave për rekomandimet e pazbatuara të marrin masat e nevojshme rast pas rasti me qëllim përshpejtimin e procesit për zbatimin e tyre.

Brenda 3-mujorit të IV të vitit 2022 dhe në vijimësi

Gjetje nga auditimi 2: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.820/13 prot, datë 24.09.2021, **janë në proces zbatimi rekomandimet me numër 4.1;10.1, si vijon:**

4.1 Rekomandimi: AKSHI në përmbushje të misionit të tij duke marrë parasysh funksionalitetet e reja të përcaktuara në legjislacionin rregullator, me një proces gjithë përfshirës të marri masa për rishikimin, përditësimin si dhe reflektimin e ndryshimeve ligjore, në dokumentin strategjik "Programi Kombëtar TIK" ku të adresohen qartë objektivat e institucionit.
10.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të AKSHI-t, DPGJC, ISSH dhe DPT të marrin masat e nevojshme për përfundimin e procesit të kalimit të aktiveve të sistemeve të teknologjisë së informacionit tek AKSHI, si dhe të përcaktojnë përgjegjësitë për vonesat e shkaktuara të zbatimit të kërkesave ligjore lidhur me këtë çështje.

Rekomandimi 2: Titullarit të AKSHIT dhe strukturave për rekomandimet që janë në proces zbatimi të marrin masat e nevojshme rast pas rasti me qëllim përshpejtimin e procesit për zbatimin e tyre.

Brenda 3 mujorit të IV të vitit 2022 dhe në vijimësi

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME -DPD

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 24 masa organizative nga të cilat nuk është kundërshtuar asnjë. Është zbatuar plotësisht 1 masë, janë zbatuar pjesërisht 2 masa, është në proces zbatimi 1 masë dhe nuk janë zbatuar 20 masa organizative.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit"*, për përmirësimin e gjendjes, Ju ***rikërkojmë*** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të zbatuara pjesërisht dhe në proces zbatimi si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

Gjetje nga auditimi 1: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.570/8 prot, datë 20.09.2021, **nuk janë zbatuar rekomandimet me numër 3.1; 4.1; 5.1; 6.1; 7.1; 8.1; 9.1; 10.1; 11.1; 12.1; 13.1; 14.1; 15.1; 17.1; 18.1; 18.2; 19.1; 20.1; 21.1; 22.1, si vijon:**
3.1 Rekomandimi: - Nga DPD, AKSHI të merren masat për përfshirjen në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Objektivat e Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike Shqipëri 2019-2022
- Nga DPD, AKSHI të merren masat për hartimin e plan veprimit për realizimin e objektivave specifike sipas komponentëve për menaxhimin e doganave dhe masat për përmirësimin e mëtejshëm të sistemeve dhe platformave të TI-së dhe treguesit e performancës:

- Zhvillimi, zbatimi dhe rishikimi i rregullt i strategjisë afatgjatë të TI që mbështet përparësitë e biznesit.
- Përmirësimi i organizimit dhe menaxhimit të TI.
- Implementimin e NCTS, ITEMS dhe sistemeve të tjera të TI të BE-së.
4.1 Rekomandimi: - Nga DPD, AKSHI të merren masat për përfshirjen në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të objektivave strategjike sipas komponentëve për dokumentin e politikave për sigurinë kibernetike 2015 – 2017.
- Gjithashtu nga DPD, AKSHI të merren masat për hartimin e plan veprimit për implementimin e objektivave strategjike sipas komponentëve për dokumentin e politikave për sigurinë kibernetike 2015 – 2017 si:
- Plotësimi i kuadrit ligjor në fushën e sigurisë kibernetike.
- Forcimi i kuadrit institucional.
- Rritja e ndërgjegjësimit për sigurinë kibernetike.
- Identifikimi dhe mbrojtja e Infrastrukturave Kritike të Informacionit në Shqipëri.
- Krijimi dhe implementimi i kërkesave minimale të sigurisë kibernetike.
- Forcimi i partneritetit me struktura të tjera përgjegjëse të fushës brenda dhe jashtë vendit
- Rritja e nivelit të njohurive, aftësive dhe kapaciteteve për ekspertizë në fushën e sigurisë kibernetike.
5.1 Rekomandimi: - Nga DPD në bashkëpunim me AKSHI-n të merren masat e nevojshme për përcaktimin e pikës së kontaktit, personin përgjegjës për infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit "Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganore" dhe t'ia komunikojnë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.
- Nga operatori i infrastrukturës kritike të informacionit, DPD, AKSHI, të merren marren masa sigurie për rritjen e sigurisë së informacionit në sistemin kritik "Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganore" duke i zbatuar dhe dokumentuar zbatimin e tyre.
6.1 Rekomandimi: Drejtoria së Përgjithshme të Doganave të marrin masat e nevojshme për hartimin e procedurave për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive për kryerjen e ndryshimeve.
7.1 Rekomandimi: DPD të hartojë plane për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sigurinë e informacionit në përmbushje të nevojave të përgjithshme dhe specifike që ndihmojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e veprimeve dhe procedurave të këtij institucioni.
8.1 Rekomandimi: DPD të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e:
- Rregullore mbi mbarëvajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave të sigurisë;
- Rregullore për kategoritë e incidenteve kibernetike si dhe formatin dhe elementët e raportimit;
- Rregullore për administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike;
- Rregullore për menaxhimin e Firewall;
- Rregullore për menaxhimin e log-eve digjitale në administratën publike.
9.1 Rekomandimi: Nga DPD në bashkëpunim me AKSHI-n të merren masat e nevojshme për të kaluar në administrim dhe inventar të AKSHI-t sistemin, "LIMS", së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse duke përcaktuar përgjegjësisë dhe detyrimet për shërbimin e mirëmbajtjes të këtij sistemi dhe infrastrukturës TIK.
10.1 Rekomandimi: DPD në bashkëpunim me AKSHI-n të marrë masat e nevojshme për hartimin e një marrëveshje të nivelit të shërbimit, për sistemin "Dixhitalizimi i shërbimeve doganore" ku të përcaktohen parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit.
- DPD në bashkëpunim me AKSHI-n të marrë masat e nevojshme për të kaluar në administrim dhe inventar të AKSHI-t pas implementimit sistemin, "Dixhitalizimi i Sistemit Doganor", së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse duke përcaktuar përgjegjësisë dhe detyrimet për shërbimin e mirëmbajtjes të këtij sistemi dhe infrastrukturës TIK.

11.1 Rekomandimi: DPD të marrë masat e nevojshme për paraqitjen në vlerën e saktë të inventarit të aktiveve të llogarisë 213 "Rrjetet dhe sistemet" si dhe kalimi i këtyre aktive nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse duke përcaktuar përgjegjësisë dhe detyrimet për shërbimin e mirëmbajtjes së këtyre sistemeve dhe infrastrukturës TIK .

12.1 Rekomandimi: DPD të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e një marrëveshjeje dypalëshe me qëllim përcaktimin e të drejtave dhe detyrimet e ndërsjellat midis DPD dhe AKSHI-t, llojin dhe nivelin e shërbimeve që i ofrohen nga AKSHI Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

13.1 Rekomandimi: DPD të marrë masa për sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave duke filluar së pari me hartimin e një procedure apo rregullore për menaxhimin e gjurmës elektronike të auditimit. Në këtë dokument duhet të specifikohet qartë vendi ku ruhen gjurmët, për cilat veprime të përdoruesit ruhen këto gjurmë, koha, struktura përgjegjëse për monitorimin dhe analizimin e tyre, detyrat dhe përgjegjësitë, e çdo element që i shërben sigurisë së të dhënave dhe parandalimit në tjetërsimin e tyre.

14.1 Rekomandimi: DPD të marrë masa të menjëhershme për ndërtimin e mekanizmave të kontrollit për mbrojtjen dhe sigurimin e të dhënave shtetërore, gjeneruar prej saj nëpërmjet sistemit Asycuda, me qëllim parandalimin e situatave të ngjashme si fshirja e të dhënave mbi gjurmën elektronike të auditimit në të ardhmen.

15.1 Rekomandimi: DPD të marrë masat e nevojshme, për të siguruar përmbushjen e detyrime mbi specifikimet teknike për sistemin LIMS në lidhje me gjenerimin, administrimin, monitorimin dhe raportimin e gjurmës elektronike të auditimit quajtur "Audit Log".

17.1 Rekomandimi: DPD të kërkojë nga AKSHI, prokurimin e pajisjes backup për linjën e internetit, me rëndësi për institucionin pasi në të janë konfiguruar lidhjet e jashtme me sistemin doganor, me qëllim parandalimin e ndërprerjes së punës në rast të një defekti në pajisjen aktuale.

18.1 Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të unifikojë të dhënat për përdoruesit e sistemit Asycuda dhe LIMS të njëjtës kategori, të plotësojë të dhënat që mungojnë për çdo përdorues, të ndërtojë kontrolle për mbylljen e përdoruesve në kohën e duhur, të mbyllë përdoruesit të cilët kanë përfunduar objektin e krijimit, me qëllim ruajtjen e sistemit nga ndërhyrjet e paautorizuara.

18.2 Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të ndërtojë mekanizma kontrolli për dokumentimin dhe miratimin fizik të ndryshimeve të lejuara për përdoruesit, për të cilat nuk gjenerohet një gjurmë elektronike auditimi.

19.1 Rekomandimi: DPD si institucion përgjegjës dhe administrues i të dhënave shtetërore që gjenerohen nëpërmjet sistemit Asycuda, të dokumentojnë me një akt rregullativ të brendshëm organizimin dhe funksionimin e të dhënave shtetërore me rëndësi kritike. Gjithashtu, të evidentohen dhe dokumentohen pa përjashtim të dhënat parësore dhe dytësore me të cilat janë ndërtuar ndërveprime për ofrimin e shërbimit ndaj shtetasve.

20.1 Rekomandimi: DPD si institucion përgjegjës dhe administrues i të dhënave shtetërore që gjenerohen nëpërmjet sistemit Asycuda, të marrë masa për përmbushjen e këtij detyrimi me strukturë të posaçme për administrimin dhe mbrojtjen e të dhënave, si shërbime të cilat nuk ofrohen nga AKSHI.

21.1 Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për testimin e situatave të konstatuara nga auditimi renditur më sipër, raportimin e tyre tek Specialistët e TIK dhe ekspertët e UNCTAD për ato raste që mund të rregullohen gjatë fazës të Upgrade, dhe evidentimin e dobësive të cilat kërkojnë më shumë kohë për zgjidhje.

22.1 Rekomandimi: DPD të kërkojë tek kontraktorit përmbushjen e funksionaliteteve që nuk janë aktualisht funksionale, mbi:

- *Import/exportin e të dhënave;*

- *Integrimin me sistemin Asycuda World me qëllim sigurimin e efektivitetit të përdorimit të sistemit LIMS pas përfundimit të kontratës së mirëmbajtjes;*
- *Manualin e Administrimit;*
- *Gjurmën elektronike të auditimit (audit trails ose logs);*
- *Raporte komplekse të cilat do të mund ti shërbenin auditimit të brendshëm dhe të jashtëm mbi monitorimin e aktivitetit dhe veprimtarisë së kësaj drejtorie;*
- *Konfigurimet për gjuhën dhe identifikimin me "Two factor authentication" të cilat nuk janë funksionale;*

Rekomandimi 1: Titullarit të DPD dhe strukturave për rekomandimet e pazbatuara të marrin masat e nevojshme rast pas rasti me qëllim përshpejtimin e procesit për zbatimin e tyre.

Brenda 3-mujorit të IV të vitit 2022 dhe në vijimësi

Gjetje nga auditimi 2: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 570/8 prot, datë 20.09.2021, **janë zbatuar pjesërisht rekomandimet me numër 2.1; 16.1, si vijon:**

2.1 Rekomandimi: Nga DPD, AKSHI të merren masat për përfshirjen në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të Objektivave e Strategjisë Ndërsektoriale e Axhendës Dixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020.
- Nga DPD, AKSHI të merren masat për rritjen e sigurisë në infrastrukturën kritike të teknologjisë së informacionit dhe zbatimin e kërkesave të larta teknike për bazat e të dhënave shtetërore etj.
- DPD në bashkëpunim me Drejtorinë e TIK të Doganave, të marrë masa për hartimin dhe konkretizimin e Planit të veprimit dhe implementimit Strategjik Institucional për objektivat e planit të strategjisë ndërsektoriale të Axhendës Dixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020.
- Të merren masat për rritjen e sigurisë përmes krijimit të Qendrës së Vazhdueshmërisë së Punës "Business Continuity Center dhe Backup" për Sistemet Qeveritare dhe "Qendrës së Rikuperimit nga Fatkeqësia" (Disaster Recovery Center –DRC)" për Sistemet Qeveritare:
1. Ndërtimi i Qendrës së Vazhdueshmërisë së Punës "Business Continuity Center dhe Backup" për Sistemet Qeveritare.
2. Ndërtimi i "Qendrës së Rikuperimit nga Fatkeqësia" (Disaster Recovery Center – DRC)" për Sistemet Qeveritare.
16.1 Rekomandimi: DPD në bashkëpunim me AKSHI-n nisur edhe nga rëndësia që ka ofrimi i shërbimit pas një fatkeqësie natyrore, të hartojnë planin e vazhdimësisë dhe planin e rikuperimit si dhe të ndërmarrin hapat e nevojshëm për sigurimin e pajisjeve të nevojshme në ndërtimin e Business Continuity si dhe të përcaktojnë burimet njerëzore përgjegjëse nga të dy institucionet.

Rekomandimi 2: Titullarit të DPD dhe strukturave për rekomandimet e zbatuara pjesërisht të marrin masat e nevojshme rast pas rasti me qëllim përshpejtimin e procesit për zbatimin e tyre.

Brenda 3-mujorit të IV të vitit 2022 dhe në vijimësi

Gjetje nga auditimi 3: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.570/8 prot, datë 20.09.2021, **është në proces zbatimi rekomandimi numër 1.1 , si vijon:**
1.1 Rekomandimi: DPD në bashkëpunim me AKSHI-n, të marrë masa për hartimin dhe konkretizimin e Planit të veprimit dhe implementimit Strategjik Institucional për objektivat e

planit strategjik institucional "Strategjia e Biznesit e Administratës Doganore shqiptare 2018-2021", implementimi i NCTS, ITMS dhe sistemeve të tjera të IT-së së BE-së në përputhje me nevojat e anëtarësimit në BE, EU MASP dhe programin e punës së EU UCC.

Rekomandimi 3: Titullarit të DPD dhe strukturave për rekomandimet e në proces zbatimi të marrin masat e nevojshme rast pas rasti me qëllim përshpejtimin e procesit për zbatimin e tyre.

Brenda 3-mujorit të IV të vitit 2022 dhe në vijimësi

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME - ISUV

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 26 masa organizative dhe 1 masë për shpërblim dëmi. Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 26 masa. Janë zbatuar 2 masa, janë në proces zbatimi 14 masa organizative, janë zbatuar pjesërisht 2 masë organizative dhe nuk janë zbatuar 8 masa organizative.
Nga masa për shpërblim dëmi është pranuar 1 masë dhe është në proces zbatimi 1 masë.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit"*, për përmirësimin e gjendjes, Ju ***rikërkojmë*** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të zbatuara pjesërisht dhe në proces zbatimi si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

Gjetje nga auditimi 1*:* Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.973/8 prot, datë 22.12.2021, **nuk janë zbatuar rekomandimet me numër 17.1; 19.1; 19.2; 19.3; 19.4; 20.1; 21.1; 23.1, si vijon:**

17.1. Rekomandimi: ISUV të marrë masa për verifikimin e situatës së krijuar në lidhje me "Hendeqet" në fushën ID, duke hartuar rregullore për përdoruesit dhe administratorët e sistemit LIMS.
19.1. Rekomandimi: ISUV të marrë masa për analizimin e situatës aktuale në lidhje me integritetin dhe plotësinë e të dhënave që përmbajnë sistemet informatike të LIMS duke përcaktuar edhe shkaqet prej të cilëve rrjedhin problematikat e konstatuara. Të merren masat e nevojshme për ngritjen dhe implementimin e mekanizmave të kontrollit dhe validimit të inputit të sistemeve informatike, duke përcaktuar tipin e të dhënave që mund të plotësojnë përdoruesit në përputhje me formatin dhe informacionin që përmban secila prej fushave, me qëllim parandalimin e përsëritjes së problematikave të konstatuara.
19.2 Rekomandimi: ISUV të marrë masa për plotësimin e sistemit LIMS me të dhënat që mungojnë për çdo përdorues, të ndërtojë kontrolle për mbylljen e përdoruesve në kohën e duhur, të mbyllë përdoruesit të cilët kanë përfunduar objektin e krijimit, me qëllim ruajtjen e sistemit nga ndërhyrjet e paautorizuara.
19.3. Rekomandimi: ISUV të marrë masa për ndërtimin e mekanizmave të kontrollit për dokumentimin dhe miratimin fizik të ndryshimeve të lejuara për përdoruesit, për të cilat nuk gjenerohet një gjurmë elektronike auditimi.
19.4. Rekomandimi: ISUV të marrë masa që të mos shfaqen në ndërfaqen Web të LIMS, punonjësit e larguar nga puna ose punonjës të cilët kanë ndryshuar pozicionin e punës dhe iu është hequr aksesi nga sistemi LIMS, por të ruhet veprimtaria e tyre në data bazë e sistemit.

20.1. Rekomandimi: ISUV të kërkojë tek OE përmbushjen e funksionaliteteve që mungojnë, për gjenerimin e raporteve javore, mujore sipas nevojave të institucionit, analizime statistikore dhe monitorimin e veprimtarisë së sistemit LIMS.
21.1. Rekomandimi: ISUV të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullores, për përdoruesit e sistemit LIMS ku të identifikohen qartë:
- *rregullat e monitorimit,*
- *politikat e implementuara për fjalëkalimet e administrimit dhe përdoruesit fundor*
- *të dhënat e detyrueshme që nevojiten të plotësohen për çdo përdorues*
- *të dhënat e pandryshueshme për secilin prej tyre,*
- *ndalimin e krijimit të më shumë se një përdoruesi për punonjës*
- *ndalimin e krijimit të një përdoruesi të ri për punonjësin ekzistues.*

23.1. Rekomandimi: Niveli drejtues në ISUV si institucion përgjegjës dhe administrues i të dhënave shtetërore të sistemit LIMS, të marrë masa për përmbushjen e këtij detyrimi me strukturë të posaçme për administrimin dhe mbrojtjen e të dhënave.

Rekomandimi 1*:* Titullarit të ISUV dhe strukturave për rekomandimet e pazbatuara të marrin masat e nevojshme rast pas rasti me qëllim përshpejtimin e procesit për zbatimin e tyre.

Brenda 3-mujorit të IV të vitit 2022 dhe në vijimësi

Gjetje nga auditimi *2:* Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.973/8 prot, datë 22.12.2021, **janë zbatuar pjesërisht rekomandimet me numër 4.1; 18.1, si vijon:**
4.1. Rekomandimi: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë duhet të ndërmarrë masa për identifikimin e nevojave për specialist TI dhe ngritjen e një strukture TI duke bërë gjithashtu edhe identifikimin e nevojave për trajnim, hartimin e planeve të trajnimeve dhe kryerjes së tyre.
18.1. Rekomandimi: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomës të serverëve në bazë të standardeve dhe praktikave më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Rekomandimi 2: Titullarit të ISUV dhe strukturave për rekomandimet e zbatuara pjesërisht të marrin masat e nevojshme rast pas rasti me qëllim përshpejtimin e procesit për zbatimin e tyre.

Brenda 3-mujorit të IV të vitit 2022 dhe në vijimësi

Gjetje nga auditimi 3: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.973/8 prot, datë 22.12.2021, **janë në proces zbatimi rekomandimet me numër 1.1; 3.1; 5.1; 6.1; 7.1; 8.1; 9.1; 10.1; 11.1; 12.1; 14.1; 15.1; 16.1; 22.1, si vijon:**

1.1. Rekomandimi: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në bashkëpunim me MBZHR dhe AKSHI-n duhet të marrë masa për miratimin e rregulloreve në bazë të së cilave institucioni mbështet veprimtarinë e tij.
3.1. Rekomandimi: ISUV duhet të ndërmarrë masa për plotësimin e kapaciteteve njerëzore duke bërë rekrutime me qëllim plotësimin e strukturës së institucionit.
5.1. Rekomandim: ISUV në të ardhmen në zhvillimin e procedurave të prokurimit "Blerje e Vogël" me vlerë nën 100.000 lekë të hartojë procesverbalet përkatëse.
6.1. Rekomandim: ISUV në të ardhmen në procedurat që do të kryej duhet të marrë masa që në termat e referencës, të përfshihet objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

7.1. Rekomandim: ISUV në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në të ardhmen duhet ti kërkojë kontraktuesit së bashku me raportet mujore dhe situacionin e shërbimeve të kryera.
8.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit dhe personat e autorizuar mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e ardhshme të prokurimit, gjatë krijimi të Njësive të Prokurimit dhe të Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave, të bazohen në kornizat ligjore dhe rregullative dhe të përfshijnë specialist të fushës përkatëse të procedurës së prokurimit.
9.1. Rekomandim: ISUV në bashkëpunim me MBZHR t'i kërkojnë AKSHI-t lidhjen e një marrëveshje nivel shërbimi, për mbarëvajtjen, monitorimin dhe dokumentimin e shërbimeve që AKSHI kryen ndaj ISUV.
10.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit dhe personat e autorizuar mbi ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e ardhshme të bazohen në përcaktimet e kornizave ligjore.
11.1. Rekomandim: ISUV në të ardhmen të zbatojë procedurat ligjore dhe kontraktuale të marrjes në dorëzim të shërbimeve.
12.1. Rekomandim: ISUV në të ardhmen të zbatojë të gjitha kornizat ligjore në delegimin dhe ndarjen e përgjegjësive në procedurat e prokurimeve.
14.1. Rekomandimi: ISUV duhet të ndërmarrë masa për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e faqes web me elementët përkatës të sigurisë së navigimit online për të rritur sigurinë.
15.1 Rekomandimi: ISUV të marrë masa për menaxhimin dhe administrimin e qendërzuar dhe të sigurt të rrjetit të ISUV nëpërmjet implementimit të Active Directory.
16.1. Rekomandimi: ISUV të marrë masa për hartimin dhe miratimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit, duke përfshirë planet për backup, sistemet dhe pajisjet kompjuterike.
22.1. Rekomandimi: ISUV me qëllim rritjen e efektivitetit të ndërsjellët të të dhënave që mbahen në sistemin LIMS në bashkëpunim me AKSHI-n dhe MBZHR të identifikojnë fushat e ndërveprimit të databazës LIMS me databazat e institucioneve të tjera për arritjen e ndërveprimit në fushat e interesit reciprok.

Rekomandimi 3: Titullarit të ISUV dhe strukturave për rekomandimet që janë në proces zbatimi të marrin masat e nevojshme rast pas rasti me qëllim përshpejtimin e procesit për zbatimin e tyre.

Brenda 3-mujorit të IV të vitit 2022 dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Gjetje nga auditimi 11: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 973/8 prot, datë 22.12.2021, **është në proces zbatimi rekomandimi numër 1, si vijon:**
1.1. Rekomandim**:** Titullari i Institucionit të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të mundësuar arkëtimin e shumës 1,704,000 lekë e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit pasi është përfituar padrejtësisht nga Kontraktuesi A. sh.p.k.

Rekomandimi 11: Titullarit të ISUV dhe strukturave për rekomandimet që janë në proces zbatimi të marrin masat e nevojshme, me qëllim përshpejtimin e procesit për zbatimin e tyre.

Brenda 3-mujorit të IV të vitit 2022 dhe në vijimësi

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME – POSTA SHQIPTARE SHA

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 58 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 52 masa dhe nuk janë pranuar 6 masa. Nga masat e pranuara situata në lidhje me

rekomandimet rezultoi se: janë zbatuar 8 masa, janë në proces zbatimi 40 masa organizative, janë zbatuar pjesërisht 2 masa organizative, nuk janë zbatuar 2 masa organizative.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit"*, për përmirësimin e gjendjes, Ju ***rikërkojmë*** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi si dhe të pa zbatuara si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

Gjetje nga auditimi 1: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.877/36 prot, datë 03.02.2022, **nuk janë zbatuar rekomandimet me numër 26.1; 27.1, si vijon:**

<u>26.1 Rekomandimi</u>: Këshilli Mbikëqyrës të miratojë ndryshimet e nevojshme për marrjen e kompetencës për emërimet e audituesve në Auditin e Brendshëm dhe heqjen e kësaj të drejtë nga Administratori i shoqërisë, me qëllim garantimin e pavarësisë së funksionaliteteve dhe objektivave që kërkohen të arrihen nga struktura e Auditit të Brendshëm si dhe shmangien nga kushtet e konfliktit të interesit për ushtrimin e detyrave të audituesit.
e statutit të shoqërisë në mënyrë që të zbatohet rekomandimi i mësipërm.
<u>27.1.Rekomandimi</u>: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a dhe Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të vlerësojnë me prioritet auditimin e IT, duke implementuar metodologjinë e përcaktuar në manualin e auditimit IT, dhe duke u thelluar në kontrolle të vazhdueshme me qëllim dhënien e sigurisë objektive, si dhe këshillimin e menaxhimit për arritjen e objektivave nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike të veprimeve që realizohen nëpërmjet sistemit për të garantuara sigurinë e të dhënave, si dhe minimizimin e kostove operacionale.
Gjithashtu të merren masa për mbulimin me auditim të brendshëm IT të sistemeve IT, në Drejtorinë e IT-së dhe Zhvillimit në përputhje me përcaktimet ligjore.

Rekomandimi 1: Titullarit të Postës Shqiptare dhe strukturave për rekomandimet e pazbatuara të marrin masat e nevojshme rast pas rasti me qëllim përshpejtimin e procesit për zbatimin e tyre.

Brenda 3-mujorit të IV të vitit 2022 dhe në vijimësi

Gjetje nga auditimi 2: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.877/36 prot, datë 03.02.2022, **janë zbatuar pjesërisht rekomandimet me numër 19.3;30.1, si vijon:**

19.3 <u>Rekomandimi</u>: Strukturat përgjegjëse në shoqërinë Posta Shqiptare Sh.a, të marrin masa për vënien në funksion sa më shpejtë të funksionaliteteve ekzistuese në Eterna lidhur me fletëdaljet e artikujve të modulit magazine me qëllim realizimin e këtyre veprimeve në mënyrë automatike si dhe vënien në funksion modulin e blerjeve dhe modulin për menaxhimin e dokumenteve të cilët nuk janë në përdorim, edhe pse nevoja për të administruar nëpërmjet sistemit është e madhe.
<u>30.1. Rekomandim</u>: Posta Shqiptare, të analizojë shpenzimet dhe kostot faktike të shërbimeve të mirëmbajtjes së sistemeve Eterna dhe në procedurat e tjera të prokurimeve që do të realizojë, të llogarisë vlerën e kontratës së mirëmbajtjes (fondin limit) duke marrë në konsideratë, amortizimin moral dhe fizik të këtij sistem, vlerën e pasqyruar në kontabilitet dhe raportin kosto-përfitim.

Rekomandimi 2: Titullarit të Postës Shqiptare dhe strukturave për rekomandimet e zbatuara pjesërisht të marrin masat e nevojshme rast pas rasti me qëllim përshpejtimin e procesit për zbatimin e tyre.

Brenda 3-mujorit të IV të vitit 2022 dhe në vijimësi

Gjetje nga auditimi 3: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 877/36 prot, datë 03.02.2022, **janë në proces zbatimi rekomandimet me numër 1.1; 2.1; 3.1; 4.1; 5.1; 8.1; 9.1; 10.1; 11.1; 11.2; 12.1; 13.1; 14.1; 16.1; 17.1; 17.2; 19.1; 20.1; 21.1; 23.2; 24.1; 28.1; 29.1; 29.2; 29.3; 33.1; 34.1; 35.1; 39.1; 40.1; 41.1; 42.1; 43.1; 44.1; 47.1; 48.1; 49.1; 50.1; 51.1; 52.1, si vijon:**

1.1 Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sha, duke marrë në konsideratë rëndësinë e shërbimeve postare dhe financiare që ofron shoqëria si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni zotëron dhe përpunon me qëllim përcaktimin e objektivave dhe adresimin e burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Postës, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e Planit Strategjik Institucional ku të përfshihet edhe planifikimi strategjik mbi teknologjinë e informacionit dhe ku të adresohen qartë objektivat e institucionit duke reflektuar ndryshimet institucionale, strukturore dhe ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndodhura ndër vite në Postën Shqiptare. Gjithashtu organet drejtuese të Postës Shqiptare Sha të marrin masa për përcaktimin e elementëve dhe indikatorëve të matshëm për matjen e plotësimit të objektivave të përcaktuara.
2.1 Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sha dhe strukturat këshilluese mbi IT, të hartojë, amendojë dhe miratojë, rregulloren e brendshme, "Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare Sha", me qëllim reflektimin e ndryshimeve institucionale, strukturore dhe ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndodhura ndër vite në shoqëri. Hartimi i kësaj Rregulloreje të marrë në konsideratë vendosjen e kontrolleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme aktuale si dhe me legjislacionin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Shqipëri.
3.1 Rekomandimi: Organet drejtuese në Posta Shqiptare Sh.a, të marrin masa për miratimin e këtyre rregulloreve dhe amendimin e tyre me qëllim reflektimin e ndryshimeve institucionale, strukturore dhe ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndodhura ndër vite në shoqëri.
4.1 Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a dhe strukturat këshilluese mbi IT, të hartojnë, amendojnë dhe miratojnë, aktet rregullative të cituara më lart në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore me qëllim reflektimin e ndryshimeve institucionale, strukturore dhe ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndodhura ndër vite në Postën Shqiptare.
Gjatë hartimit dhe miratimit të tyre të respektohen rigorozisht përcaktimet ligjore për arkivat në Republikën e Shqipërisë.
5.1 Rekomandimi: Administratori i Përgjithshëm i Postës Shqiptare Sh.a në bashkëpunim me Departamentet përkatëse në Posta Sh.A dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrin masa për menaxhimin e burimeve njerëzore, me qëllim adresimin e përgjegjësive dhe përcaktimin e detyrave si dhe plotësimin e vendeve vakante sipas strukturës organike. Gjithashtu të marrin masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit IT dhe të çdo përdoruesi të sistemeve TIK si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

8.1 Rekomandimi: Posta Shqiptare Sh.a të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomës të serverave në bazë të rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK si dhe në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim ruajtjen e sigurisë fizike të ambienteve të infrastrukturave kritike.

9.1 Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a të marrin masa për hartimin dhe miratimin e rregulloreve përkatëse për funksionimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit që ka në përdorim institucioni, me qëllim pasqyrimin e saktë të përgjegjësive, detyrave dhe të drejtave për menaxhimin e përdoruesve të këtyre sistemeve. Në rregullore të përcaktohet edhe politika për menaxhimin e gabimeve njerëzore dhe teknike në lidhje me përdorimin e sistemeve të IT.

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit të marrë masa për adresimin e çështjeve të konstatuar nga grupi i auditimit, me qëllim rritjen e sigurisë së identifikimit të përdoruesit si: fjalëkalim i ndryshëm nga përdoruesi, gjatësia, përfshirja e karaktereve speciale apo numrave si dhe periodiciteti për ndryshimin e tij, me qëllim rritjen e sigurisë në identifikimin e përdoruesit. Të merren në konsideratë praktikat e përcaktuara në rregulloren për "Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike" miratuar nga AKCESK. Gjithashtu, të aktivizohen automatikisht:

-Opsioni "Aktiv" për përdoruesit e rinj, çfarë parandalon së pari veprime të tjera operacionale, por dhe si një veprim i shpeshtë i cili duhet të jetë standard.

-Ndryshimi i fjalëkalimit me forcë nëpërmjet opsionit "Ndrysho fjalëkalimin në log-imin e radhës", as në rastet kur fjalëkalimi gjenerohet në mënyrë automatike si emri i përdoruesit për përdoruesit e rinj.

11.1 Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit të marrë masa për unifikimin e të dhënave për përdoruesit e sistemit Eterna financiare dhe postare të të njëjtës kategori, të plotësojë të dhënat që mungojnë për çdo përdorues, të ndërtojë kontrolle për mbylljen e përdoruesve në kohën e duhur, të mbyllë përdoruesit të cilët kanë përfunduar objektin e krijimit, me qëllim ruajtjen e sistemit nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu të marrë masa për analizimin e situatës aktuale të evidentuara nga auditimi në lidhje me integritetin dhe plotësinë e të dhënave mbi përdoruesit e sistemeve Eterna financiare dhe postare.

11.2 Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit të ndërtojë mekanizma kontrolli për dokumentimin dhe miratimin fizik të ndryshimeve të lejuara për përdoruesit e sistemeve, me qëllim evidentimin dhe parandalimin e problematikave që lidhen me sigurinë e të dhënave.

12.1.Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në postën Shqiptare të marri masa për:

-Konfigurimin në routerin kryesor të një scripti i cili monitoron subnetet ku posta ka shërbimet e saj me qëllim detektimin në rastin e një sulmi ose hyrje të pa autorizuar IP-në e aksesimit dhe në mënyrë automatike ta vendosi në një "blacklist ".

-Të merren masa për të ndryshuar të gjitha portat e aksesimit të serverave, pajisjeve nga standarde në custom pasi sulmet bëhen gjithnjë në portat standarde të aksesimit Remote, me qëllim uljen e riskut për thyerje të sigurisë.

-Të bllokohet useri "admin" dhe të krijohet një user me emërtim ndryshe dhe me privilegje të plota.

-Të krijohen grup userash me të drejta të limituara. Një user i cili shërben për monitorimin SNMP me të drejta vetëm Read dhe një user i cili aksesohet nga stafi me të drejta vetëm Read.

-Të krijohet një procedure e kontrollit të log-eve javore për të parë dhe analizuar a ka patur tentative sulmesh, ose skanime të userit admin.

-Posta Shqiptare duhet të marrë masa për lidhje backup për të gjitha filialet e saj, duke garantuar shmangien e bllokimit të punës në rast të një defekti në lidhjen primare.

Gjithashtu të merren masa për administrimin dhe implementimin e të gjitha konfigurimeve të nevojshme të evidentuara nga auditimi dhe të tjera të mundshme, me qëllim rritjen e sigurisë së infrastrukturës network.

13.1.Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në Postën Shqiptare të marri masa për rritjen e kapacitet të storage apo zëvendësimin e tyre në përputhje me nevojat institucionale që Posta Sh.a ka, duke marrë në konsideratë dhe zhvillimet teknologjike për të ardhmen në shoqërinë Posta Shqiptare, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së punës.

14.1.Rekomandim: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a t'i japin rëndësi sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave duke filluar së pari me hartimin e një procedure apo rregullore për menaxhimin e gjurmës elektronike të auditimit, me qëllim uljen e riskut mbi sigurinë e të dhënave me pasojë humbjen dhe tjetërsimin e tyre. Në këtë dokument duhet të specifikohet qartë vendi ku ruhen gjurmët, për cilat veprime të përdoruesit ruhen këto gjurmë, koha, struktura përgjegjëse për monitorimin dhe analizimin e tyre, detyrat dhe përgjegjësitë, e çdo element që i shërben sigurisë së të dhënave dhe parandalimit në tjetërsimin e tyre.

16.1.Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në bashkëpunim me strukturat drejtuese në Postën Shqiptare të marrin masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, me qëllim uljen e riskut për ndërprerjen e shërbimeve dhe vazhdimësisë së punës.

17.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë, në bashkëpunim me drejtorët e përgjithshëm të cilët drejtojnë sipas strukturës Departamentin e Shërbimeve, Administrimin e Shoqërisë dhe Zhvillimit dhe Standardeve të hartojnë, dokumentojnë dhe miratojnë gjurmën e auditimit për rrjedhën e transaksioneve financiare dhe të tjera, ku të jenë identifikuar procedurat dhe operacionet që shoqëria ndjek me qëllim qartësinë dhe kuptueshmërinë e mjedisit të kontrollit.

17.2 Rekomandimi: Drejtuesit e Departamentit të Shërbimeve, Administrimit të Shoqërisë dhe Zhvillimit dhe Standardeve krahas identifikimit të proceseve që nevojiten për dokumentimin e gjurmës audituese, në bashkëpunim me Drejtorinë e IT dhe Zhvillimit dhe Drejtorinë e Sigurisë dhe Cilësisë duhet të hartojnë dhe dokumentojnë diagramet e rrjedhës së informacionit për çdo proces që realizohet nëpërmjet sistemit me qëllim përcaktimin e të dhënave hyrëse, roleve, ndryshimin, miratimin dhe përfundimin për çdo shërbim që realizohet nëpërmjet sistemit informatik.

19.1 Rekomandimi: Posta Shqiptare Sh.a, të marrë masa për përditësimin e manualeve të sistemit Eterna me qëllim shtimin e produkteve/shërbimeve të reja si dhe të marrë masa për sistemimin e mangësive në sistem për mirëmbajtjen e kursit të këmbimit për monedhën EUR.

20.1.Rekomandimi: Drejtoria e TI dhe Zhvillimit, të analizojë dhe adresojë tek ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes parregullsitë, mangësitë e konstatuara nga auditimi mbi raportet që gjenerojnë të dhëna të sistemit të cilat nuk kanë filtrat e aplikuar, nuk zgjidhin kërkesat e përdoruesve të cilët krijojnë mënyra alternative të përpunimit të mëtejshëm të informacionit jashtë sistemit Eterna Financiar dhe Postar, çfarë do të lehtësonte veprimet manuale të punonjësve.

21.1.Rekomandimi: Drejtoria e TI dhe Zhvillimit, të analizojë dhe adresojë tek ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes parregullsitë, mangësitë e konstatuara nga auditimi mbi fshirjen në mënyrë automatike nga sistemi Eterna Postar të të dhënave të marrësit të pakove që janë në pritje si dhe të merren masa për shtimin e funksionaliteteve të reja mbi popullimin e informacioneve të klientëve ekzistues në mënyrë të automatizuar, çfarë do të lehtësonte veprimet manuale të punonjësve.

23.2 Rekomandimi: Drejtoria e TI dhe Zhvillimit, të analizojë dhe të marri masa mbi përdoruesit që kanë më shumë se dy user-a aktiv tek portali e-Albania si dhe përdoruesit që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Postën Shqiptare dhe rezultojnë të kenë përdorues

aktiv për leximin e shërbimeve nga e-Albania, me qëllim uljen e riskut për akses të paautorizuar dhe keqpërdorimin e të dhënave.

24.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a, të marrin masat e nevojshme për:

a. informatizimin e shërbimeve që kryhen manualisht;

b. importimin e të dhënave në Datawarehouse BI, për shërbimet që kryhen tek sistemet e të tretëve në mënyrë automatike, ditore;

c. implementimin e raporteve me të dhëna përmbledhëse nga Dataëarehouse BI, që i shërbejnë monitorimit, vendimmarrjes, raportimit dhe transparencës.

28.1. Rekomandimi: Posta Shqiptare, në Dokumentet e Tenderit dhe në kushtet e kontratave të çdo procedure prokurimi që do të realizojë për blerjen edhe mirëmbajtjen e çdo sistemi teknologjie informacioni që do të aplikojë dhe zhvillojë, duhet të përcaktojë që:

-"Posta Shqiptare, në përfundim të kontratës së furnizimit apo të afatit të garancisë së pajisjeve dhe sistemit, apo në përfundim të afatit të kontratës së parë të mirëmbajtjes (sipas përcaktimeve të VKM. 710, datë 21.8.2013), pronësia e Kodeve Burimore (source code), analizat e projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të sistemit, do ti kalojnë Postës Shqiptare Sh.a, pa asnjë kosto shtesë".

*29.1. Rekomandim: Posta Shqiptare Sh.a, të gjejë rrugët e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit për të negociuar me OE "*H. S.*" me qëllim heqjen nga kontrata e datës 31.08.2020, për "Mirëmbajtjen E-Posta për 4 vite" të kushtit: "Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit".*

29.2. Rekomandim: Posta Shqiptare, në Dokumentet e Tenderit të çdo procedure prokurimi të hapur që do të realizojë për blerjen e moduleve dhe për mirëmbajtjen e sistemeve Eterna, të marrë në konsideratë rekomandimet e APP, dhe të mos vendosë kërkesat e veçanta që: "OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Softëare të instaluar tek Posta Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program"; "Operatori ekonomik, qofte zotëruesi i të drejtës se autorit ose i autorizuar prej tij, duhet te disponoje kodin ne burim, pasi Posta Shqiptare nuk e disponon këtë kod".

*29.3. Rekomandim: Posta Shqiptare Sh.a, me përfundimin të kontratës së lidhur në datën 31.08.2020, me OE "*H. S.*" për "Mirëmbajtjen E-Posta për 4 vite", me vlerë 20,000,000 lekë, pa TVSH, në kushtet e Veçanta dhe të Përgjithshme të kontratave që do të realizohen në procedurat e prokurimeve vijuese për shërbimin e mirëmbajtjes të sistemeve Eterna, të vendosë kushtin që: "Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit do të jetë dhe do të mbetet pronë e Postës Shqiptare".*

33.1. Rekomandimi: Posta Shqiptare Sh.a, në të gjitha procedurat e tjera të prokurimeve, duhet të mbajë parasysh faktin që, kriteret e veçanta të kualifikimit, të hartohen konform rregullave të prokurimit publik, të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohet dhe të sigurojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

34.1. Rekomandimi: Posta Shqiptare Sh.a, në të gjitha procedurat e tjera të prokurimeve, duhet të mbajë parasysh faktin që, për përmbushjen e kapacitetit ekonomik dhe teknik kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen dhe të jenë në përputhje dhe brenda kufijve të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik.

35.1.Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të mbajnë procesverbalet mbi monitorimin e ofrimit dhe cilësisë të shërbimit sipas kushteve të kontratës.

39.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi planifikimin buxhetor të shpenzimeve të njësisë, në rastet kur vlera e shpenzimeve/investimeve është në vlera të larta, të kryejnë një analizë kosto-përfitim të shpenzimeve/investimeve në fjalë.
40.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e procedurës së prokurimit në fjalë të hartojnë MNSH-në bazuar në praktikat më të mira.
41.1Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të bëjnë të mundur kryerjen e kolaudimit të pajisjes dhe mbajtjen e procesverbaleve në mënyrë intervalore.
42.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e specifikimeve teknike në procedurat e ardhshme të prokurimeve, gjatë hartimit të specifikimeve teknike, të bazohen në rregulloret dhe legjislacionin përkatës.
43.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe të kritereve të veçanta në procedurat e ardhshme të prokurimeve, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe të kritereve të veçanta, të kenë kujdes që kriteret e vendosura të mos jenë diskriminuese duke penalizuar operatorë që të jenë pjesëmarrës në garë.
44.1.Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe të kritereve të veçanta në procedurat e ardhshme të prokurimeve, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe të kritereve të veçanta, të kenë kujdes që kriteret e vendosura të mos jenë diskriminuese duke penalizuar operatorë që të jenë pjesëmarrës në garë, pasi në shpjegimin tuaj ky lloj kriteri do të plotësojë kërkesat e cilësisë, origjinalitetin e mallrave nuk qëndron sepse janë certifikatat ato që i japin këto atribute dhe jo emri.
47.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e procedurës së prokurimit në fjalë të hartojnë MNSH-në bazuar në praktikat më të mira.
48.1 Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të bëjnë të mundur kryerjen e kolaudimit të pajisjes dhe mbajtjen e procesverbaleve në mënyrë intervalore
49.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e procedurës së prokurimit në fjalë të hartojnë MNSH-në bazuar në praktikat më të mira.
50.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi marrjen në dorëzim të kontratës dhe zbatimit të saj të bëjnë të mundur së bashku me operatorin ekonomik fitues të zhvillojnë trajnime të stafit sipas pikave të specifikimeve teknike.
51.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e procedurës së prokurimit në fjalë të hartojnë MNSH-në bazuar në praktikat më të mira.
52.1 Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe të kritereve të veçanta në procedurat e ardhshme të prokurimeve, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe të kritereve të veçanta, të kenë kujdes që kriteret e vendosura të mos jenë diskriminuese duke penalizuar operatorë që të jenë pjesëmarrës në garë.

Rekomandimi 3: Titullarit të Postës Shqiptare dhe strukturave për rekomandimet që janë në proces zbatimi të marrin masat e nevojshme rast pas rasti me qëllim përshpejtimin e procesit për zbatimin e tyre.

Brenda 3-mujorit të IV të vitit 2022 dhe në vijimësi

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME – BASHKIA SHKODËR

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 26 masa organizative. Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 26 masa. Janë zbatuar 4 masa, janë në proces zbatimi 8 masa organizative, janë zbatuar pjesërisht 5 masë organizative dhe nuk janë zbatuar 9 masa organizative.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit"*, për përmirësimin e gjendjes, Ju ***rikërkojmë*** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi si dhe të pa zbatuara si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

Gjetje nga auditimi 1: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 552/7 prot, datë 19.09.2021, **nuk janë zbatuar rekomandimet me numër 1.1; 2.1; 6.1; 7.1; 8.1; 19.1; 20.5; 21.1, si vijon:**

1.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër duke patur parasysh ndryshimet strukturore dhe infrastrukturore të ndodhura në institucion të marrë masa për përditësimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë për vitet 2015-2030 me element të teknologjisë së Informacionit dhe të bëjë rishikimin e këtij dokumenti strategjik çdo 5 vjet.
Gjithashtu strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme të marrin masa për përcaktimin e elementëve dhe indikatorëve të matshëm për matjen e plotësimit të objektivave të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë.
2.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit.
6.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër në bashkëpunim me strukturat këshilluese mbi TIK dhe sektorin TIK, të marrin masat e nevojshme për përditësimin dhe dokumentimin e regjistrit të risqeve dhe për hartimin dhe dokumentimin e një plani veprimi për minimizimin/ parandalimin e risqeve të identifikuara, si dhe të bëhet monitorimi periodik i zbatimit të këtyre masave.
7.1 Rekomandim: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Shkodër në bashkëpunim me sektorin TIK të marrin masa për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve si dhe menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.
8.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër të marri masa për zhvillimin e burimeve njerëzore të Auditit të brendshëm me njohuri të mjaftueshme mbi teknologjinë e informacionit dhe mbulimin me auditim të brendshëm IT të sistemeve IT, sektorit IT pranë bashkisë si dhe përdoruesit e sistemeve informatike në përputhje me përcaktimet ligjore.
19.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër të marrin masa për hartimin dhe miratimin e rregulloreve përkatëse për funksionimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit të cilët ka në përdorim institucioni, në të cilat të jenë të pasqyruara saktë përgjegjësitë, detyrat dhe të drejtat për menaxhimin e përdoruesve të këtyre sistemeve. Në rregullore të përcaktohet edhe politika për menaxhimin e gabimeve njerëzore dhe teknike në lidhje me përdorimin e sistemeve të IT.
20.5 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, në bashkëpunim me strukturën e teknologjisë së informacionit të marrin masa për hartimin dhe miratimin e një politike të mirë dokumentuar për analizimin periodik të gjurmëve të auditimit të veprimeve të kryera në sistemet IT me qëllim evidentimin dhe parandalimin e problematikave të mundshme në lidhje me mirëfunksionimin dhe mirë përdorimin e sistemeve IT të Bashkisë Shkodër.
21.1 Rekomandimi: Struktura e teknologjisë së informacionit, të marrë masa për analizimin e situatës aktuale në lidhje me integritetin dhe plotësinë e të dhënave që përmbajnë sistemet informatike të Bashkisë Shkodër duke përcaktuar edhe shkaqet prej të cilëve rrjedhin problematikat e konstatuara. Të merren masat e nevojshme për ngritjen dhe implementimin e mekanizmave të kontrollit dhe validimit të inputit të sistemeve informatike, duke përcaktuar

dhe kornizuar tipin e të dhënave që mund të plotësojnë përdoruesit në përputhje me formatin dhe informacionin që përmban secila prej fushave, me qëllim parandalimin e përsëritjes së problematikave të konstatuara.

Rekomandimi 1: Titullarit të Bashkisë Shkodër dhe strukturave për rekomandimet e pazbatuara të marrin masat e nevojshme rast pas rasti me qëllim përshpejtimin e procesit për zbatimin e tyre.

Brenda 3-mujorit të IV të vitit 2022 dhe në vijimësi

Gjetje nga auditimi 2: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 552/7 prot, datë 19.09.2021, **janë zbatuar pjesërisht rekomandimet me numër 4.1; 10.1; 11.1; 12.1; 18.1, si vijon:**

4.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrin masa për menaxhimin e burimeve njerëzore, gjithashtu të marrin masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit IT dhe të çdo përdoruesi të sistemeve TIK si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.
10.1 Rekomandim: Sektori TIK pranë Bashkisë Shkodër të marrë masat e nevojshme për krijimin e konfigurimeve përkatëse në rrjetin e institucionit mbi logimin, konfigurimin dhe sigurinë e switch-ve dhe firewall-it. Të krijohen zona me limite të caktuara brenda LAN si dhe rrjeti të konfigurohet në VLAN (rrjete virtuale) për menaxhimin dhe lejimin e grupeve të IP-ve në shërbime të ndryshme sipas nevojave. Gjithashtu të merren masa për administrimin dhe implementimin e të gjitha konfigurimeve të nevojshme të evidentuara nga auditimi dhe të tjera të mundshme, me qëllim rritjen e sigurisë së infrastrukturës network.
11.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për mbarëvajtjen e faqes web, të marrin masa për përmirësimin e faqes web me elementët përkatës të sigurisë (certifikatën e sigurisë) së navigimit online për të rritur sigurinë si dhe të merren masa për përmirësimin dhe përditësimin e faqes web me (informacione, ligje, rregullore, akte, etj) për të rritur ndihmesën ndaj qytetarëve. Të reflektohen dobësitë e dala nga auditimi dhe të kihet parasysh që në të ardhmen të shtohen elementë inovativ në faqen web për ta bërë atë sa më interaktive dhe ndihmëse për qytetarët.
12.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në bashkinë Shkodër në bashkëpunim me sektorin e IT-së të marrin masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat.
Gjithashtu të merren masat e nevojshme që ruajtja e të dhënave dhe backup-eve të sistemeve të realizohet në memorie dhe hapësira virtuale që janë në pronësi të bashkisë me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit dhe cenimin e të dhënave të sistemeve.
18.1 Rekomandimi: Personat autorizues mbi ndjekjen e zbatimit të kontratës të kryejnë matjen e cilësisë së shërbimeve dhe të kryejnë raporte periodike mbi ecurinë e shërbimit bazuar në kontratën e lidhur midis O.E dhe A.K.

Rekomandimi 2: Titullarit të Bashkisë Shkodër dhe strukturave për rekomandimet e zbatuara pjesërisht të marrin masat e nevojshme rast pas rasti me qëllim përshpejtimin e procesit për zbatimin e tyre.

Brenda 3-mujorit të IV të vitit 2022 dhe në vijimësi

Gjetje nga auditimi 3: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.552/7 prot, datë 19.09.2021, **janë në proces zbatimi rekomandimet me numër 9.1; 13.1; 14.1; 15.1; 16.1; 17.1; 19.2; 20.2, si vijon:**

9.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomës të server-ave në bazë të rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK si dhe në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.
13.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit dhe personat autorizues mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e ardhshme , gjatë krijimi të Njësive të Prokurimit dhe të Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave, të bazohen në kornizat ligjore dhe rregullative dhe të përfshijnë minimumi një specialist të fushës përkatëse të procedurës së prokurimit.
14.1 Rekomandimi: Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të kenë parasysh që gjatë vlerësimit të O.E pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, të bazohen në legjislacionin përkatës që të mos lejojnë asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në dokumentacion apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.
15.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit dhe personat autorizues mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e ardhshme të prokurimit, gjatë krijimi të Njësive të Prokurimit dhe të Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave, të bazohen në kornizat ligjore dhe rregullative dhe të përfshijnë minimumi një specialist të fushës përkatëse të procedurës së prokurimit.
16.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit dhe personat autorizues mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e prokurimit, me bazë shërbimet në Teknologjinë e Informacionit të kenë parasysh që në hartimin e kontratave të shërbimit të bazohen në legjislacionin e sipërpërmendur duke hartuar Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit.
17.1 Rekomandimi: Personat autorizues mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e prokurimit, me bazë shërbimet në Teknologjinë e Informacionit, në sistemet ekzistuese, të parashikojnë MNSH-në, kohëzgjatja e së cilës duhet të jetë jo më e shkurtër se 2 (dy) vjet.
19.2 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër të marrin masa për përcaktimin e administrator-it/ëve të sistemeve të teknologjisë së informacionit që Bashkia Shkodër ka në përdorim. Detyrat, përgjegjësitë dhe të drejtat e administratorit të sistemeve IT përcaktohen në rregulloren përkatëse të sistemit.
20.2 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, në bashkëpunim me strukturën e teknologjisë së informacionit të marrin masa për minimizimin e rasteve të krijimit të përdoruesve me kredenciale gjenerike. Nëse do të përdoren të tillë, të përcaktohet me Urdhër të veçantë se cili punonjës do të posedojë dhe do të përdorë këto kredenciale.

Rekomandimi 3: Titullarit të Bashkisë Shkodër dhe strukturave për rekomandimet që janë në proces zbatimi të marrin masat e nevojshme rast pas rasti me qëllim përshpejtimin e procesit për zbatimin e tyre.

Brenda 3-mujorit të IV të vitit 2022 dhe në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT